

Rendi i ditës

Procesi i Konsultimeve mbi mekanizmat për përcaktimin e fakteve për krime të luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut

Hotel Prishtina, Prishtinë

05.04.2009

- | | |
|---------------|--|
| 10:00 – 10:15 | Hapja e takimit
Kushtrim Koliqi - Integra |
| 10:15 – 12:00 | Nevojat e viktimave dhe e shoqërisë në Kosovë
Shukrije Gashi – Partners Kosova
Diskutime |
| 12:00 – 12:15 | Video regjistrim: Dëshmia publike e viktimave |
| 12:15 – 12:45 | Pauza |
| 12:45 – 13:15 | Përvojat e të tjerëve: Komisionet për përcaktimin e fakteve mbi krimet në të kaluarën; Rëndësia dhe mekanizmat për përcaktimin e fakteve mbi të kaluarën
Bekim Blakaj – Fondi për të drejtën humanitare |
| 13:15 – 13:45 | Prezantimi i iniciativës për themelimin KOMRA-s: Historiati i iniciativës për KOMRA; Përse KOMRA
Ivan Novosel - Legalis |
| 13:45 – 14:30 | Pyetje dhe përgjigje |
| 14:30 – 15:00 | Konkluzionet |
| 15:00 | Dreka |

Pjesëmarrësit

1. Liridon Jetishi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike dhe Fakulteti Juridik
2. Kristijan Hasanaj, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
3. Visar Haxhifazliju, Resurs qendra për të rinj
4. Florim Atashi, Fakulteti Juridik
5. Gëzim Brestovci, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
6. Arta Selimi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
7. Bledar Bunjaku, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
8. Uran Me ujku, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
9. Lavdim Rizani, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
10. Liridona Ibrahim, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
11. Florentina Hajdari, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
12. Vullnet Sadikaj, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
13. Shkelzen Gërxhaliju, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
14. Refki Ramaj, Fakulteti ekonomik
15. Linda Krasniqi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
16. Abetare Me ulolli, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
17. Shqipe Avdiu, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
18. Arbresha Jashari, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
19. Dafina Sanaja, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
20. Lendita Behrami, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
21. Ylber Maxhuni, NVO *Youth Step*, Vushtri
22. Krenare Imeraj, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
23. Liridona Neziraj, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
24. Agnesa Jahme urataj, Fakulteti Filozofik, Departamenti i pedagogjisë sociale
25. Shukrije Ahmeti, Fakulteti Filozofik, Departamenti i pedagogjisë sociale
26. Aferdita Hyseni, Fakulteti Filozofik, Departamenti i pedagogjisë sociale
27. Sami Morina, Fakulteti Juridik
28. Venera Sylejmani, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
29. Blerina Osmani, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
30. Herolinda Ademi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
31. Lirie Avdiu, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
32. Edmir Sejdiu, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
33. Bukuriye Rrustemi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i sociologjisë
34. Resmije Bllaca, Fakulteti Juridik
35. Naser Lajqi, OJQ *Syri i vizionit*, Pejë
36. Fisnik Gashi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
37. Gentiana Dushi, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
38. Albulena Hasani, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike
39. Besart Metaj, Fakulteti Juridik
40. Nazim Maxhuni, Fakulteti Filozofik, Departamenti i shkencave politike

Organizatorët dhe panelistët

41. Ivan Novosel, *Legalis*, Kroaci
42. Shukrije Gashi, Partners Kosova-Center for Conflict Management
43. Kushtrim Koliqi, Integra
44. Bekim Blakaj, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë

45. Besarta Vasija, Fondi për të drejtën humanitare, Kosovë

Vëzhguesit

46. Abdullah Ferizi, Forum ZFD

47. Avni Melenica, Shoqata 22 *Maj*, Vushtrri

48. Martin Kraft, Forum ZFD

Hapja e mbledhjes

Kushtrim Koliqi: Që mbahet në Kosovë në vargun e dhjet plus një konsultime që do të mbahen gjatë tërë këtij viti në Kosovë. Këto Konsultime janë pjesë e një projekti ma të madh një projekti Regjional ku në secilën pjesë të ish Jugosllavisë, në pjesë ku ka pasur trazira ku ka pasur luftë kanë me u mbajt konsultimet. Në Kosove kanë me u mbajt 10 konsultime, kanë me qenë 5 nacional, 5 lokal, dhe një regjionale, çka domethënë, kanë me u thirr njerëzit nga regjioni. Shumë mirë që konsultimi i parë është me të rinj faktikisht me studentë të fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridik dhe shumë mirë që të rinjtë kanë hapur këtë cikël të konsultimeve që ka me u mbajt në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtyre mbledhjeve, me uhabeteve që do të bëhen gjatë këtyre konsultimeve ka të bëjë me iniciativën e shoqërisë civile të rajonit për themelimin e komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e kryera në ish Jugosllavi, të njëjtën kohë mbi shkeljet e rënda që janë bërë gjatë këtyre luftërave. Kështu që kjo është edhe arsye pse në sot jemi mbledh këtu. Për mos më vazhduar unë ma shumë ne kemi këtu njerëz që janë shumë ma kompetent në lidhje me këtë iniciativë. Kemi njerëz të cilët kanë punuar prej fillimit në këtë iniciativë faktikisht ka vite që është përfol dhe ka vite që është bo me uhabet për këtë iniciativë tash ka ardhur koha me u organizuar që me u mbledh sa më shumë komente, sugjerime prej target grupeve të ndryshme jo veç të rinjve, ka më pas konsultime më shumicën e target grupeve që konsiderohen shumë të rëndësishme për mi marr opinionin mbi themelimin të këtij komisioni regjional. Kishte qenë shumë mirë, shumë e udhës me u prezantuar, me bo një prezantim total të tavolinës po shkoj më vetveten unë jam Kushtrim Koliqi vij prej organizatës Integra dhe jam organizatori kryesor të konsultimeve më të rinj më student. Po vazhdoj nga ana imë tjetër.

Bekim Blakaj: Mirëdita të gjithëve unë jam Bekim Blakaj udhëheqës i zyrës Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë.

Ivan Novosel: Mirëdita të gjithëve unë jam Ivan Novosell. Anëtar i organizatës „Llegallis” e cila vepron në brendësi të grupit punues për të rinj lidhur me këtë koalicion KOMRA ne Kroaci.

Kushtrim Koliqi: Për të gjithë ata kemi dhe mysafir prej Kroacisë, për gjithë ata që nuk e dinë serbishten siç jam edhe unë, janë aty pajisjet për përkthim sime ultant kështu që ndermes panelistave është edhe Ivani kështu që mos më pas probleme në kome unikim.

Besarta Vasija : Fondi për të Drejtën Humanitare, koordinatorë për Kosovë e koalicionit për themelimin e KOMRA-s.

Liridon Jetishi : Liridon Jetishi student i shkencave politike edhe fakultetit juridik.

Kristijan Hasanaj: Kristijan Hasanaj student i shkencave politike.

Visar Haxhifazliju: Vijë për Qendrës së resurseve për student, gjithashtu student.

Florim Atashi: Florim Atashi student i fakultetit Juridik.

Gezim Brestovci: Gëzim Brestovci Shkencat politike

Arta Selimi : Arta Selimi student e Shkencave politike viti i dytë.

Bledar Bunjaku: Bledar Bunjaku –Shkencat politike

Uran Me ujku: Uran Me ujku Shkencat politike

Lavdim Rizani: Lavdim Rizani student i Shkencave politike

Liridona Ibrahimimi : Student e Shkencave politike, viti i parë

Florentina Hajdari: Student e Shkencave politike, viti i parë

Vulnet Sadikaj : Vulnet Sadikaj student i Shkencave politike

Shkelzen Gërxhaliju: Shkelzen Gërxhaliju -Nga departamenti Shkencave politike

Refki Ramaj: Student i fakultetit Ekonomik

Linda Krasniqi: Studente e fakultetit Ssociologjisë

Abetare Me ulolli : Studente fakulteti Filozofik departamenti Sociologji

Shqipe Avdiju: Sociologji

Arbresha Jashari: Sociologji

Dafina Sanaja: Sociologji

Lendita Behrami: Sociologji

Ylber Maxhuni : Përfaqësuesi organizatës joqeveritare,, Youth Step” nga Vushtrria

Avni Melenica:Familjari i personave të zhdukur, , 22 Maji”- Vushtrri

Martin Kraft :ZDF është një organizatë gjermane joqeveritare

Krenare Imeraj: Nga fakulteti Shkencave politike

Liridona Neziraj:Pedagogji sociale

Agnesa Jahme urataj:Absolvente e Pedagogjisë sociale

Shukrije Ahmeti:Studente Pedagogjisë sociale

Blerina Osmani: Pedagogji sociale

Aferdita Hyseni: Pedagogji sociale

Sami Morina: Juridik

Venera Sylejmanaj: Studente e Shkencave politike

Herolinda Ademi: Studente e Shkencave politike

Lirie Avdiu: Studente e fakultetit Filozofik, departamenti Shkencave politike

Edmir Sejdiu: Student i fakultetit Filozofik, departamenti Shkencave politike

Bukurije Rrustemi: Studioj Sociologjinë

Resmije Bllaca: Juridik

Naser Lajqi: Organizata joqeveritare,,Syri i vizionit “ Pejë

Fisnik Gashi: Shkenca politike

Gentiana Dushi: Shkenca politike

Albulena Hasani : Shkenca Politike

Abdullah Ferizi: Forumi ZFD në shërbim civil paqësor

Shukrije Gashi :Partners Kosova, Qendër për administrimin e konflikteve dhe anëtare e komisionit të KOMRA-s

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë, edhe njëherë sinqerisht falënderoj për interesim shumë të madh. Ndoshta edhe vet tema për të cilën ka me u fol është sensitive dhe shumë interesante të njëjtën kohë se në njëfarë forme dëshirojmë të bëjmë një zgjidhje për ato krime të cilat janë kryer në rajonin tonë. Dëshirojmë ta institucionalizojmë këtë problem që ka ndodhur dhe personat përgjegjës në çfarë do qoftë mënyrë me u dit e ndoshta edhe me u akuzu. Nuk ka qenë e rastësishme se shumica nga ju jeni nga Shkencat politike, Sociologjia dhe të Juridiku, se faktikisht Integra e ka parë si shumë të rëndësishme edhe drejtimin tuaj profesional që keni në lidhje më këtë komision rajonal i cili po planifikohet me u bë. Jo që studentët e tjerë janë më pak të rëndësishëm, por na mendojmë se kjo temë dhe ky institucion që ndoshta dhe ishalla themelohet e kryen punën e vetë e kryen mandatin e vetë. Mendoj që ju keni më qenë faktor kyçë në këtë proces, e sidomos në Kosovë. E di që për shumë njerëz jo veç për juve por për shumë njerëz edhe për me ua para një kohë ka qenë kjo temë pak sa abstrakte, ky ballafaqim me të kaluarën. Ka qenë pak temë abstrakte me bo një komision rajonal. Por kjo nuk është se ka ndodh për here të parë në Kosovë. Domethënë ka pasur shumë shtete e shumë vende që kanë kaluar nëpër trazira ndryshme, luftëra të ndryshme, nëpër krime të ndryshme ata janë ballafaquar me të kaluarën duke u nis me Luftën e Parë Botërore, aty ka hala proces për tu ballafaquar me të kaluarën. Do më thonë shumica e vendeve që kanë kaluar nëpër këso tragjedi të mëdha ata e kanë parë shumë të rëndësishme këtë ballafaqim më të kaluarën, në çfarë do forme. Tash organizatat serioze të krejt Ballkanit e kanë parë të rëndësishme se ky ballafaqim me të kaluarën përveç kontakti drejtë për drejtë të viktimave, përveç ngritjes së vetëdijes të popullit e ka pa shumë të rëndësishme të bëjë një institucion që ka peshë pa marr parasysh se çka kanë me qenë

rezultatet e atij institucioni, apo të dalurat të atij institucioni. Për të mos vazhduar më shumë, thash edhe njëherë kemi disa njerëz shumë më kompetent. I falënderoj shumë që kanë ardhur, që kanë gjetur kohë për të ardhur, faktikisht këta kanë me qenë njerëz që kanë me u sill gjatë këtyre 11 konsultime në Kosovë. Këta kanë më qenë që non-stop që kanë më fol. Edhe siç po e shihni në agjendë ju me undeni më pa se hapja ka qenë e imja, tash vazhdojmë më zonzjën Shukrije Gashi nga Partners Kosova, e cila do të na flas për nevojat e viktimave dhe shoqërisë në Kosovë. Gjithmonë në lidhje me këtë idenë e themelimit të koalicionit të Komisionit Rajonal. Pasi që zonzja Shukrije do të bëjë njëfarë prezantimi, do të flas në lidhje më këtë temë, atëherë është një kohë e caktuar për diskutim. Të kemi të qartë se nuk do të flasim vetëm ne. Ideja e këtyre konsultimeve është të flisni ju, ndërsa ne do të ju informojmë se çka përdëshirojmë të bëjmë, çka është ideja, çka po planifikohet të bëhet, ende nuk dihet a do të bëhet apo jo, por qëllimi i kësaj është që ju më thënë. Në qoftë se ne e kemi keq, në qoftë se e kemi mirë sugjerimet e juaja kanë me u rekordu si në mënyrë vizuale po ashtu edhe zëri juaj, kanë me u nxjerr konkluzionet prej secilit konsultim edhe prej këtë konsultim. Kështu që çdo gjë që do të thoni ka më qenë shumë e rëndësishme për neve, kjo do të jetë njëfarë lloj udhërrëfyese në lidhje më këtë Komision, sepse as ne nuk e dimë saktë se çfarë mandati ka më pas ky komision. E dijmë se është shumë e rëndësishme që në të ardhmen duhet themeluar një komision dhe duhet ta krij punën e vetë në mënyrë të pavarur, të pavarur sidomos prej politikës. Ja jap fjalën zonzjës Shukrije Gashi.

Nevojat e shoqërisë dhe viktimave

Shukrije Gashi, Partners Kosova

Shukrije Gashi: Mirëdita të gjithëve, mirë se keni ardhur, kam nder të veçantë që jeni të pranishëm në një iniciativë të tillë e cila ka një rendësi të veçantë për Kosovën edhe krejt rajonin. Unë jam shumë e sigurt se të rinjtë, studentët, janë ata të cilët ma së miri më së shumti me und të bëjnë për një iniciativë të tillë e cila do të jetë një obligim edhe qytetar, moral, njerëzor e nacional kur dihet që Kosova është pjesë e rajonit, është ende në fazën e bërjes së shtetësisë dhe e ka për obligim që të plotëson ose përmbush shumë standarde cilat janë një barrë e rëndë që peshojnë në një shtet i cili është në ndërtim e sipër dhe natyrisht se pa i përmbushur këto standarde Kosova nuk do të me und të arrin që të integrohet në Evropë aty ky edhe është synimi i gjithë qytetarëve të Kosovës, shoqërisë civile, pastaj qeverisë. Natyrisht se proceset e tilla nëpër të cilën po kalon edhe Kosova ka ndodh edhe në shumë vende të botës dhe me dhimbje dhe ballafaqime, probleme të mëdha. Fatmirësisht në gjithë këtë përballje tonën ose për përballjen e me vështirësi, fatmirësisht e kemi bashkësinë ndërkombëtare me ne dhe sigurisht që ma lehtë do ti kalojmë proceset, mirë po në radhë të parë në jemi ata të cilët duhem të bëjmë hapat të parë dhe ndoshta shumë ma shumë se sa që kërkohet nga ne për ti realizuar afatet e parapara për plotësimin e disa standardeve. Fillimisht kur kam dëgjuar për një iniciativë të tillë do më thonë për iniciativën rajonale për krijimin e një komisioni i cili do të bënë përcaktimin edhe gjetjen e fakteve për të vërtetën, vërtetë jam fascinuar dhe natyrisht se shoqëria civile gjithkrah në botë edhe në Kosovë dhe në rajon ndërmerr hapat e tilla të cilit në dukjen e parë duken të vështirë duken të paqartë është normale dhe e natyrshme me pas ngurrime në iniciativa të tilla kur ende në barrën e shoqërisë në ish Jugosllavi peshojnë mbi shtatëmbëdhjetë mijë viktima, raste, për

cilat ende nuk është bërë çka duhet, nuk është vënë drejtësia në vend. Për një ndërmarrje të tillë për të kryer veprime cilat do ta vënë drejtësinë në vend është shumë e nevojshme që duke e marr parasysh të gjitha veçantit nga rasti në rast, nga shteti në shtet, në pjesët e ish Jugosllavisë që qasja të jetë më së njerëzorë. Viktima e ka vetëm një emër dhe ajo quhet viktimë nuk ka ndonjë emër tjetër. Për ndërmarrje të tilla që janë të një vetëdije të lartë duhet pasur durim për arsye se ky është një proces i gjatë i dhimbshëm dhe natyrisht se në këtë proces ma së shumti kanë pësuar viktimat dhe fjala kryesore u takon atyre, ata duhet të dëgjohen dhe ne duhet pasur vesh për ti dëgjuar ata. Ne duhet marr provoja të hulumtuar se çka krejt nevojitet që të bëjmë, në këtë rast po flas për Kosovën, Kosova që drejtësia të vuhet në vend dhe shpresoj se me ndihmën në radhë të parë të studentëve, organizatave të rinjve organizatave për mbrojtën e të drejtave të njeriut siç themi gjyqësor të Kosovës, prokurorive dhe shoqërisë civile e qeverisë, do të arrijmë që bashkarish të bëjmë hapat e parë por të sigurt të vejmë një themel të qëndrueshëm. Ne duhet shpejtuar që të bëjmë hapa të tillë për arsye se ne jemi ata të cilët do ti shtyjmë këto ndryshime përpara. Është shoqëria civile, janë studentët, organizatat cilat përmendem të cilët duhen në mënyrë të pa ngurrime ta luajnë rolin e tyre të bëjnë shumë që qeveria të ndërmer hapa konkretë dhe të fillohet më inicimin e krijimit të një komisioni të tillë dhe vënies së drejtësisë në vend. Unë jam shumë e sigurt që gjithë ju e përcillni me kujdes emisionin e lajmeve dhe vazhdimisht jeni në rrjedhje me gjithë çka ndodhe në Kosove. Para dy ditësh, edhe ma shumë ka filluar për shembull greva e këshillit për mbrojtën e veteranëve të luftës. Kjo është një shenjë se ne ende në Kosove nuk jemi duke i kryer detyrat tona as si qytetar, dhe as si shoqëri, e as si shtet fatmirësisht një reagim i shpejtë i kryeministrit ishte i qëlluar dhe kjo flet që megjithatë shoqëria e Kosovës edhe si shoqëri civile edhe si qeveri po bënë përpjekje që ta zënë hapin me kohë dhe mirë është kjo. Natyrisht në procese të tilla duhet bërë përpjekje që ta kem vëmendjen në radhë të parë bie në viktimat të luftës, shoqatat e viktimave, viktimat, të zhdukurit, e shoqatat të tjerat, grupet të cilat janë atakuar më së shumti mirëpo për t'u dalë borxh grupeve të tilla shoqëria civile ka një obligim moral në këtë rast ju rinia sepse e ardhmja është me ju dhe ju takon juve që të bëni çmos që gjeneratat të cilat vijnë pas jush fëmijët e juaj të mos mbeten më ngarkesën se fqinjini tim ta shikoj si armik, kjo të hiqet të zhvendoset një herë dhe për gjithmonë nga terreni i ish Jugosllavisë fjala armik të vendoset në drejtësi të kryhen të dënohen kryesit e krimeve në ish Jugosllavi dhe mos të mbetet barrë shoqërisë dhe as në ndërgjegjen tonë njerëzorë një peshë e cila do të na pengon në hapat tonë drejt integritimit në Bashkësinë Evropiane që është një nga standardet e shumta cilat janë parashikuar për Kosovën që të me und të hyn në Bashkësinë Evropiane. Cilat janë komponentët shumë të rëndësishme që kjo të bëhet? Është ballafaqimi me të kaluarën në radhë të parë, Çka do të thotë ballafaqimi me të kaluarën? Ne e dimë se kjo komponent ngërthen në vetë shumë çka madje dhe emocione të shumta të cilat bëjnë që ne në radhë të parë si qenie njerëzore të bëjmë shumë përpjekje të jemi të paanshëm, të përpiqemi të jemi objektiv në të njëjtën kohë të përpiqemi të bashkë ndjejmë më viktimën të mos bëjmë dallime së viktima është shqiptare, është serbe, kroate, boshnjake e të tjera. Për atë të bëjmë përpjekje ta shohim si qenie njerëzorë po aq të rëndësishëm pjesëtari i nacionalitetit tonë. Përveç të tjerash, përveç kësaj që e thash është shumë më rendësi dhe do të ishte e mira e madhe që qytetarët pjesëtarët e secilit nacionalitet ata cilët kanë qenë pjesëmarrësit drejtpërsëdrejti në ndërmarrjen e krimeve të ndihmonin ose të dhënë ndihmë këtij procesi duke i sjell para drejtësisë ata cilët kanë kryer krime se vetëm duke e bërë një hap të tillë në do të krijojmë hapsin për të

treguar se vërtet ne i çojmë drejtat e njeriut, i çojmë zhvillimet demokratike, proceset demokratike në Evropë dhe më gjerë, që jemi të devotshëm për të qenë pjesë e bashkësisë ndërkombëtare. Për t'u bërë kjo për veç të tjerash janë disa standarde tjera të cilat drejtpërdrejt lidhen me ballafaqimin me të kaluarën. Pjesë e ballafaqimit me të kaluarën janë viktimat të cilat rendojnë ndërgjegjen tonë në të cilave duhet t'u krijohet hapësira për veç dëgjimit të zërit të tyre krijimin e me undësive të tjera, domethënë kryesit e veprave penale ata cilët ju kanë shkaktuar dhembje, pastaj ndërtimin e memorialëve, hartën e kujtesës dhe veprimet tjera të cilat jo që do ti kthejnë ata cilët u zhduken dhe u vranë por të paktën viktimat ta kanë një lehtësim moral se diçka shoqëria ka bërë për ta, është ndërmarr diçka që do ta vë drejtësinë në vend dhe drejtësia do të vihet në vend kur krijohet komisioni cili do të funksionon ashtu siç duhet dhe qytetarët të cilët pësuar më së shumti të ndihen të lehtësuar, së paktën që kriminelët janë dënuar. Kthimi i dinjitetit të viktimave po ashtu është një komponent tjetër, është një rast shumë i rëndësishëm. Dje në emisionin e lajmeve të mbrëmjes pash një sekuençë nga Mitrovica në lagjen Kovaçi se çka kishte ndodh në të kaluarën dhe që qytetarët të cilët kishin pësuar deklaruan se në përvjetorin e vrasjes së anëtarëve të tyre nuk kishte shkuar askush për ti takuar ata njerëz. Domethënë edhe pas dhjetë vjetësh nuk gjet askush as kurajo as interesim për ti vizituar këta njerëz. Kjo është një shkelje dinjitetit dhe kjo është pjesë e kësaj iniciative dhe kjo është thjesht obligim i ndërgjegjes tonë të cilën në nuk jemi duke e respektuar. Në fakt do duhej që familjet të tilla vazhdimisht do të janë në vëmendje edhe të shoqërisë civile por edhe të qeveris shtetit Kosovës. Të paktën që ata të jenë të rrethuar nga ne dhe ta dinë se e kanë vëmendjen tonë, se në po bashkë ndiem me ta, prandaj më vjen mirë sot që jeni këtu dhe keni gjet kohë e vullnet për të dëgjuar mos them për tu bashkëngjit se nuk di sa jeni të gatshëm por shpresat janë të mëdha se do ti bashkë ngjiteni një iniciative të tillë. Është e rëndësishme se kush e ndërmerr këtë iniciativë por në radhë të parë gjithmonë përqendrimin duhet ta kenë të interesimi të nevojta për ta vënë drejtësinë në vend. Prandaj unë shpresoj se ju jeni ata të cilët me vetëdije me vullnet dhe dëshirë të madhe do të përkrahni do të ndërmerrni hapa cilët do ti ndihmojnë viktimave dhe cilët atyre që pësuar që e ardhmja në Kosovë dhe në rajon të jetë e baraspeshuar mirë të zhduken të gjithat hezitimet rreth bashkëbisedimit më qytetarët e krejt rajonit që mos të ketë më dyer të mbyllura, rrugë të bllokuara por në të lirshëm bashkëbisedonim me njëri tjetrin dhe ti çajmë haletë më njëri tjetrin ti respektojmë dhe ti nderojmë viktimat të secilit komb dhe të gjitha minoriteteve në mënyrë që bota të na shoh ndryshe. Në këtë rast po e përmend shembullin më duket se ishte kryeministri i Francës nëse nuk gaboj i cili tha: Tash duhet të mbyllet rrethi i pranimit të shteteve të reja në bashkësinë evropianë. A thua pse ndodhi kjo? Dhe me ua menjëherë më ka shkua mendja tek Kosova dhe tek shtete tjera të ish Jugosllavisë sigurisht se po të silleshim ndryshe dhe po të ndërmerrnim hapat të nevojshme dhe të shpejt për ti eliminuar gjitha këto pengesa ose ma mirë të them plotësim standardesh nuk do të mbyllej dera, unë shpresoj se ishte vetëm një, domethënë ishte vetëm propozimi i tij dhe këtë hap nuk do ta ndërmarrin shtetet tjera. Çka do të thotë kjo po të na mbyllet dera. Si Kosovë që ne për 10-15 vite ose ma tepër të ngelim jashtë bashkësisë evropianë aty ku edhe e kemi synimin. Andaj edhe njëherë po e theksoj se në radhë të parë duhet bërë çmos të përkrahët një iniciativë të tillë, të bënë hapa konkret të bëjnë kërkesa të bëjnë presion pozitiv e kam fjalën, një energji pozitive, një reflektim pozitiv në këtë drejtim që qeveria të bënë ma shumë bashkë më ne për ta vënë drejtësinë në vend për të bërë riparimin e dëmeve të shkaktuara në radhë të parë viktimave, bashkë ndijim më ta realizim e të drejtave të tyre duke

përfshirë edhe shoqatën e veteranëve të luftës për cilët shpresoj se së shpejti do të bëhet diçka dhe ka sinjale pozitive kur pash se shoqata e tjera nuk I akuzojnë këta njerëz ashtu siç zakonisht tentohet të flitet e të përhapet e keqja përhapet shumë shpejt kurse ne duhet të jemi ata të cilët vazhdimisht të jemi karshi të së keqes, dhe mesazhet negative, tentativat negative ti shndërrojmë në një gjuhë të mesazheve pozitive dhe përpiqemi që procesin ta shpejtojmë, të baraspeshojmë mirë qasjen tonë rezonimin tonë karshi atyre të cilët ma se shumti pësuan nga lufta. Një komponent tjetër është pranimi publik çka nënkuptojmë me këtë komponent, viktimat, vazhdimisht do të kthehem tek viktimat, janë ata cilët kanë nevojë të madhe që ne si qytetarë edhe si shoqëri civile edhe si të ri edhe si gjyqësi të them sistem gjyqësorë edhe si është domethënë gjithë faktorët të relevant të rëndësishëm shoqërisë që ta kenë vëmendjen tonë. Ne të përqendrohemi tek ata, të bëjmë një pranim publik të gjendjes së tyre një pranim publik të rrefimeve të tyre trishtuara dhe në fakt në t'u japim hapsin që ata mos ta ndijën më vetën viktimë. Se duke e ndier vetën viktimë vazhdimisht ata nuk do të jenë në gjende të integrohen të riparohen t'u kthehet dinjiteti. Dinjiteti i viktimave do t'u rikthehet vetëm nëse shoqëria e Kosovës do të ndërmer hapa konkrete. Në radhë të parë hap konkret dhe i domosdoshëm është dëgjimi i zërit të tyre, krijimi i hapësirës për ta, krijimi i komisionit, mbledhja e fakteve natyrisht ne të cilët kemi ndërmarr që ta bëjmë përkrahjen e kësaj iniciative nuk do të jem atë cilët do të dënojmë, gjykojmë, por thjesht të mbledhim fakte ti ndihmojmë prokurorit në të gjitha vendet përkatëse ose respektive me informacion të bollshëm, me informacion të hulumtuar dhe të vërtetuar mirë të bëhet dëgjimi i dëshmitarëve dëgjimi kryesve të veprave penale në gjithë këtë proces unë jam shumë e sigurt që është shumë vështirë që gjithë ne këtu sa jemi të ndërmarrim hapa në atë drejtim dhe ta bëjmë punën tonë. Por gjithmonë duke pasur parasysh se kjo është shumë e nevojshme. Askush në as një moment nuk do ta bënë këtë në vendin tonë, në jemi atë cilët duhet ta bëjmë këtë hapin e parë dhe që pastaj bota e qytetëruar gjykata për krime luftë, gjykata ndërkombëtare e Hagës, organizata e kombeve të bashkuar edhe të tjera dhe në këtë rast në Kosove e kemi edhe EULEX-in, misioni i përgjithshëm mes të tjerash që në fushën e drejtësisë ta bënë edhe një ndërmarrje e tillë do më thonë hulumtimin, në përmbledhje, në gjetjen e fakteve dhe sjelljen e kriminelëve para drejtësisë. Secila zvarritje do të jetë edhe një mbyllje e një dritare të Kosovës karshi botës demokratike, siç u zvarrit pavarësia peng e Kosovës po e them ende peng për arsye se ende nuk është rrumbullakuar krejt deri më tani e kanë pranuar 58 shtete që nuk është pak për një kohë shkurtë megjithatë ka mbet shumë për tu bërë dhe në qoftë se dikujt ku do qoftë në rruzullin tokësor është nevojshme që të punon 24 orë për ne është nevojshme të punojmë 72 orë në mënyre që të japim hapsin dhe gjitha dilemat që ekzistojnë nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për ti hapur të gjitha dyert dhe dritaret e Kosovës duhet që ne të bëjmë shumë ma shumë dhe kjo me und të bëhet me një syçelëti, me një mendje të kthjellët me një vullnet të fortë për ta pa Kosovën në mesin e të gjitha shteteve që janë pjesë e organizatës të kombeve të bashkuara dhe forumet e tjera ndërkombëtare që kanë rendësi të veçantë. Për ta sforcuar këtë që po e them do ta përmend se fatmirësisht në vitet paraprake që nga viti 2006 tri organizata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Fondi për të drejtën humanitare në Beograd dhe pastaj gjithashtu zyra në Prishtinë, Qendra për Hulumtimin e Dokumenteve dhe një organizatë tjetër Dokumenta, këto pas një seri forumesh, takimesh dhe përpjekje, vendosen që të bëjnë një hap të ri që në kreativitetin e tyre në fushën e vënies të drejtësisë në vend ta zbulojnë para të tjerëve dhe që ftojnë më shumë organizata cilat do ti bashkëngjiteshin iniciativës rajonale për

krijim e Komisionit Regjional për përcaktimin dhe gjetjen e fakteve dhe është bërë mirë në të gjitha takimet që ka më pasur në disa vende në Sarajevë, në mal të Zi, Kroaci këtu në Kosove dhe kështu më radhë. Edhe pse tak tuk ka pasur mos pajtime kanë gjetur përkrahje të madhe natyrisht në të gjithat këto procese të cilat janë zhvillu shumë shpejt për arsye se për krijimin e një kesi soji Komisioni nevojitet kohë. Për një kohë kaq të shkurt është arritur mjaft. Janë mbi 150 individ dhe mbi 100 organizata të ndryshme cilat kanë dhënë përkrahje të fuqishme për themelimin të këtij komisioni ndër ato është dhe Partners Kosova. Unë kam qenë në disa forume dhe në disa takime që janë mbajtur, mandej edhe në trajnimet dhe them më plot përgjegjësi nuk kam ngurru ti bashkëngjitëm. Natyrisht gjithmonë duke e parapa faktin se ky është një proces në ndërtim e sipër dhe ende nuk është gjetur formë ula përkatëse. Këto komisione nga rasti në rast nëpër botë kanë emërtime të ndryshme. Natyrisht krejt kjo u baze të veçantive përfshirë nga rasti në rast nga konflikti në konflikt. Kurse në rastin e ish shteteve të Jugosllavisë duke përfshirë edhe Kosovën e cila është formë uar si shtet i ri ideja është që kjo këtu të jetë rajon thjesht që kryesit veprave penale kryesit e krimeve janë të ngjashmit të njëjtit nga vendi në vend dhe për ta arritur që të bëhet një vënie e drejtësisë e baraspeshuar mirë është menduar që ideja rajonale do ta realizon këtë. Në të kundërtën po të bëjë në mënyrë veçantë veç e veç atëherë do të ishte shumë vështirë që kryesit e veprave të njëjtat penale të silleshin para drejtësisë për arsye se ka nevojë për këmbimin e informacionit, për këmbimin e fakteve, për vërtetimin e tyre kjo e ka kuptimin e veçantë pse është themeluar si ide rajonale. Unë ma shumë s'do ta kisha zgjatë ndoshta e stërgjata pak por mirë qëllimi im është që ju ta keni më të qartë për atë është mirë që keni ardhur sot këtu në fakt ky do të jetë një bashkëbisedim për arsye se as njëri nga këtu nuk ka as njëfarë pronësie. Pronësia e vetmja në këtë çështje do të jetë pronësia e viktimave dhe grupeve të cilat pësojnë nga lufta më se shumti. Fjala e tyre është meritore kur se fjala e jonë, e gjithë neve, e gjithë juve është ndihmës, lehtësim i këtij procesi në krijimin dhe realizimin e një iniciative të tillë. Ju jeni të ftuar këtu që të debatoni dhe të jepni rekomandimet e tuaja përkitazi me një iniciativë të tillë. Faleminderit shumë.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë zonja Shukrije. Zonja Shukrije më shumë u fokusua te viktimat, faktikisht viktimat janë më të rëndësishmet në këtë proces, viktimat janë ato që përveç që duhen me ndje, me u liru prej një barre shumë të madhe, prej një jete të shkatërruar, ato duhen të trajtohen mirë. Edhe ky proces kjo iniciativë, kjo ide, pak a shumë ka me i sjell gjërat në vend, shumë peshq të vegjël pi quaj kushtimisht kriminel janë ende të lirë, shumë kryes të krimeve të vogla të mëdha, të vrasjeve të dhunimeve, çdo lloji të krimeve, ata janë hala të lirë ata punojnë ata jetojnë. Ata në çfarë do qoftë mënyrë duhet me u identiku duhet me u fakti. Viktimat janë ata që e faktojnë kjo është pak a shumë ideja kryesore këtij komisioni. Të dihet kush çka ka bë, me u dit emrat, faktet, me u dit ngjarjet, me u dit historitë e ndryshme të cilat janë përjetuar. Në momentin kur i dimë ato, kur i lexojmë shumë më lehtë është për me mendu përpara. Fëmija im, unë jam shumë i ri, ndoshta pas pesë viteve e bëj një fëmijë, por fëmija im kam dëshirë më pas një libër me lexuar me fakte. Jo një libër historik që është i efekt i politikës që shpërndan urrejtje. Faktet, faktet e bëjnë historinë. Fëmija im dëshiroj të dijë sa njerëz janë vra në Kosovë. Fëmija im dëshiroj të dijë si janë emrat e atyre që i ka bërë ato dhe ky komision pak a shumë këtë qëllim e ka, të dihet kush çka ka bërë në luftërat e fundit. Unë po flas për Kosovë, se vetë jam i Kosovës kuptohet se jam pak më shumë i lidhur emocionalisht. Çka është një rëndësi shumë e madhe ky

komision ka me i involvu plot faktor, ka mi involvu diku diku krejt popullatën. Secili prej neve ndoshta këtu edhe unë, janë viktimë indirektë, secili prej neve ka dikë brenda familjes apo farefisit të vetë kanë përjetuar njëfarë lloj dhunë, kanë përjetuar, ndoshta unë vetë ngaa ana e nënës time në Pejë kam të vvarë. Do më thonë secili prej juve keni dika viktimë, të njëjtën kohë na jemi të obliguar me punu për ata. Ata kanë nevojë për një përkrahje të madhe. Dika dika krejt Kosova është e vogël, lufta ka ndodhur në shumicën e territorit të Kosovës. Kështu dika dika krejt jemi të prektë prej luftës. Krejt e kemi interesin tonë për themelimin e një komisioni. Puna e modelit, puna e formatit janë që profesionistët, prokuroret, gjyqtaret e të tjerët, ata e bëjnë atë punë, por puna jonë është me e shty, me bë presion pozitiv gjithmonë që me ndodh kjo. Me u bo një komision i cili ka me dalë me një raport pesëqind faqe, një mijë faqe, me fakte, me storje edhe ka me dhënë rezultatet e veta. Kjo është pjesa që ne duhet më ja nis me uhabetit tonë. Mendimet e juaja janë shumë të rëndësishëm për neve, mendimet e juaja nuk janë veç për neve por për ekzistencën e këtij komisioni në të ardhmen kështu që un po e mare guximin më hape diskutimin më juve. E kemi teknikë tonë të cilët e sjellin mikrofonin deri tek ju edhe e falënderojmë shumë. Ndoshta ka më i ra me u sillë shumë, edhe besoj një me uhabet sa ma konstruktiv edhe më qenë debat. Çka do që keni të paqartë, edhe në qoftë se e kritikoni këtë iniciativë, edhe nëse e pëlqeni thuajeni lirisht. Hajde të bëjmë me uhabet. Ka po dëshirojmë me ja nis.

Lavdim Rizani: Faleminderit që ma dhatë fjalën dhe ndihem i privilegjuar se sot gjendem në mesin e tuaj,,më një temë shumë të rëndësishme që do të bisedojmë sot. Pra për krimet e kryera në ish Jugosllavi ne kemi njohuri por duhet edhe fakte. Pra ish Jugosllavia ka qenë e përberë nga disa republika siç ne e dimë, ose prej disa vendeve të ndryshme, ka pasur popuj të ndryshëm në ish Jugosllavi, e cila filloi të shpërbëhet nga viti 1991 dhe fillimi luftës në Kroaci dhe në Bosnjë. Mirëpo, më pas edhe në Kosovë. Do më thënë kemi pasur shumë çështje barbare që kanë ndodhur, mirëpo krimin me und ta shihnim në fillim kur në Ish Jugosllavi kishte një kushtetutë, një akt i shkruar që thuhet se çdo popull në ish Jugosllavi kishte me undësi për vetëvendosje. Mirëpo, që aty shihet krimi kur shqiptarëve ju mohohet vetëvendosja, ata nuk kanë pasur të drejt për vetëvendosje edhe pse ishte i shkruar një akt i tillë. Kemi mundur të shohim që janë kryer krime në Kosovë, deri në luftën kur përçarja erdhi në një masë të madhe, ku shumë njerëz nuk pajtoheshin me krimet dhe me ngjarjet që ndodheshin, edhe do më thonë, dolën publikisht para popullit dhe e shpallen një ushtri të vetën. Që aty filloj çështja më barbare që ndodhi diku rreth vitit 1998 në Kosovë. Kemi krime të kryera shumë në Kosovë, kemi masakra të ndryshme por duhet të kemi edhe fakte për këto masakra, duhet ti gjejmë akterët kryesor të cilët kanë qenë këtu. Mirëpo jo çdo herë duke i balancuar kryesit e krimeve më ata që kanë pësuar krimet. Duhet të ndahen veç. Domethënë kryesit e krimeve duhet ti kemi parasysh që ata janë njerëz barbar dhe ata që kanë pësuar krimet nuk me undë të barazohen në të njëjtën mënyrë me ta. Kjo është çështja që paraqesim ne këtu duhet të flasim shumë ma lirë do më thënë për këto gjëra deri më tash.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë një aspekt tjetër që ky komision do të qartësoj e kristalizoj është moment kur kolegja e tha. Do të thotë kur e dëgjon ti një serb, ai serbi kur nuk mundet të pranoj, faktikisht bëjnë krahasime mes krimeve. Me undohen në çfarë do formë ti

krahasojnë krimet që i kanë kryer serbët ndaj shqiptarëve dhe shqiptarët ndaj serbëve. Ky Komision do të nxjerr fakte, shifra, numra, do me thënë, këtë të mirë e ka ky komision. Faktikisht kur flasim me fakte kur del një komision rajonal që përbëhet ndoshta edhe prej shtetit kryes të krimeve atëherë ka me qenë shumë më serioze. Mendimet tjera ju lutëm.

Naser Lajqi: Fillimisht përshëndetje, është një nder të marr pjesë në një konferencë të tillë në një konsultim që ka të bëjë më viktima të luftës, kështu që unë nuk do të ndalem në ato se çka ka ndodhur, dhe ne të gjithë e dimë se çka ka ndodh kështu që unë pak a shume kisha disa rekomandime për këtë komision, i cili tentohet të krijohet. Një prej rekomandimeve është që kemi shumë fakte të nxjerra nga viktimat e luftës, mirëpo çka është bërë me ato fakte dhe sa është punuar nga gjyqësia e UNMIK-ut e cila ka qenë deri më tani bashkë më gjyqtaret tonë. Ajo çka duhet të kërkonim ne si komision që tentojmë ta krijojmë është të kërkojmë nga gjykatat, tash është EULEX-i, nga trupi i EULEX-it të krijohet një gjyqësi e cila do të merret më këto fakte. Dhe ne si shoqëri civile ti marrim ato fakte dhe të dhënat të cilat janë dal nga viktimat e luftës ti shqyrtojmë se a janë përpiluar dhe a janë përfill gjitha ato që kanë dal. Një rekomandim tjetër është se shumë familje apo shumë viktima kanë pësuar gjatë luftës dhe nuk marrin asnjë informatë. Shkojnë individët dhe i pyesin, është shumë lehtësuese për ta, kur shkon dhe i pyet dhe atë e shpreh atë çka e ndjen, atë çka i ka ndodh. Mirëpo çka bëhet mandej askush nuk shkon për ta vizituar. Ata nuk kanë asnjë informatë se çka ndodh me ato informata që i ka dhënë një individit të caktuar qoftë gjyqtar, apo qoftë organizatë e cila merret me hulumtimet të tilla. Në kemi shumë individ të cilët janë caktuar me emra për krime luftë dhe çka është bërë deri më tani, ata sillen sot nëpër vende të ndryshme nëpër Serbi e nuk arrestohen nga askush. Ne e kishim një rast shumë të freskët para dy vitesh në Pejë kur një person i cili ka kryer krime luftë vije me përcjellje të UNMIK-ut, për ta vizituar pronën e tij afër fqinjë të cilët i ka vra e i ka masakruar, kështu që edhe përkundër reagimit të tij tek pas disa orëve kur duhet të ndërhyt edhe kryetari i kome unës dhe kryetari i gjykatës qarkut të Pejës. Dhe më në fund pas pesë-gjashtë orëve ai arrin të arrestohet. Dhe çfarë ndodh mandej nuk ka kurrfarë informate a u dënua a është liruar apo ku ndodhet ai person. Domethënë ajo çka i duhet këtij komisioni është të jetë në kontakt të vazhdueshëm jo vetëm me proceset gjyqësore por edhe me këto familje. Institucionet tona nuk janë duke bërë atë çka duhet, është shumë lehtë kur është një përvjetor të shkosh. Unë më tepër ato i shoh si një keqardhje të institucioneve tona për atë ditë, që vetëm atë ditë i vizitojnë familjet. Asnjëherë nuk i vizitojnë ato familje për të parë si jetojnë, cilat janë hallet dhe bregat e tyre. Nuk duhet ti shikojmë këto familje këto viktima me keqardhje, por ne duhet ti shikojmë me mburrje dhe të jemi krenar që të paktën kemi pasur njerëz tillë të cilët janë flijuar për këtë gjë. Nuk guxojmë të lejojmë t'ia hedhim topin njëri tjetrit, nuk guxojmë në këtë rast ma tepër ata që i kundërvihen njëri tjetrit me luftë, se dihet që janë shqiptarët dhe janë serbët. Nuk guxojmë të përgjithësohen, në çoftë se në do të përgjithësohen ti themi në popullit serb se ju jeni kriminel ose ata neve se ne si popull shqiptar jemi kriminel, dhe mendoj se gjenerata e gjenerata të tjera do të shkojnë dhe do të shohin njëri tjetrin me sy të armikut. Mirëpo duhet ti saktësojmë ti gjejmë individët në qoftë se e ka kryej për shembull: Në qoftë se një person në rrethin ku unë jetoj e ka krye një krim luftë atëherë nuk duhet të fajësohet krejt rrethi por të thuhet se ky person ka kryer krime luftë dhe ai të vendoset para drejtësisë. Atëherë ne kur i identifikojmë këta persona, a dënohen këta persona por në të njëjtën kohë dhe familjarët e tyre a janë të informuar

me procese që po vazhdojnë deri në fund. Atëherë dita ditës kjo urrejtje që është tani dhe ky sy armiqësisë që si e shohin njëri tjetrin do të jetë më i vogël. Nuk me und të them që ndoshta do të harrohet shumë shpejt se duhet vite e vite të tillë të harrohet por mirëpo sa do pak të zbusim këtë sy të armiqësisë. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Fjalja e fundit e kolegut është harrimi. Nuk duhet me u harru gjërat, ky komision ka me pas gjëra të veçanta edhe për memorialet, mënyrat e memorialeve dhe se këto gjëra mos të harrohen. Se në momentin kur ti shkon në memorial të kujtohen gjërat e mëson historinë e re faktikisht këto memorialë, këto kujtime nuk kanë me na lejuar me bo gabime prapë. Po kthehem te shembujt lufta e dytë botore, Izraeli në krejt botën ka memoriale, një investim shumë të madh e ka bo në këto memoriale. Kjo nuk bën të harrohet. Nuk do të thotë që ne tash pas 342.000 vjet me thënë shiko çka na keni bërë ju e tash na po hakmerremi. Por gjërat nuk bën të harrohen. Dikush tjetër.

Ylber Maxhuni: Unë jam Ylber Maxhuni prej organizatës „Youth Step” nga Vushtrria.
Kushtrim Koliqi: Ylber, Ylber, a kish pas me undësi më fol në këmbë pasi që

Ylber Maxhuni: S’prish punë, edhe unë e ndjej vetën të nderuar që jam pjesë e këtij debati. Mendoj se nga ajo çka u tha në këtë mënyre vyen të dënohen kriminelet të luftës edhe të përgjigjen para drejtësisë. Unë mendoj se duhet të bëhet një bashkëpunim shumë më i thellë dhe të jetë ndër shtetëror, sepse për shembull interesi jonë është ti gjejmë kriminelët e luftës dhe të vijmë para drejtësisë. Mirëpo ka kaluar një kohë e gjatë, kanë kaluar 10 vite dhe njerëzit nuk me und ti njohin ata që kanë kryer krime. Detyra jonë është që të mbledhim faktet ti dorëzojmë faktet, por përgjegjësia e shoqërisë serbe, qeverisë serbe është që të bëjë evidentimin e grupeve të cilat kanë operuar në Kosovë. Që ti gjejmë ata që kanë kryer krime, ndërsa mendoj se duhet të krijohen disa grupe të cilat do të punojnë në regjione në mbledhjen e evidencave nëpër regjione, sa regjione kemi në Kosovë. Pesë regjione dhe ato grupe të jenë prej neve të komisionit. Kaq kisha, këto janë rekomandimet e mia kisha dashur të theksoj se është hera e parë që marr pjese në këso debate.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë. Shumë shkurt Bekimi dhe menjëherë fjala tek ju, se ka lidhje më atë çka bisedoj kolegu.

Bekim Blakaj: Faleminderit Kushtrim. Me ua po më bën optimist fakti se jeni kaq të interesuar në këtë debat, dëshiroj edhe njëherë të ju falënderoj të gjithëve. Në fakt krejt çka thatë të gjithë prej juve keni drejt sidomos prej Peje, Syri i vizionit” disa çështje të cilat janë më të vërtet të rëndësishme. E përmenda që ekzistojnë shumë fakte, mirëpo çka ka bërë gjyqësia. Pajtohem me ty, sidomos me kolegë të Juridikut ndoshta me und ta kenë informacionin se tash 10 vite pas përfundimit të luftës në Kosovë vetëm dy akt gjykime në formë të prerë janë sjellë prej gjykatave këtu në Kosovë, gjykatësve ndërkombëtar për krime luftë është fjala. Është dënim i vogël dhe aspak nuk i kënaq familjet të viktimave. Prandaj në fakt komisioni është shumë është i domosdoshëm, unë mendoj se është i domosdoshëm për ndryshe komisionet nga përvoja e vendeve të tjera. E sot pas ditë konkretisht do të flasim për këtë, e sesionin e fundit do të flasim konkretisht për Komisionin Rajonal KOMRA-n janë trupa jo jashtë gjykatave të cilat i trajtojnë krimet e luftës dhe i nxirin të vërtetat nga atë se çka ka ndodhur në të kaluarën. Domethënë.

kurrresi nuk duhet mi pa komisionet si zëvendësim i gjykatave sepse gjithsesi gjykata duhet mi krye punën e tyre. E përkundrazi në shumicën e rasteve në historinë e komisioneve, komisionet kanë japë një ndihmë shumë të madhe për gjykata duke ju ofruar sepse çdo komision në fund ko më nxjerr një raport detal për gjetjet e tyre që kanë gjet në terren e kjo ndërlihdhet me ato që tha zotëriu Maxhunaj. Komisionet janë instrumente hulumtuese në terren, fakt mbledhëse e ato fakte pastaj do të bëhen publike edhe gjykatat respektivisht prokurorit do ti kemi dhe besoj që ajo do të ishte një ndihmesë e madhe edhe për procesimin sa ma të madh të kryesve të veprave. Mos ta kuptojmë komisionin si diçka që i zëvendëson gjykatat e për rastin konkret do të flasim pasdite besoj në sesionin e fundit edhe shpresoj që kemi më pas hapsin për të debatuar ma shume. Në rastin konkret ende ky proces është tek në fillim. Prandaj po organizohen këto konsultime që të njoftohet opinioni sa ma i gjerë sidomos shoqëria civile, të rinjtë e kështu me radhë edhe të merren idetë prej tyre sikur se cili do të ishte ma i suksesshëm mandatë i Komisionit Kompetencat dhe kështu më radhe. Besoj që pas pauze do të flasim ashtu ma detajuar për përvojën e komisioneve të tjera që deri tani janë formuar dhe e kanë përkundu punën e tyre. Më falni që isha kaq i gjatë por me u deshtë të flas.

Kushtrim Koliqi: Liridoni.

Liridon Jetishi: Së pari ju përshëndes quhem Liridon Jetishi edhe njëherë po prezantohem, dihet se në debat jemi ftuar për me fol për viktimat të cilat janë dhe kanë ndodhur në të gjithë territorin e ish Jugosllavisë. Pra viktimat tek ne Kosovë me und të themi lirisht se nuk kanë kurrfarë përkujdesje institucionale. Një ndër viktimat që me und të japin fakte direkte kundër çdo gjykimi ose kundër shtetit, i cili ka kryer krime të cilat nuk përfshijne kurrfarë konvente ndërkombëtare janë të burgosur politik. Sepse unë vetë me und të marr një sërë deklarata të cilat direkt shprehen nga çdo individ, cili paraqet shkeljet themelore apo shkeljet më të rend atë cilat i ka kryer okupatori, por në varg të këtyre fakteve kemi edhe krime të ndryshëm cilat vijnë nga familjet e të pa gjeturve kur ju ka marrë prindërit vëllai motra apo dikush i afërm të familjes se tyre dhe kanë qenë direkt në atë rast. Kështu deri më sot pa marr parasysh kush i ka shikuar këto krime ka pasur pak a shumë lirisht mundem më thonë se kanë has në sy të gjelbër. Dëshira jonë është se këto fakte t'u ofrohen edhe si opsion ti arrijmë si komision ose si grup që do të formohet sot e tutje për shembull, që t'u japë ma shumë sy botës çka ka ndodhur në Kosovë. Kur dihet, një kohë shumë e gjatë me William Walker deklaroi se këtu po kryhen krime kundër njerëzimit, edhe pse ato kishin ndodhur edhe ma herët, do të thotë dihet se po duhet një punë shumë e madhe me argumentuar ato çka ka ndodhur këtu. Për mendim timin pika e parë ka qenë, ne si komision ose kushdo që formohet sikur komision të merret me të burgosurit politik sepse dihet që masakra e Dubravës është një nga parashikimet jashtë normale që mundet më ndodhe mbi njëzimin. Sepse një i burgosur po shkon për riedukim, risocializim nuk shkon aty të përjeton dhuna të ndryshme edhe këto pikërisht ajo çështje e cila duhet të kujdesemi çka ka ndodhur aty, dihen rrahjet që kanë ndodhur në Lipjan, dënimet të ndryshme në Kosovë. Pra kemi tema gjera të cilat unë vetë i kam përjetuar në familje por edhe në shoqëri afër katundit tim ose diku tjetër, Kaq Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Komisioni ka me u marr me gjitha llojet e viktimave, duke përfshirë edhe të burgosurit politik, kështu trajtimi ka me qenë ekskluziv. Faktikisht gjatë ditës së sotme ne kemi me fol për përvoja të vendeve të tjera, përvoja e Argjentinës, përvoja e vendeve, qysh kanë

kaluar këto komisione, sa të suksesshme kanë qenë këto komisione edhe tani domethënë pjesa e fundit duhet me qenë edhe ideja më e kristalizuar para juve për KOMRA-n, iniciativën e komisionit rajonal, për këtë jena mbledh sot këtu. Zotëria këtu.

Edmir Sejdiu: Faleminderit shumë unë jam Edmir Sejdiu kisha me u ndërlidh në fjalën që e patë zonja Shukrije Gashi, për përkujdesjen më të madhe të viktimave dhe familjarëve të tyre, me und të zbardhet fati i viktimave dhe të zhdukurve, atëherë unë do të thosha se nuk është mirë që të bëhet një bisedë e tillë do të thosha këtu e mos të merret diçka çka nuk punohet në praktik. Në rast se ne bëjmë një plan këtu dhe nuk shkojmë të rrimë me të afërmit familjarë të tyre atëherë ne realisht nuk do të dimë gjenden e tyre. Në rast se ne do të shkojmë nëpër fshatra të ndryshme dimë se cilat familje janë prekur nga krimet, ata janë të mbyllur në një dhomë shumë të errët në vetvete, atëherë çka do të bëjmë ne të shkojmë të bisedojmë më ta sepse një fjalë ose një fjalë e rastit arrin ti çliroj brengat dhe ata do të dinë të çlirohen pak në një mënyrë dhe do të dinë se dikush po brengoset për ata. Dhe tha shumë mirë zonja, se në Mitrovicë faktikisht në lagjen e Kovaçëve është bërë një inaugurim ose ashtu diçka dhe nuk ka marr pjesë askush për ti shikuar ata. Ata me und ta ndjejnë veten të anashkaluar nga shoqëria ose nga rrethi i jonë ku po jetojmë, faktikisht ne duhet të bëjmë shumë të debatojmë me ta, t'iu tregojmë atyre se edhe ne përjetojmë në një mënyrë dhimbjen e tyre, ti tregojmë se ne jemi se bashku me ta në rrugën për zbardhjen e fatit të viktimave. Po një gjë tjetër që është, krimet si do të zbulohen atëherë neve u cek edhe ma herët nga zonja për bashkëpunimin me minoritetet të ndryshme. U pa ma herët u cek në ish Jugosllavi krimet, në Kroaci në Bosnjë, në Slloveni, dhe tek ne në Kosovë, atëherë kryesit po thuaj janë të njëjtë për gjitha këto krime, janë ata që kanë marrë pjesë edhe në Kroaci, edhe në Bosnjë pastaj edhe në Kosovë. Atëherë ne duhet të kome unikojmë të gjithë se bashku sepse një ndihmesë e vogël nga secila pjesë atëherë si thuhet, nga një pik nga një pik mbushet pusi, ashtu do të ndodh edhe këtu. Besoj se do të merret diçka atëherë do të zbulohen të gjitha, normalisht nuk duhet në ngritet ndonjë urrejtje, ose një serb ka bo krim në Kosovë me të njëjtën mënyrë ti kthehet një kosovar një serbi. Atëherë mendoj që do të bëhet një tryezë të debatohet me të gjithë dhe kjo do të çoj deri tek zgjidhja e një problem i cili është bukur i madh.

Kushtrim Koliqi: Domethënë përkujdesja ndaj viktimave, dinjitetin që e përmendi zonja Shukrije, për informata të juaja ka shumë shoqata të dala nga lufta siç është shoqata e viktimave, të pagjeturve që janë të involvuar në këtë proces. Kanë me ndodh edhe shumë konsultime dhe me atë target grup, me ata njerëz të cilët direkt kanë qenë të prekur. Në këtë vargun e këtij cikli prej 10 konsultimeve plus një rajonale, ka me pas konsultime të veçanta me ata që të dëgjohet zëri i tyre. Faktikisht ne asgjë nuk bëjmë këtu nëse nuk dëgjohet zëri i tyre. Ne kot mblidhemi këtu nëse nuk merren parasysh zëri i viktimave në lidhje me krijimin e këtij komisioni. Viktimat kanë kaluar në procese shumë më të renda se dikush për shembull: Unë personalisht ndoshta, dikush më është vrarë ose diçka ngjashëm, por unë personalisht nuk jam shumë i atakuar, domethënë ajo ka prioritet më shumë se unë Kushtrimi, zëri i tyre. Definitivisht ata janë të harruar, definitivisht ndoshta edhe të keqtrajtuar diku diku, ndoshta keqtrajtohen nga aspekti politik, kur ka fushata zgjedhore thënë më shpesh e tjera dhe tjera, por faktikisht dinjiteti ka me iu ngrit me këtë Komision. Një prej pikave të cilat ky komision në raportin e vetë do të bëjë është që do të bëjë konkludime, rekomandime, sugjerime të veçanta për memoriale, për mënyrën si

duhen trajtuar ata, mos të mbeten ata një grup i marginalizuar për të keqen e shoqërisë, por ata me qenë krenarie e jona. Ata me u ndje mirë kur ulesh me ta jo të... çdo herë që takohesh me ta, ata ankohen që e kanë me drejtë, sepse askush nuk kujdeset për ata. Po vazhdojmë zonjusha...

Florentina Hajdari : Jam Florentina, nga shkencat politike pajtohem plotësisht më zotëri Me ujën kur tha më herët se ndonëse faktet dhe argumentet ekzistojnë ato në njëfarë formë po shkojnë tutje në njëfarë heshtje, askush nuk me und ti bie në fije. Ndonëse familjet e dëshmorëve janë determinanti kryesor i grumbullimit të këtyre fakteve ata nuk janë këtu dhe nuk dinë se si është duke ecur tutje ky proces. Në njëfarë mënyre të flasim hapur dhe të bëjmë debate të këtilla është një hap tutje por bashkëpunimi më media është një gjë kryesore, ndonëse familjet e dëshmorëve do ti bënë të dinë se zëri i tyre ka pas jehonë. Edhe ky proces është duke u zhvilluar dhe faktet dhe argumentet që ata i kanë jep dikush tjetër është duke i dëgjuar e jo vetëm ata që janë të involvuar në këtë proces të ngushtë. Faleminderit..

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë. Zonja Shukrije një koment.

Shukrije Gashi: Faleminderit shumë për një qasje kaq konstruktive. Është fakt se në anën e viktimës ekzistojnë të gjitha argumentet, të gjitha faktet dhe fatkeqësisht të gjithat këto fakte, argumente që i posedojnë viktimat në vendet të tjera dhe në Kosovë, ende nuk kanë arritur të dalin në sipërfaqja në formën e duhur, në qasjen e shoshitur ato janë ende nën pluhurin e harresës në mungesëtë pakujdesisë të shoqërisë civile dhe qeverisë së Kosovës. Pse po ndodh kjo pse në po ngadalsohemi në proces, faji kujt është faji i yni, ka rrezik se këto fakte madje dhe të vjetërsohen, dhe për të gjithë ata që ja juristët e dinë se çka duhet më thonë vjetërsia e lëndës. Në qoftë se ne nuk jemi ata që ti ndihmojmë ata viktimat ti iniciojmë në rastet të tilla, që të gjinden kryesit e këtyre veprave penale. Atëherë argumentet mënyra me undësia e argumentit do të eliminohet dhe me këtë do të harrohet dhe historia. Dhe përsëri ka rrezik potencial që të na përsëritet e kaluara, një e kaluar që qon kah konfliktet e reja dhe thjeshtë injorimi i Ballkanit dhe përjashtimi i Kosovës dhe të gjitha vendeve të tjera nga hyrja e shtetet në bashkësinë nga shtetet të cilët janë demokratike. Askush s'ka kohë që të na pret ne më vite të tëra. Në duhet të ngutemi shpejt mos për kurr gjë tjetër thjesht për hir të viktimave, vetëm për hir të viktimave. Faktet ekzistojnë janë të bollshme janë të mjaftueshme, viktimat janë të gatshme të dëshmojnë këtë e kanë dëshmuar disa here çka nevojitet, nevojitet vullneti jonë dhe mekanizmat të cilat do t'ia mundësojnë mënyrë të shoshitur të baraspeshuar mirë të argumentohet drejtësia, të argumentohet e vërteta, kryesit e veprave penale të dënohen. Por në qoftë se ne më hezitime më dyshime se me und të ndodh ashtu apo kështu nuk është qasja e duhur në do ta zvarritim këtë proces s'do të bëhet asgjë. Shumë thjesht nuk do të bëhet asgjë. Kemi dhe organizata cilat kanë kredibilitet në Kosovë, këshilli për mbrojtën e drejtave të njeriut i cili ka bërë një punë të mirë me vitet të tëra, Fondi për të drejtën humanitare, Partners Kosova, Integra, Rrjeti i grave të Kosovës dhe organizatat të tjera cilat kanë bërë dhe bëjnë një punë të madhe në Kosovë. Mirëpo këto duhen të dalin në sipërfaqe duhen të dalin të zëshëm të gjithë ne duhet të flasim me një zë. Me zërin e arsyes në mënyrë që iniciativa e tilla të përkrahen. Shfrytëzoj këtë rast dhe të theksoj se komisioni, themelimi i komisionit është përgjegjësi primare e qeverive të tyre shteteve të cilat kanë qenë të përfshira nga lufta. Mos të mendoj askush se ne jemi ata që do ta themelojmë komisionin. Assesi se nuk është përgjegjësia e jona nuk është kompetencë e jona, e jona është

vullneti i mirë, dëshira për ta ndihme uar një iniciativë të tillë dhe thjesht është e jona se nëpërmes vendosjes drejtësisë t'u kthehet dinjiteti i viktimave dhe për këtë kemi argumente të mjaftueshme. Nevojitet vetëm energji pozitive, reflektim pozitiv, bashkëpunim ma i fuqishëm, ma i madhe dhe shtytje pozitive karshi qeveris. Qeveria që ndërmer diçka që të niset konstruktimi apo themelimi i këtij komisioni.

Bekim Blakaj: Faleminderit Shukrije. Në mungesëtë Kushtrimit unë do ta moderoj këtë tryezë të rrumbullaket për një kohë të shkurt. Më vjen mirë diçka, se nga shumica e juve që folët sot u nis nga pikënisja e viktimës. Në fakt ideja këtë e përmendi Shukrija disa herë, ideja është se ky komision absolutisht të merret me viktima. Është diçka interesante gjykatat sigurisht që merren më viktimat mirëpo fokusi i tyre nuk janë viktimat. Fokusi i tyre është me gjet prova të mjaftueshme për të dënuar një kryes të veprës, çka është gjithçka në rregull. Mirëpo pastaj atyre nuk ju intereson shumë çështja e viktimave të shprehem në mënyrë banale siç u shpreha. Komisioni dot kishte një qasje tjetër ndaj viktimave, gjithmonë pe përmendi pas pasues do të flasim për provoja e të tjerëve. Mirëpo gjithmonë rekomandimi kryesor i Komisioneve ka pasur të bëjë me viktimat, me reparacionin, ose dëmshpërblimin e viktimave. E kjo nuk do të thotë që shpërblimi është material në të holla, ka mënyra ma të ndryshëmve shpërblimeve, siç janë ngritja e monumenteve, caktimi i ditëve komemorative, për viktima, kërkimi faljes, në fakt pranimi, Nëse më lejoni shkurtimisht dua me ju tregu se gjatë punës në terren një kohë të gjatë, përndryshe Fondi për të Drejtën Humanitare siç e përmendi pak parës Shukrija si dhe shumë organizata të tjera bënë hulumtime në terren dhe është në kontakt ditor me viktima, Është një hierarki e nevojave të viktimave, ata kanë drejt me dit se çka ka ndodh me të dashurit e tyre, pse ka ndodh, çka ka qenë motivi për me u ju bo dikush keq atyre, kanë nevojë për përgjegjësi kanë nevojë me pa atë që ju ka bo dëme, në burg, para gjykatësit pastaj në burg. Kanë nevojë për dëmshpërblim e pastaj me und të flasim ne për ndonjë pajtim i cili është i domosdoshëm. Mirëpo pa këta hapa paraprak kurrë gjithsesi nuk e besoj se me und të vjen deri tek pajtimi para se ti kalojmë këta hapa. Po e shoh një dorë të ngritur atje Urdhëroni.

Liridona Neziri: Jam Liridona Neziri vijë nga Gjakova desha me dhënë një koment rreth organizatave. Për mendimin tim së pari si një punëtoare sociale, së pari duhet të bëhet aftësimi apo këshillimi i popullatës se çfarë ndihma jep organizata, çfarë me und t'u ofroj, çfarë këshillime me und të bëjë organizata. Sepse shumica nga popullata mendojnë se nga organizatat me und të marrin ndihma humanitare, para ose sende të tjera. Shumica nga tyre nuk e dinë që organizata me und të ofroj këshillime për këta njerëz se çfarë kanë pësuar gjatë luftës. Dhe kisha thonë së pari që me u bo aftësimi i njerëzve.

Kushtrim Koliqi: Veç pak të sqarohem, a e ke fjalën për Komisionin si organizatë apo çfarë organizatë të sqarohemi.

Liridona Neziri: Në përgjithësi organizatat, edhe për këtë komision edhe për organizatat të tjera. Se popullata nuk e dinë çka një organizatë me und të ofron dhe nuk e dinë vlerën e një këshilluesi sa me und të them vlerën e një punëtori social ose një psikologu. Shumica e popullatës e mbajnë të mbyllur ato çka ka ndodhur gjatë luftës, nuk e shprehin sepse nuk e dinë qysh me u qas atyre, nuk kanë besim tek ai person. Për shembull nëse apo pasnesër më ardhur

tek unë nuk kanë besim me u shpreh ata çka kanë përjetuar e duhet mi gjet një qasje për me t'iu afruar atyre personave. Ky ishte mendimi im.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë, e ki prekur një qasje shumë të rëndësishme, informimi masiv. Njerëzit në Kosovë janë shumë pak të informuara së pari më procesin si proces, me ballafaqimin me të kaluarën. Shumë pak të informuar me koalicionin me idenë e koalicionit, edhe për atë fatkeqësisht edhe po bëhen këto konsultime. Edhe përveç këtyre konsultimeve ka edhe shumë ideja të tjera Rajonale, të cilat kanë të bëjnë direkt me informimin e masës. Së pari për Komisionin dhe ballafaqimin me të kaluarën, informimi në Kosovë me ungon, në bazë të hulumtimit që e kemi bo na bash për ballafaqimin me të kaluarën informimi është në nivelet ma të ultë. Ata sigurosh që e dinë për luftën për viktimat ama procesin si proces nuk dinë me e zbërthye. Faleminderit. Kush, kolegu.?

Nazim Maxhuni: Faleminderit Kushtrim. Jam Nazim Maxhuni prej Shkencave politike desha me u ndërlidh bash për këtë temë që e ceki kjo kolegia këtu afër. Të gjithë e dimë çka ka ndodhur në Kosovë dhe shumë luftëra tjera në ish Jugosllavin. Problemi te informimi është se për shembull unë personalisht kam kontakte më mediat, kam parë se gjithmonë me ungojnë debate të tilla për këtë çështje, për këtë debat. Më shumë i kushtojnë rëndësi sendeve tjetra se kësaj për me pa sendet, çka ka ndodh dhe tek, dhe për ta informuar opinion në përgjithësi. Konkretisht unë mendoj dhe garant dhe kolegët të tjerë pajtohen me me ua, që problemi është krejt të mediat qofshin elektronike, apo radiot, shtypi-gazetat. Kaq desha të shtoj, më shumë skam çka. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Koalicioni dhe vetë Këshilli Koordinues partneritetin dhe bashkëpunimin me media e sheh si prioritet goxha të veçantë. Vetëm për këtë arsye për informim. Informim masiv, do të ketë projekte me strategji të veçantë të ndërmarra vetë prej koalicionit prej anëtareve të koalicionit për këtë qasje. Komisioni është një projekt shumë ambicioz. Një projekt duhet me ditë me miliona njerëz, se territori i ish Jugosllavisë e përbëjnë territorin më miliona njerëz kështu që faktikisht shumica prej këtyre duhen me ditë për ekzistimin e komisionit, çka është ky komision. Kështu që bashkëpunimi me media dhe produktet, produksionet mediale kanë me qenë një mjet shumë i rëndësishëm i këtij koalicioni për informim. Zonja Shukrije.

Shukrije Gashi: Prapë, më qëllim të ndihmoj këtë bashkëbisedim tonin, ajo studentja apo vajza që e shtroj pyetjen ma herët. Përkitazi mënyrës me të cilën duhet ti qasemi viktimës, vetëm sa për informim me und të them se ekziston Qendra për rehabilitim e viktimës. Qendra për rehabilitim të viktimës dhe torturës të cilën qendër udhëheqë Feride Rushiti. Kjo organizatë bënë një punë të mirë dhe besoj se do të ishte mirë që aty të drejtoheni domethënë se për secilin segment që është pjesë ekzistojnë OJQ dhe institucionet shtetërore në të cilët me und të drejtohen viktimat. Një çështje tjetër të cilën desha ta theksoj lidhet me informimin dhe transmetimin e informatës, përcillja e informatës nga ana e mediave. Do të ishte mirë ta luani një rol ofrues, bashkëpunues në këtë iniciativë dhe jo një rol destruktiv i cili do të bëhet pre e dallimeve dhe ngjyimeve politike. Në fakt ky proces duhet të shikohet dhe të trajtohet si proces jo politik në mënyrë që qytetarët ta kenë lirinë vullnetin dhe dëshirën që pa asnjë ngurrim ti bashkëngjiten pa marr parasysh rezervat individuale që do ti keni, shpresoj që siç e tha Kushtrimi në të ardhmen e

afërt do të organizohet një tryezë e ngjashme vetëm për mediat dhe mediat do ta kenë mundësin ta kuptojnë rendësin dhe rolin e transmetimit të informatës të saktë. Për neve prova janë viktima direkte, cila për shembull në Kosovë ngurrojnë edhe me u shpreh është varg i gjerë dhunimeve të cilat i ka krye okupatori, edhe ato femra sot nuk guxojnë me u shpreh pse shoqëria thotë jo distancimi në shoqëri dhe probleme tjera të caktuara. Krejt problemi është qysh me ju qasë viktimës. Komisioni nuk ka nevojë për shembull tu e dit se ku duhet me shkuar, në cilën bazë me shkuar me shkel në dërrasa të kalbtë qysh thotë populli. Më mirë me shku me hapa të sigurt me dit kë me studiu është problemi se viktima direkte ka një përcaktim qartë çka ka ndodh. E kemi e kemi shumë shumë raste për cilat duhet me fol, muaj me thënë nuk del një debat siç tha parës 72 orë por një shekull. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Dikush tjetër. Pas zonjushës kisha pasur qejf edhe zotëri Abdullahi me dhënë mendimin e tij se është një prej njerëzve që ka punuar shumë me viktima. Edhe puna e tij është shumë e rëndësishme.

Blerina Osmani: Po ju dëgjoj me shumë vëmendje po më vije mirë vetë arsyeja pse kemi ardhur është arsye humane, dhe ne si sociolog merremi me këto gjëra shumë më konkret. Kam pak një problem të jam pak e sinqertë. Unë e kam problemin te konkretizimi. Mirë është motivi jonë, mirë është vullneti jonë por ndonjëherë më të rëndësishme janë mekanizmat, u përmenden por për me ua mekanizmat në këtë rast janë të rëndësishme. Kisha dashur në mesin tonë sigurisht këtu të kemi juristë apo studentë të juridikut të jenë më konkret edhe ndaj meje si sociologe. Cilat hapa deri më sot ka marr një iniciativë tjetër por me një fakt konkret me një person konkret që ka bë një krim? Cilat etapa kemi vazhduar ne sepse jemi të sigurt që pas 10 viteve nuk jemi tryeza e parë, ka pasur edhe emra edhe sigurisht shifra që po përmenden se cilat hapa janë ndërmarrë edhe ne si diçka e re si një iniciativë e re të marrim ndoshta shembull pak nga historia, ajo është një sugjerim i imi unë jam përndryshe student e Universitetit të Vjenës, sot si austriak atje unë ende shoh me sytë e mi qe historia ende flet, unë deri sot nuk pashë krenarë austriak për prejardhjen e tij. Të kthehem prapë në sociologji, e përmendi zotëria këtu që emrin nuk po ia di, përmendi termin stabilitet prapë te konkretizimi që po kërkoj. Të lutem, ne të gjithë që jemi këtu vetëm një herë ta imagjinojmë një situatë, gjykatat tona vijnë në situatë pas një kohe shumë të gjatë që një kriminel serb në mesin tonë del para gjykatës sa mendoni që ne si ballkanas që shquhemi ndoshta për pak ngrohje të brendshme ta quaj ashtu një gjak ngrohtësi, sa mundemi ne si shoqëri të jemi stabil? A ka me pas një destabilizim të shoqërisë? Do të thotë a do të mundemi, për veti jam nga Podujeva jemi shumë afër kufirin serb, të jemi vetëm ma konkret të jemi vetëm ma konkret dhe ti mendojmë hapat prapa ajo është një sugjerim i imi. Me kaq.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë edhe pse pata pak vështirësi edhe me të kuptu veç ma merr menja që do të mundohem për më të mirën. Për me u bo pak ma konkret Kosovë dhe në rajon ka shumë organizata, po më vjen keq që nuk paske dëgjuar, por ka shumë organizata serioze që kanë punuar në mbledhjen e fakteve që kanë punuar direkt me viktimat...tash..jo jo tash dua të dal te konkretizimi i idesë, ideja këto kanë vepruar si organizma të veçantë Fondi për të drejtën humanitare ka bo një punë shumë te madhe por ka punuar si Fond. Ideja tash për themelimin e këtij komisioni ka ardh prej çfarëdo organizate që ka punuar me ballafaqimet me të kaluarën kjo është pak a shumë që ka me u centralizu ky problem, d.m.th tjetër është kur Fondi

apo Integra e bënë një raport, çfarëdo hulumtimi e publikon një raport të mbledhjes së fakteve, të rekordimeve, të intervistave, e tjetër është kur një komision rajonal, jopolitik, i përgjegjshëm, kredibil, me njerëz profesional brenda e qet atë raport dhe ky raport vlen për të gjitha shtetet që kanë qenë të involvuara në konflikt. Kjo është po më duket, ta dhashë një përgjigje për pyetjen e parë. Ideja e këtyre tryezave është që këto paqartësi si tuajat e të mijat, unë ende kam paqartësi, me u sqaru, me u bë më të dijshme për neve, çka është kjo ide, në çfarë procesi kemi hyrë, kështu nëse ky komision ka me qenë central në aspektin që ka me u shtri në gjithë rajonin ka me u marr me konfliktet e rajonit, atëherë ka me qenë shumë serioz raporti tij dhe puna e tij. E përkundër kësaj ka shumë organizata cilat vetë edhe FDH apo plot organizata tjera materialet e veta dhe punët e vet, do tia dërgojnë punët e veta këtij komisioni, i cili ka me i shfrytëzu këto dhe ka me punu shumë vjet. Cka ke pyetja e dytë se e pata edhe një. Veç pak shumë shkurtimisht.

Blerina Osmani: Pata shumë pyetje mes rreshtave, kështu që më duket instancat, instancat prej juristëve kërkova me dit nëse ne kem emra...

Kushtrim Koliqi: Sa i përket komisioni rajonal e përmenda edhe në përgjigjen e parë, tendenca jonë është me qenë të involvuar njerëz më kredibil, më profesional dhe më jopolitik, çështja e konflikteve është shumë politike sot në qoftë unë për lahem me një serb, menjëherë nxehem dhe bëhem shumë i njëanshëm. D.m.th komisioni ka me qenë i udhëhequr prej njerëzve më kredibil jo vetëm prej krejt rajonit po edhe internacional. Kjo të len hapësirë për një lojë ferr, se është themeluar edhe një komision në Serbi ama ka qenë teje politik. Ama ajo ka qenë e themeluar prej njerëzve jo kredibil, e kjo pak a shumë është detyrë e shoqërisë civile, studentëve, artistëve detyrë e mediave që m e u bo një institucion shumë kredibil për masën. Pse një viktimë me me punu me njerëz të institucionit rajonal me sociolog tanë me dhënë intervistën e vet, ai duhet me qenë i bindur që historia e vet ka me u thonë dhe ka me u trajtu në rregull, puna e dinjiteti tash prapë po flasim, më duket që diku diku ti dhashë përgjigjet, po i preke do pika interesante njerëzit kredibil kanë me u involvu këtu unë jo, se unë nuk jam njeri kredibil për masën. Unë po e ndihmoj procesin, unë mundem të bëjë fushata, mundem të bëjë takime, mundem të mbledhi, të shkruaj ama unë nuk kam kredibilitet në masë. A ki me shtu diçka se unë u nxeha.

Bekim Blakaj: Po në fakt unë desha me thënë diçka për komisionin rajonal, vetëm diçka dua të jem i qartë me juve. Komisioni Rajonal ende nuk ekziston, ekziston një iniciativë për me u krijuar një komision rajonal domethënë mos te merr askush që është krijuar. Çështja tjetër komision as rajonal as nacional nuk mundet me kriju askush përpos qeverisë, parlamentit ose kryetarit, as shoqëria civile asnjë organizatë e shoqërisë civile asnjë individ nuk me und të krijoj komision. Komisioni zyrtarisht quhet i krijuar kur institucionet e një vendi më të larta qeveria, parlamenti dhe kryetari e nënshkruan krijimin e këtij komisioni. Ndërsa konkretisht për iniciativën për komisionin rajonal, ne në fakt e kemi hedhur hapin e parë, një rrugë shumë e gjatë është para neve duhet me u përcaktu gjërat, duhet me dit cili do të ishte mandati, kompetencat e kështu me radhë d.m.th ne jemi vetëm në hapin e parë. Shpresoj që do të kemi përkrahje të gjerë edhe nga ju në dhe ide të reja në lidhje me këtë koalicion për krijimin e koalicionit rajonal. Më falni që ju morra kaq kohë por ke nevoja.

Kushtrim Koliqi: Ok, tani Abdullahi. Se është shumë i rëndësishëm. Mos ti mbetemi borxh Blerinës për punën e stabilitetit, unë do ta kisha ndërlidh me thënien e zonjës Gashi kur tha se në rast që e kaluara të harrohet ajo ka rrezik të përsëritet dhe në rast që kjo do të përsëritet pikërisht kjo do sjellë destabilitet. Çfarë dua të them me këto, stabiliteti do të varret pikërisht nga kjo ne duhet të shikojmë se çka ka pas në të kaluarën të hulumtojmë ato të zbardhim fatin dhe pikërisht kjo do të sjell një stabilitet në të ardhmen. Në rast që ne i harrojmë dhe dëshirojmë të integrohemi në BE ose në instancat tjera më të larta, pikërisht rruga jonë do të jetë një rrugë e turbullt drejtë të së ardhmes. Duhet të hulumtojmë çfarë ka ndodhur në të kaluarën dhe kjo do të na sjell një plus shumë të madh drejtë asaj që duam të arrijmë në të ardhmen, e kjo sjell stabilitetin që përmendëm më herët. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Abdullah veç pak se kemi me diskutuar për diçka shumë të rëndësishme, kemi shumë kohë. E kemi Abdullahun dhe e kemi kolegen nga Zagrebi, i cili me und të flas prej një perspektive krejt tjetër.

Abdullah Ferizi: Edhe njëherë Abdullah Ferizi i organizatës forum ZFD, kam pas fatin dhe obligim shumë të madh që, edhe njëherë Abdullah Ferizi vijë nga organizata forum ZFD e kam një fat dhe një obligim shumë të madh që nga viti 2006 punoj si trajner me këshillin koordinues të shoqatave për personat e zhdukur të Kosovës. Detyra ime ka qenë që këta njerëz mi provuar, ata mi aftësuar në mënyrën më të mirë të artikulimit, të nevojave të veta dhe mbrojtjen e argumenteve të tyre. Me qëllim të arritjes së kërkesave të caktuara, që ata i akne, natyrisht gjithmonë të drejta por për fat të keq gjithmonë shumë të politizime edhe të manipulime. Ajo çka Blerina e përmendi konkretizim unë isha ndal te ajo fjalë i ka dy anët e veta pozitive dhe negative, pozitive e ka për shkak që është pikërisht zëri i viktimave që është kërkesa kryesore e viktimave, unë me und të flas për këtë grup të viktimave d.m.th për shoqatat e familjarëve pak më shumë por duke i mos anashkaluar viktimat tjera dikush i përmendi ish-burgosurit politik mandej dëshmorët invalidët e luftës dhe secili nga ne dhe ne komplet si shoqëri për shembull që mendim i jemi dhe i organizatës të cilën e përfaqësoj këtu është që viktimë nuk janë vetëm individët me emër dhe mbiemër por jemi edhe ne komplet si shoqëri dhe kjo reflektohet Shuki e përmendi më herët më qasjet tona ndaj këtyre problemeve që kanë dalë prej një te kaluare të dhunshme që kemi pasur. Sa i përket konkretizimit thashë që ajo është zëri i viktimave ajo është çka edhe viktimat vetë kërkojnë dhe një mekanizëm konkret i cili do të merret me hallet e tyre, mbi të gjitha do të ndihmonte në rehabilitimin e tyre dhe për disa që ende janë në lista si të zhdukur dhe nuk dihet fati i tyre. Mirëpo negativja e fjalës konkretizim është që e përmendi Bekimi jemi në fillim të një procesi për një konkretizim të tillë diçka tjetër që Bekimi përmendi, ku dua të kthehem është që e ceku prapë që kjo është një iniciativë, nëse është një iniciativë atëherë nuk do të thotë assesi që kjo ose prej juve ose prej njerëzve tjerë sidomos prej viktimave që kërkohet me ngrit dorën dhe me thënë po duke e përkrahur iniciativën. Ka shumë punë për tu bërë nevojitet shumë kontribut prandaj iniciativa nënkupton që prej gjitha këtyre grupeve të caktuara sidomos nga ju si gjeneratë më e re kërkohet angazhim pjesëmarrje aktive dhe kontribut, në mënyra të ndryshme qoftë si e përmendi Kushtrimi me kampanja të ndryshme me vetëdijesim të madh, qoftë me ide konkrete qe disa prej tyre që u dhanë këtu por edhe me hapa tjerë të cilat do ta shpejtonin këtë proces deri te konkretizimi që u përmend Shuki tha që nuk

kemi shumë kohë për me humb në fakt nëse tendenca jonë si shoqëri është që të jemi të familjes evropiane duhet me ditë që për shkak të proceseve historike jemi mjaft prapa nga familja evropiane dhe nuk e kemi atë luks që me të kaluarën tonë me u marr në një mënyrë të ngadaltë dhe në anglisht po shprehem easy going mirëpo e kemi atë obligim që i ka ra kësaj gjenerate që me këtë të kaluarën tonë me u marr me një mënyrë më aktive me një elan më të fortë dhe kjo është shumë e dhimbshme mirëpo është me rëndësi me pa si diçka të domosdoshme që çdo vonesë ka me shkaktua pa marrë parasysh që nuk i dëshirojmë ka me shkaktua mbulim ose fshehje të fakteve prandaj nevojitet angazhim i të gjithëve. Nëse kthehem prapë te grupi i shoqatave të familjarëve ajo është diçka që për fat të keq ka ndodh deri tash ka qenë ajo që e përmenda një manipulim u tha edhe më herët sa herë që ka ndonjë kampanjë politike sa herë që janë votimet sa herë që edhe kur ka ndonjë manifestim ku kanalet e televizioneve të Kosovës i kanë ekranet e tyre të mbushura pikërisht me familjarët e viktimave. Mirëpo një koment nga ata është që gjatë javës tërë vitin tjetër dhe nëse e matë me minutazhë më shumë hapësirë i jepet kafshëve, për emisionin për kafshët shtëpiake se sa që iu jepet viktimave. Është një e vërtetë shumë e hidhur jo vetëm në atë që televizionet tona nuk duhen të kenë emision për kafshë absolut jo televizionet tona duhet me pas emisione normale, duhet me pas emisione për fëmijë të cilat nuk do të kishin qenë të ngarkuara me çështjen me të cilën janë të ngarkuar shoqatat e familjarëve. Unë mendoj që KOMRA iniciativa për një komision është njëra nga mënyrat që me u ballafaquar me të gjitha këto pasoja të luftës me provuar me u marr në mënyrë konstruktive me to edhe me iu bë vendin atje ku e kanë në memorien tonë kolektive nëpër qytete tona dhe në librat e historisë, në atë mënyrë që diçka e tillë që një e kaluar e dhunshme të jetë. Unë e kisha ndalur këtu nëse dikush ka ndonjë pyetje sa i përket po them prapë shoqatave të familjarëve kisha me undu me dhënë mendimin tim por normal që nuk jam unë i thirrur për të folur në emrin e tyre sepse këtë me unden ata me bë vetë edhe do ta bëjnë së shpejti në konsultimet e dyta që janë të planifikuara. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Të shkojmë me Ivanin.

Ivan Novosel: Do të pres ti vendosni dëgjueset për përkthim.

Kushtrim Koliqi: Cili Kanal është për përkthim. Kanali një është për përkthime. Për ata që kanë nevojë edhe kush nuk ka pajisje ju lutemi teknikëve tonë të mrekullueshëm. Menjëherë pas Ivanit domethënë edhe dikush tjetër që ka me thënë urgjent. Kemi mi leshu dy video regjistrime të cilat, para se mi lëshuar ato ka me fol Bekimi, janë video regjistrimet e viktimave cilat kanë me tregu storjet e tyre. Bekimi ka me na dhënë një hyrje parë që ti lëshojmë ato, është një video regjistrim i shkurt tani kemi pauzën. A jemi gati po me duket që po. Edhe një a... edhe një palë.

Ivan Novosel: A me und të filloj?

Kushtrim Koliqi: Po më duket që tani me und të fillojmë. Me und të fillojmë.

Ivan Novosel: Me und të fillojmë. Mirë. Unë do të kthena një hap prapa, kur një kolege e përmendi, faktikisht sot disa herë u përmend ideja e stabilitetit dhe ideja e Bashkësisë Evropiane. Pra, në lidhje me stabilitet, ajo që është e rëndësishme rreth konkretizimit tërë ky proces do të formohet në momentin kur qeveritë, parlamentet, presidentet të shteteve marrin një vendim për

themelimin e Komisionit Rajonal. Pas përfundimit të punës së Komisionit të cilën Komisioni do ta kalon përmes një kohe të caktuar dhe e përcakton mandatit apo kohëzgjatjen e Komisionit. Komisioni do të del me disa rekomandime. Çfarë unë shoh si një parakusht të rëndësishëm për stabilitetin janë bash këto rekomandime të Komisionit të cilat me und me një dozë të madhe të me und të paramendoj se do të jetë diçka e ngjashme si që ka ndodhur në Francë, Gjermani pas luftës dyte botërore. Pra, procesi i stabilizimit nuk është i fiksuar në një pik brenda një kohe. Thjesht ky proces zgjat tërë kohën. Ky zhvillohet bashkë me shoqëritë të cilat gjithashtu nuk janë monolite. Pra, shoqëritë janë qenie të gjallë. Procesi i stabilizimit në shtetet e ish-Jugosllavi si pas vizionit tim do të zhvillohet në atë mënyrë, ku ato do të përjetojnë kulmin e tyre, dhe kjo do të jetë disa kohë pas publikimit të raportit dhe pas një kohe kurë parlamentet, institucionet arsimore, elita e shoqërisë, institucionet qeveritare vendosin për ta krijuar një kurikulum ose ndonjë lloj arsimi për të drejtat e njeriut. Do të thotë diçka, që e përfshin tolerancën ndër-etnike, respekti për njerëzit. Në atë moment me und të themi se e kemi arritur një nivel të civilizuar. Ajo nuk do të jetë nesër, nuk do të jetë pasnesër, ose nuk di a do të jetë por në një pik të caktuar të kohës kjo do të ndodhë. Pse është e nevojshme koha, pse është nevojshme aq shumë kohë për të ardhur deri tek ajo. Është e rëndësishme të kuptohet se ekziston struktura dhe procesi. Pra, struktura është e përbërë nga individët nga disa pjesë të caktuara të cilat nuk janë të ndërtuara në atë mënyrë që ato pjesët thjesht të përputhen, dhe se struktura, sistemi nuk është i njëjtë me numrin e pjesëve të caktuara. Thjesht ato pjesë janë në bashkëveprim. Njëra me tjetrën ose më shumë të tjera. Kjo nuk është një proces i thjeshtë dhe ai thjesht do të zgjat. Për të ardhur deri tek shërimi shoqërive tona dhe bashkëngjitja në një rrjedhje normale të civilizimit këtu u flit për familjen evropiane, për Bashkimin Evropian dhe në neper atë proces duhet të kapërcejmë dhe ajo do të zgjat shumë. Proces i cili momentalisht është në Kroaci, nuk e di sa i keni ndjekur mediat, por Kroacia para disa ditëve ka hyrë në aleancën e NATO-s. Ka qenë një fushatë rreth Kroacisë e cila fliste si ne nuk dëshirojmë në aleancën e NATO-s, ekziston aleanca ushtarake. Megjithatë çka është i rëndësishëm, por problemi në këtë fushatë ishte se ajo ishte e lidhur me rrethin e ngushtë të njerëzve, thjesht se elita politike asnjëherë nuk është përpjekur që në NATO nuk hyrë sepse ata janë anëtarë të organizatave qeveritare por ata e kanë shpjeguar që ushtria është duke hyrë në NATO aleance.. Nga ana tjetër elita politike nuk është përpjekur për të shpjeguar që tërë shteti, do të thotë një shtet me të gjitha institucionet e saj, shteti me shoqërinë si një pjesë integrale hyrë gjithashtu në aleancën e NATO-s. Kur flasim për Bashkimin Evropian, për Bashkimin Evropian në këto hapësira, prapë do të flisni nga perspektiva e Kroacisë, e shohin si një objektiv si një dritë në fund të tunelit, për të cilën duhet të përpiqemi. Por megjithatë e rëndësishme është gjëra parë që ne duhet ta kuptojmë pastaj ta transferojmë kuptimin në tjera ne atë nuk e bëjmë j dhe nuk guxojmë ta bëjmë. Nuk guxojmë sepse ajo është e afërme i gabuar për kome unitetin për shkak se atë e kërkon Bashkësia Evropiane. Sepse në këtë mënyrë nuk e sigurojmë stabilitetin afat-gjatë. Nuk e sigurojmë stabilitetin e shoqërisë tonë. Pse është kështu? Përsëri, thjesht kthehemi në histori në lidhje me strukturat dhe storjen e procesit. Bashkimi Evropian është një strukturë politike, struktura politike e parë që është ndërlidhur me një ose më shumë nuk e di me sa shumë faktorë. Këta faktorë, këta faktorë janë ndërlidhur gjeografikisht, ekonomikisht, ushtarakisht dhe me aspekte të tjera. Dhe kur Bashkësia Evropiane thotë se duhet të respektohen të drejtat e njeriut domethënë disa nga pjesët që dalin nga tregu i lirë, demokracisë liberale dhe kështu me radhë, është një gënjeshtër. Ajo është një gënjeshtër.

Dhe ajo që të gjithë ne duhet të kuptojmë është se në nuk duhet te veprojmë sepse ashtu dëshiron Gjermania, Franca, ne duhet të punojmë për shkak vendit tonë. Thjesht për shkak të ardhmes tonë. Sepse nëse në këtë mënyrë, sepse në qoftë se në këtë mënyrë nuk e bëjmë procesin, përsëri do të përsëritet ajo që ndodhi në vitin 1991 dhe më tej. Thjesht, pas Luftës së Dytë Botërore, kur u krijua Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë, ku këta popuj prapë janë futur në një krijim artificial neonataliste e cila në praninë e ideologjisë ka provuar ti mbush vrimat të cilat kanë qenë të dukshme dhe riskun i cili ka qenë i pashmangshëm. Për atë se njerëzit nuk janë të barabartë, njerëzit vetëm kanë drejtat të barabarta, në atë mënyrë as shoqëria as shtetet nuk janë të barabartë, ata vetëm kanë drejtat të barabarta në një kontekst të caktuar. Thjesht kjo ideologji nuk ka ardhur nga brenda dhe nuk i ka përfshi të gjithë e shoqërisë. Kaq pata.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit shumë. Këtë fjalë e di. Po shkojmë me dokumente shumë të vogla, por mos e harrojmë se kemi me pas hala hapësirë me fol. Kur kemi me fol për përvoja e shteteve tjera janë shumë interesante. Janë provoja, janë përralla shume interesante në çka kanë kaluar ata. Në të njëjtën kohë kur kemi me fol tamam për idenë, historinë e idesë themelimin e komisionit rajonal edhe aty ka me pas hapësin për diskutim. Po shkojmë me veri short coments. Shumë të shkurta. Mos më keqkupto por menjëherë pas pauzës kemi hapsin për diskutime.

Besart Metaj: Faleminderit shumë. Unë jam Besarti student fakultetit Juridik. Vijë nga Gjakova, desha vetëm me thonë se unë plotësisht pajtohem me kolegën Blerinën që tha duhet ti konkretizojmë gjërat. Nga të cilat duhet të kemi më shumë seriozitet në punë dhe me kolegun që tha se ne duhet të dimë qasjen e trajtimit të viktimave. Ne shumë mirë e dimë se në Kosovë ka pasur masakra të ndryshme, masakra e Reçakut, masakra e Mejës, masakra e Pejës, masakra e Izbicës, ne te gjitha këto masakra e kemi bile nga një dëshmitar i cili ka pas fatin dhe ka shpëtuar nga ajo masakër. Po ashtu desha të them për OJQ me atë kolegun nga Forumi ZDF qe tha për të zhdukurit. Me u më vjen mire qe paska organizata të tilla, sepse unë jam vete nga askush ne shtëpinë time nuk ka ardhur përveç Kryqit Kuq. Organizata ne Kosovë ka boll, bile prej tyre ka shumë por ato janë vetëm në Prishtinë. Nuk po dalim jashtë Prishtinës. Ato po më duket po thithnin investime nga fondi humanitar ndërkombëtar, nga USAID-I, edhe nuk pi kryejnë punën e tyre. Faleminderit.

Abdullah Ferizi: Veç diçka shkurt. Organizata për të cilën unë punoj nuk është organizatore e trajnimeve ku unë kom qenë trajner është ICMP komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur. Që është organizatë e cila e ka selinë ne Prishtinë, selinë për Kosovë. Mirëpo, ICMP punon me këshillin e familjarëve për persona të zhdukur, këshilli koordinues është një mekanizëm një rrjet i cili shoqatat e familjarëve prej disa vendeve të Kosovës, nuk mundem ti përfshij të gjithat që në këshill koordinues nuk janë, po e zëmë, thirrjet e nënave dhe disa tjera prej Gjakovës,, nuk janë, , organizata nga Krusha e madhe nëse s'po gabojmë mirëpo është një mekanizëm një rrjet i shoqatave të familjarëve dhe këta janë grupi me të cilin ICMP punon.

Kushtrim Koliqi: Fakt që organizatat janë të centralizuar në Prishtinë por mos harro që ata e kanë bazën në Prishtinë por punojnë shumë jashtë. Tjetër është kapaciteti i tyre, d.m.th sa kanë kapacitet që storjet e gjithkujt mi dëgjuar. Definitivisht çdo stroje çdo viktimë në çfarë do forme duhet me u dëgjuar, kapaciteti i OJQ nuk është shumë i madh çfarë kapaciteti kishte mundur mi

pas një komision kështu për këtë është qëllimi për me u bashku, se Integra i ka marr 20 storje, 50 storje, 25 intervista, Fondi ka marr qeqaq, prapë nuk janë mbuluar e gjitha, definitivisht ti ki drejt sidomos me Gjakovën që është vendi.....

Besart Metaj: Problemi kryesor është se ne mos me ndenjur nëpër zyre, na mos me nejt nëpër Prishtinë, por me dal në terren me hulumtuar. Me këqyrë ku, në cilin vend duhet me shku. Ne shumica e dimë se viktimat që kanë pësuar me se shumti, përveç Reçakut është Rrafshi Dukagjinit edhe andej kurrkush nuk vjen as në Pejë, as në Deçan, as në Gjakovë, as në Krushë.

Kushtrim Koliqi: Plotësisht drejt ki, kurë bohet ajo intervistë me pasur edhe adresën, e adresa e qasej intervistë ka me qenë komisioni, komisioni me grupet e veta punuese, besoj që ka me u shtri në krejt Kosovën. Jo veç në Kosovën por faktikisht në krejt Jugosllavin. Krejt është çështja të kapaciteti, të kapacitetet që i kanë momentalisht OJQ. Puna e tyre definitivisht posaçërisht për Dukagjinin. Duhet me pasur shumë kohë faktikisht me mbuluar tërë dukagjinin çaçë shumë raste ka. Domethënë rastet janë ndër ma të mëdha në Dukagjin. Janë ma trishtueshme, ma tragjike të me mundshme. Por prapë është çështja të kapaciteti që kuptohet, nëse ka me qenë një komision Rajonal, kjo ideja ambicioze ma merr mendja që ka më pas qëllim që çdo storje që çdo histori e çdo kujt më pas të arkivuar, se është në interes të komisionit më pasur çdo storje. Ti ki shumë drejt që s'është bo hiq bre, në krahasim çka ka nuk u bo kurrgjë. Në krahasim çka kanë përjetuar njerëzit nuk u bo kurrgjë. Edhe për atë jena mbledh këtu me fol për një ide shumë ambicioze në këtë drejtim. Pe lojna para se me leshu video incizimet sepse janë shumë të rëndësishëm. Bekimi do ta bërë vetëm një hyrje të këtyre video incizimeve që kanë me ju ndihmuar para se me i pa.

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë, me vërtet po e ritheksoj edhe njëherë por po më pëlqen qasja e juaj që fokusin e keni viktimën. Ky proces i këtij Koalicioni për formimin e Komisionit Rajonal e ka historinë pak ma të gjatë, janë majtë deri më tani një numër shumë i madh i konsultimeve të këtilla, por ka pas edhe forume të mëdha. Forumi i fundit në fakt i katërt Rajonal është mbajt më 28, 29 -10. 2008 në Prishtinë, ka pas mbi 400 pjesëmarrës, para këtij forumi ka qenë në Beograd, pastaj kemi pasur në Zagreb, edhe në Sarajevë. Një sesion, një gjysmë dite të punimeve të forumeve ja kemi kushtuar viktimave, në fakt zërit të viktimave. Këto incizime janë nga dy forume, prej forumit të fundit që u mbajt në Prishtinë. Kolegia e përmendi që është nga Podujeva i kemi dy të ri, në fakt këta kanë qenë fëmije edhe janë viktimat një masakre të tmerrshme. Për fat të mirë ata dy kanë mbijetuar por shumica e familjarëve të tyre janë të vramë. Incizimi tjetër ka të bëjë me Forumin që është mbajtur në Beograd e kemi një dëshmitar nga një fshat nga komuna e Suharekës, dua t'iu lus ta keni parasysh ata kanë fol para 400 njerëzve e kanë mbledhë forcën me tregu atë çka ju ka ndodh. Prapë po e cekim Bekim Gashi nga fshati Tërnjë të komunës Suharekës ka marr fuqi dhe ka shkuar në Beograd dhe e ka tregu ngjarjen e tij. Në fakt në sallë e kemi një zotëri i cili ka qenë në Beograd në një konferencë të tjetër dhe e ka tregu storjen e tij. Ju lutëm me kujdes nëse keni me mundësi ta shikoni.

Shkon video incizimi.....

Bekim Blakaj: Ka pasur më dhjetëra komisione që janë krijuar e kanë krye punën e tyre, komisionin e tyre, disa kanë qenë ma suksesshme, disa ma pak të suksesshme, për fat të keq ka pasur edhe komisione që kanë qenë të dështuar. Mirëpo para se me u ndal te Komisionet dëshiroj me u mundu shumë thjesht me ju shpjeguar nevojën për Komisione. Gjithë ne jemi dëshmitar situatës të sotme në Kosovë. E dimë të gjithë, kemi dëgjuar për vrasje të ndryshme, masakra të ndryshme, rreth 14.000 viktima të luftës janë në Kosove duke i përfshirë të vramë dhe të zhdukur. Ma herët e përmenda kemi pasur dy gjykime për krime lufte cilat kanë marr formën e prerë do më thonë gjykata supreme i ka vërtetu si të cilat jonë jo të plotfuqishme. Një moment sot paradite i përmenda nevojat e viktimave edhe pse Shukrija në mënyrë të detajuar na ka fol për nevojat e viktimave. Mirëpo dëshiroj ti ri cekë edhe njëherë. Viktimat kanë drejtën të pamohueshme me dit të vërtetën. Çka ka ndodh me familjarët të tyre, pse ka ndodh. Ato viktima kanë të drejtë me kërkuar përgjegjësi edhe ajo është obligimi ynë më kërkuar përgjegjësi për atë çka ka ndodh. Edhe sigurisht dëmshpërblim. Kjo është një rrugë natyrale për me u arrit lloj pajtimi. Mirëpo si në Kosovë ka pas qindra raste në botë. Disa edhe më të tmerrshëm së në Kosovë me një numër shumë ma të madhe të viktimave, më një kohëzgjatje shumë ma të madhe, më dekada ka zgjat kanë zgjat luftërat dhe krimet. Gjithashtu edhe në ato vende si në Kosove nuk ka pasur gjykime, nuk jonë nxjerr kryesit e krimeve nuk ju ka gjykuar. Ju ka mohu viktimave, ju ka mohu se është bërë një shkelje ndaj tyre që është një dhimbje shumë e madhe, mohimi i krimet e kështu më radhë. Prandaj, shumë ma herët se ne më nisë këtë debat në Kosovë ose në rajon po them në vende tjera kanë menduar çka më bo në këto raste, a më mbyllur ashtu siç është pa fol fare, thjesht me u shpreh mi fut gjitha këto nën tepih dhe me vazhduar, apo me u mundu diçka se paku më ju kthyer dinjitetin viktimave. Por pas luftës dytë botërore ne e kemi pas këtu edhe jo veç në Kosovë por në krejt Rajon, ka pasur krime të tmerrshëm për të cilat fare nuk u fol për cilat ne nuk kemi mësuar në librat e historisë fare edhe nuk kemi dit edhe pse dikush ndoshta prej gjyshërve tonë ka bënë viktimë. Në fare s’kemi dëgjuar për ato. Domethënë shumë thjesht u mbyll aj kapituj edhe gjithat ato janë fshehur nën tepih. Po na ndodhi prapë u përsërit kjo. Si preventiv ndaj përsëritjes krimeve është nevojë që me u krijuar një platformë e pranueshme nga gjithë për atë çka ka ndodh në të kallumen. E për me qenë e pranueshme nga gjithë duhen me u nxirr faktet mirëpo dikush sot e përmendi çka 10 vjet kaluan, unë personalisht për shkak punës time në terren di me disa, deri 10 vetë dëshmitar okular cilët kanë qenë por sot nuk janë në mesin tonë dhe historia e tyre ka shkuar me ta, po çka nëse kjo status kohë vazhdon edhe me vite tëra. Edhe me dhjetëra vite tjera. Atëherë në nuk kemi mundur ti nxjerrim, me i pru konkludimet se çka ka ndodh në të kaluarën. Prandaj koha është se me u mare seriozisht më të kaluarën. Në vende tjera kanë krijuar komisione ato jonë trupa jashtë gjykatave, jashtë gjyqësor të cilët janë marr me të vërtetën dhe fokusi i tyre ka qenë viktimat jo proceset gjyqësore. Siç e thashë ma herët sot nuk duhet mi kuptuar komisionet si zëvendësim i gjykatave. Kurrsesi. Në fakt ato me und të ndihmojnë në masë të madhe gjykatave. Mirëpo për me u kthyer përfundimisht te Komisionet te përvoja e tjerëve me komisione para se me filluar me fol në detale për disa pika po dua me ju tregu diçka se, disa mos them shumica nga komisioneve nuk i kanë plotësuar nevojat e të gjitha viktimave, Në fakt është e natyrshëm, është e natyrshme sepse viktimat asnjë rast nuk mundën me u pajtuar me atë çka ka ndodhur. Edhe ata për fat të keq gjithë jetën e vetë kanë me mbajt dhimbjen për atë çka ju ka ndodhur në të kaluarën. Asnjë komision me tjetrin nuk e kanë pasur një model të caktuar kanë dalluar në bazë të nevojave të shoqërisë edhe në bazë të

nevojave të atij vendi. Janë modifikuar, kanë shërbyer si një model por më gjithë atë jonë modifikuar. Para se më dal te kjo kush e krijon komisionin. Po dua me thënë, se komisionet deri më tani kanë qenë brenda një shteti ose pas një luftë tmerrshme ose pas një ulje të sistemit totalitar, ku ai sistem aj aparat totalitar ka bërë krime, ndoshta ndaj pakicave etnike ose ndaj qytetarëve të tjerë të vetë prandaj është ndijë nevoja që të krijohet komisioni mbi të vërtetën. Kjo është iniciativa e parë që pretendon të krijohet një komision rajonal. Një komision të vetëm ta krijojnë disa shtete por mirëpo do të ndalem sepse sesioni tjetër ka të bëjë me Komisionin Rajonal, kështu që në atë sesion do të flasim për këtë. Kush e themelon komisionin. Komisionin për përcaktimin e fakteve themelojnë parlamentet, ose kuvendet e vendeve, kryetari, kemi një rast në fakt që mbreti e ka krijuar është rasti i komisionit të Marokut, qeveria. Domethënë, njëra prej tyre, jot të gjithat ose kuvendi ose kryetari ose e krijon qeveria. Mirëpo ka pasur raste ku komisionet janë krijuar nga institucionet ndërkombëtare më duket në Timorin Lindor ku Kombet e bashkuara kanë krijuar komisionin. Mirëpo ka pasur edhe komisione të cilat janë krijuar si marrëveshje paqësore. Për shembull rast konkret marrëveshje për Kosovë ka mundur të jetë një nga pikat që palët ta krijojnë një komision për të vërtetën. Mirëpo, kjo nuk ka ndodhur të ne por në disa vende tjera ku me marrëveshje paqësore është krijuar edhe komisioni. Afrika Jugut, Gjermania edhe Urugai, komisionet e tyre vendeve janë krijuar nga parlamentet e tyre. I ka dhe anët pozitive edhe negative, varësisht se kush e krijon komisionin ekzistojnë edhe anët pozitive edhe anët negative. Pe marr shembull komisionet të cilat i ka krijuar parlamenti. Komë lexuar diku se në Afrikë të Jugut është dashtë 300 orë debat në parlament për themelimin e komisionit. Është debat shumë i gjatë. Lidhje më krijim e komisionit, procesi i krijimit të komisionit nëpër mes parlamenteve është shumë ma i gjatë se në rastet tjera. Kjo është një nga mangësitë sepse gjithmonë do të kishte parlamentar që janë pro dhe që janë kundërt. Mandej varet se sa është baraspesha e tyre aty negociohet, çka negociohet. Po flas për komisione tjera jo për komisionin Rajonal e që aty ka pas parti politike që nuk kanë qenë shumë të interesuar me u krijuar një komision për nxirjen e fakteve edhe ata kanë qenë kundër edhe e kanë bo opstruksione në parlamente, mandej kanë mundur me u kushtëzuar, ok, në japim votën për me u aprovuar ligji sepse këtu jonë pru ligje të posaçme për krijimin e komisione, e për më pru atë ligj kanë kushtëzuar, kanë negociuar në kuptim, ok në e krijojmë komisionin, por atëherë misioni i komisionit nuk ka me qenë kjo, kjo, kjo.... Ose vije edhe të ajo pikë ku disa komisione e kanë pasur mandatin shumë ngushtë në këtë çështje do të kthehem kur vijmë të pika e misionit. Argjentina Peruja, Maroku, Kili, komisionet e këtyre vendeve janë krijuar nga kryetarët e këtyre shteteve. Ana pozitive është se këtu komisionet janë krijuar shumë shpejt, zakonisht kryetarët të shteteve, në Marok ka qenë mbreti I Marokut I cili e ka krijuar komisionin, nuk janë marr shumë më konsultime, mos të them fare, por më një dekret të vetin, me një dekret të vetin, ka thonë e po krijojmë komisionin. Mirëpo në këto raste këto komisione nuk e kanë pasur një përkrahje shumë të madhe prej shoqërisë civile e çka është një hendikep shumë i madhe. Është një hendikep shumë i madh sepse po e marrim rastin e Argjentinës, është krijuar komisioni prej kryetarit por kurrë nuk e ka marrë përkrahjen e disa sidomos shoqatave të familjarëve të viktimave. Janë të njohura ato Nënat nga Sheshi i Majit në Argjentinë. Ato kurrë nuk e kanë përkrah komisionin dhe as nuk e kanë pru dokumentacionin e tyre të bollshëm për krimet të kryera. Thjesht nuk kanë dash me bashkëpunuar me komision dhe nuk e kanë pranuar as raportin final nuk e kanë pranuar i cili është real. Gjithmonë ka pasur hezitime nga ana shoqërisë civile, bile në Argjentinë

komisioni kohën e vetë e ka shpenzuar me atë për mi bind organizatat shoqërisë civile të bashkëpunojnë dhe të ofrojnë materialet e veta në komision. Në Guatemalë është krijuar komisioni me marrëveshje paqësore edhe qysh përmenda kombet e bashkuara kanë krijuar OKB-ja. Ka pas një rast ashtu është quajti Kongresi i dytë Afrikan, kjo ka ndodh në Afrikë ku vetë ushtria rebele e cila ka qenë kundërshtarë e qeverisë dhe ushtrisë ka kërkuar krijimin, domethënë ky është një rast i vetëm ku një ushtri kryengritëse ka kërkuar që të krijohet komisioni në mënyrë që mi spastruar rendet, reshtët e vetë me krimet mundshme që kanë ndodh. Domethënë ata vetë kanë kërkuar që të krijohet komisioni dhe të hulumtohen, hetohen rastet ku ndoshta pjesëtarët e asaj ushtrie kryengritëse kanë bërë krime. Edhe pse kur ka dal raporti i atij komisioni në fillim kanë hezituuar ta pranojnë raportin por megjithatë e kanë pranuar. Edhe që ka pasur aty gjetje ku edhe ajo ushtri kryengritëse ka bo krime ndaj popullatës. Ndalemi pak te puna e periudhës së Komisioneve. Komisionet kur krijohen, për veç, mandateve, kompetencave, kështu me radhë e kanë një përudh të caktuar të kohës. Ka shembuj ndër ma të ndryshëm mirëpo është tregu, pa marrë parasysh nga përmasat e krimeve që i ka hetuar komisioni edhe pa marrë parasysh periudha kohore cilën e ka hetuar komisioni. Është tregu në praktik që komisioni cili e zgjat punën e vetë ma shume se tri vite atëherë nuk ka qenë i suksesshëm, sepse ka disa arsye njëra nga ato është se e ka hup interesimin e opinionit publik. E ka stërzgatur mandatin e vetë e ka humbur edhe përkrahjen edhe familjarëve të viktimave sepse ata nuk kanë mundur me pritë një kohë të gjatë që komisionarët të ulen në vende të veta edhe me vite ta zgjasin punën. Këtu desha me u ndërlidh pak për idenë e komisionit rajonal. Ideja është që Komisioni të ketë kohëzgjatjen prej tri vitesh sepse e mbulon një territor shumë ma të madhe, më mundësi për gjashtë muaj shtesë për përpilimin e raportit. Sepse me të vërtet është punë e madhe. Të bësh hulumtime në terren e të gjithë ato të dhëna mi seleksionuar dhe mi nxirë faktet të cilat kanë me u përfshi në raport. Domethënë është një punë e madhe, prandaj desha me thonë, periudha optimal e punës së një komisioni ishte më qenë prej një viti deri në tre vite. Desha me fol diçka për strukturat e Komisionit. Gjitha komisionet kanë pasur struktura të ndryshme dhe prapë po e ricekë se këtë e kanë organizuar në bazë të nevojave atij vendi. Sepse, jo gjithat konflikte kanë qenë të njëjta, kanë pasur karakter të njëjtë, jo gjitha konflikte kanë zgjatur njëjtë e kështu më radhë. Komisionet e kanë një organizim të brendshëm, departamentet, ndahen në departamente, sa e di unë prapë e marr Afrikën Jugore e cila ka pas disa departamente. Departamenti i cili u marr me hulumtimin e rasteve, me hetimet, departamenti ligjor, i cili i ka shikuar krejt ato dhe e ka pru vendimin se cilat fakte janë, me und të merren si besueshme, të cilat janë të pamjaftueshme dhe kështu me radhë. Mandej ka pasur edhe departamentin për përkrahjen e viktimave, përkrahjen psikologjike të tyre dhe ka pasur departamentin për amnisti. Për amnisti kemi me fol pakës ma vonë, unë se paku kisha pasur dëshirë që me u ndal aty sepse me të vërtet na duhet debati. Unë për veti nuk e kam asnjë ide, komisioni rajonal a është deshtë më pas amnisti apo jo. Do t'iu marrë disa shembuj se ndoshta janë pro disa kundër, sidoqoftë flasin ma vonë për këtë. Komisionet përpos organizimit të brendshëm kanë pasur dhe organizmin territorial. Shembull, Peru përpos zyrës qendrore të komisionit i kanë pasur 5 zyre rajonale edhe kanë pasur bile edhe ashtu quajtur zyre mobile cilat kanë shku nëpër vende të caktuara ku ka pasur krime dhe aty kanë marr informata. Aty është stafi teknik, ata që i marrin deklaratat edhe domethënë kanë pasur me përkthyes dhe me, me, me, me psikolog e kështu më radhë. Ndërsa, ata që vendosin për punën e komisionit që udhëheqin më komision janë komisionarët. Tash hapet pyetja, kush duhet me qenë

komisionar. Kush është aj që ka me udhëheq, kush janë ata që kanë me udhëheq punën e komisionit. Është një përgjegjësi shumë e madhe deri tash në praktik kanë qenë dy lloje të përzgjedhjes ose dy mënyra të caktimit komisionarëve. Ka qenë emërimi i Komisionarëve dhe përzgjedhja e komisionarëve. Për me u kthye mbrapa te themelimi i komisioneve, zakonisht komisionet të cilët janë krijuar nga president të vendeve ose prapë pi përmendi shembullin e Marokut ku Komisionin e ka krijuar mbreti i Marokut edhe komisionarët janë emëruar nga të njëjti. Edhe pse komisioni duhet me qenë organ total i pavarur nga institucionet, edhe pse një institucion presidenti, ose qeveria, ose parlamenti, e formon komisionin kurrsesi nuk guxon mi përzier gishtat. Ka pas, nuk më kujtohet por ka të bëjë me Amerikën Latinë ku është kushtëzuar që në komisionar të jetë edhe një përfaqësues politik. Por në shumicën e komisioneve politika nuk ka mundur fare të ndërhy nga as ata që e kanë krijuar komisionin. Edhe në këto raste komisioni ka dal me raport shumë real. Ne, tash po flas për KOMRA nuk jemi shumë, fare nuk mbizotëron ideja që komisionarët të emërohen. Në fakt ata duhen me u përzgjedh. E si, thjesht sikur përzgjedhja Ombudspersonit tek ne, kisha shpresuar se mos me u tej zgjat sikur ky. Mënyra ma e mirë për... ka pas komisione që kanë pasur një mandat shumë të ngushtë të përcaktuar. Për shembull mandati i komisionit në Argjentinë ka qenë ekskluzivisht të merret vetëm më persona të zhdukur. Respektivisht me hulumtimin, ata kanë marr pjesë dhe në ekshumimet e varrezave masive. Vetëm me qatë mision u marrë. E tash edhe kjo e ka anën negative dhe pozitive, sigurisht që komisioni është dashtë me u marr me qenë gjithëpërfshirës mi trajtuar gjithat shkeljet. Mirëpo atëherë me und të hup në kualitet, pa marr parasysh kohën e shkurt edhe nëse merret me të gjitha mundet me hup diku në mënyrë që as mos me dal raporti në kohë, por edhe as raporti mos me kon i saktë. Është tregu që ato komision që kanë pasur punën të saktë të përcaktuar kanë qenë ma të suksesshme, pse jonë marr vetëm me ato. Edhe në Marko edhe se u quajt ndryshe, është marr vetëm me persona të zhdukur dhe deri diku kanë pasur sukses, diku më duket 700 e ma shumë persona që kanë konfiguruar si të zhdukur, trupat e tyre janë gjetur bash prej komisionit të Marokos, misioni është një çështje shumë e nxehtë me çka me u marr. Diçka çka është pozitive e kjo ka ndodh në disa komisione është se komisioni u marr me një çështje të caktuar. Ose vetëm me viktimat të vramë ose vetëm me viktimat cilat nuk janë më të gjallë, të vramë dhe të zhdukurit. Ose me ish të burgosur, ka pasur dhe komision që kanë prekur çështje të ndryshme të shkeljes të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë edhe mobilizimin e mundshëm, cila me të vërtet është shkelje e rënd, mirëpo komisioni e ka një kompetencë, një mandat kur ta përfundon punën e vet gjithmonë ka mundësi që në rekomandimet të veta atë përfshi krijim e një trupi tjetër, nuk është e thënë komisioni por një trup tjetër i cili ka me u marr më specifik, me diçka çka nuk u marr komisioni. Nuk po di qysh mi thjeshtësuar me marr një shembull, nëse merret vetëm me çështjen të vvarëve dhe të zhdukurve, atëherë kur ta përfundon punën komisioni mundet me pru një rekomandim që një trup tjetër çfarë do qoftë ai zyrtar me u marr me çështjen e fëmijëve bonjak ose me përdhunimeve të femrave, seksuale apo çka do tjetër. Kështu që gjithmonë ekziston ajo mundësi që komisioni si produkt i punës së vetë për të rekomanduar krijimin e një trupi tjetër. Kanë kaluar katër minuta por skam qare pa fol për kompetencat e komisionit që është gjithashtu një çështje që duhet me u debatuar shumë. Disa komisione, edhe kjo ka të bëjë me krijimin e komisionit, zakonisht komisionet që janë krijuar prej presidentëve kanë pasur kompetenca ma të vogla, ka pas komisione të atilla, mundohuni ta keni parasysh që këto komisione janë krijuar në vende ku ka pas një luftë brenda shtetërore ku një qeveri ka bo

krime ndaj një pakice edhe ajo qeveri ende gjendet në politikë, ai ka qenë një kompromis, ka pas komision cili decidivisht, nuk e di cili është cili është shembulli ju ka ndalu komisionarëve që të bëjnë emërimin e kryerësve të veprave thjesht nuk kanë pasur drejt mi nxjerr emrat të kryerësve të veprave. Që është shumë problem, Domethënë komisionet që janë krijuar më lehtë me një vendim presidenti kanë pasur fushë manovrimi më të vogël. Mirëpo zakonisht komisionet që krijohen nga parlamentet ato në fakt kanë fushë veprim më të gjon, dua të përmend se shumë komisione kanë pasur kompetenca shumë të gjerë duke përfshi bastisjen e institucioneve qeveritare që me ardhur te dokumentacioni, shembull që është shumë konkret kanë pasur drejt mi thirrur përfaqësuesit të partisë politike në dëgjim publik për atë se çka kanë bo ata në të kaluarën lidhur me krime. Kanë pasur kompetenca që mi ftuar dëshmitarët mi kushtëzuar dëshmitarët nga ana e kryerësve të veprave në mënyrë që me dëshmuar para komisionit. Varet se sa ka kompetenca një komision për me kryer punën e vetë eh.. këtu arrij deri tek një kompetencë të cilën e përmenda edhe ma herët ku dua me u ndal krejt shkurtimisht. Amnisti në mënyrë që me pru ti dikë që ka abuzuar drejtat e njeriut, ka bo krime me pru me dëshmuar para komisionit atëherë duhesh mi ofruar ti diçka tij. Komisioni i Afrikës të Jugut e ka pas drejtën e amnisti, për këtë thash edhe ma herët unë ende nuk mundem me pas një qëndrim. Në Afrikë të Jugut kanë aplikuar mbi 7 000 persona që kanë qenë të involvuar në krime të ndryshme e di unë ndoshta ma pak ma shumë se 1500 prej tyre ju ka aprovuar amnistia sepse edhe amnistia i ka rregullat e veta në atë mënyrë i ka kushtëzuar kryesit e veprave që ta pranojnë deri në detale se çka kanë bo. Tash është shumë e.. prej pikë vështrimit të viktimave është shumë problem se ti mi aprovuar amnistinë për dikon që ka bërë krime gjithsesi, jo për ata që kanë bo krime kështu me radhë, ju jepet amnistia. Me gjithë atë kur fillohet me procedurë gjyqësore ata do ta kenë dënim më të lehtë sepse kanë qenë bashkëpunëtor me komisionin dhe i kanë afruar fakte. Mirëpo unë e kam pa një film shumë të shkurt me u për Afrikën e Jugut ku dy familje, dy tri, aktivist kanë qenë për drejtat e njeriut dhe një ditë duke u kthyer nga terreni janë zhduk, thjesht, dhe faljet, grat e tyre dhe fëmija nuk kanë ditë kurrë kurgjë. Kryerësit e asaj veprave kanë aplikuar për amnisti dhe në mënyrë publike kanë dëshmuar për kryerjen e saj, kush ju ka dhënë urdhër, pse e kanë bo, ku janë kufomat, janë gjet kufomat, janë varros. Por mos t'iu jepte amnistia atyre ndoshta kurrë nuk dihej ku janë trupat. Dhe familjet domethënë s'kishin me pas një varr dhe mandej në fund të fundit nuk kishin me ditë kush i ka vra sepse s'kanë pasur fakte. Thjesht janë kidnapuar nga rruga. Ndoshta mundemi me debatuar ma vonë lidhur me amnistinë çka mendoni ju. Nga pikë vështrimi ligjor është diçka legale juristët e dinë ma së miri që në njëfarë mënyrë iu jepet amnistia dëshmitareve bashkëpunëtor në mënyrë që të nxirret e vërteta në pah. Por gjithsesi nga pikë vështrimi i viktimave besoj se është shumë vështirë që të pranojmë që amnistia ti jepet dikujt që ka kryer vepra penale të tmerrshme. Për mos me hup kohë ma shumë po shkoj edhe në dy tri pika të tjera. Metodologjia e punës se komisionit. Në fillim komisionet i kanë pasur dy metodologji, në fillim ma shumë ka mbizotëruar dëgjimi i dëshmitarëve ka qenë i mbyllur, komisioni ka punuar me vite e asgjë nuk u dit në publik se çka po ndodh, ka mbledh materiale kanë bo intervista, kanë dëgjuar dëshmitar, kanë dëgjuar viktimat, por nuk kanë dit asgjë se çka po bohet me komision nga jashtë. Ma vonë kanë filluar dëgjimet publike, t'iu tregoj diçka çka është me rendësi në Argjentinë kur u nxirë raporti i komisionit sepse ka qenë i mbyllur ditsha gjë mos më merrni për Argjentinën saktësisht, raporti o shit brenda katër jave 300.000 kopje. Ka qenë best seller. Sepse ju ka interesuar njerëzve se çka ka ndodh, se çka ka në atë raport. Deri sa

në këto seancat publike raporti ma nuk u interesoi sepse gjatë krejt kohës punës komisionit seancat kanë qenë publike. Vetëm në raste të rralla këtyre dëshmitaret kanë qenë viktimat e dhunimeve edhe fëmijëve, ato seanca jonë kon të mbyllura, përndryshe tjerat jonë kon publike., bile edhe në raste këtyre kanë dëshmuar edhe vetë kryesit të veprave. Bashkëpunimi me media ka qenë në nivel shumë të duhur, kështu si big brother që e qesin gjysmë ore në ditë se çka ka ndodh, qashtu e kanë qitë edhe punën e komisionit. Ka qenë shumë interesimi i madh i qytetarëve, raporti në fund është përkthyer në 11 gjuhe zyrtare në Afrikë të Jugut. Po dua me thonë se është tregu ma i suksesshëm dëgjimi publik sepse popullata e gjerë ka pasur mundësi të dëgjoj për atë çka ka ndodh. Edhe është krijuar njëfarë simpatie ose ndjeshmërie mes popullatës dhe viktimave është.. se di sa e përcillet video incizimin pak ma herët 400 vetë në sallë askush me zë nuk ka bo deri sa kanë përfunduar viktimat. Megjithatë të gjithë jemi qenie njerëzore edhe mundemi me dëgjuar se çka i ka ndodhur pa marr parasysh se kush është viktima. Do më thonë bashkë ndjenje me njëri me tjetrin,. Edhe kjo ka pasur efekt shumë të mirë dhe kjo ka ndikuar që të ketë një platformë e përbashkët mbi ato se çka ka ndodhur në të kaluarën. Kemi mundur me fol edhe për mbrojtjen e dëshmitarëve sepse në rast konkret nuk besoj se kish pas ndonjë problem për dëshmitar edhe pse domethënë komisionet kanë krijuar mekanizma për mbrojtën e dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar në mënyrë publike në Komision edhe gjithsesi këtë e kam përmendur edhe sot në mëngjes një ndër rekomandimet gjithmonë, një ndër rekomandimet e komisionarëve kanë të bëjnë me zhdëmtimin ose me dëmshpërblimin e viktimave. Në shumë raste me dëmshpërblim material, por ka edhe mënyra tjera dëmshpërblimit siç janë ngritja e memorialëve, caktimi i ditëve të posaçme kushtuar viktimave. Futja e raportit ose pjesë të raportit në kurikulumin e sistemit të edukimit thjesht në histori edhe kjo është shumë e rëndësishme, atë çka ka ndodh duhet me u mësuar në librat e historisë. Bile një komision përpos raportit që e ka pas shumë voluminoz mbi 30.000 faqe ka bo versione të shkurta të raportit bile një version e ka bo version për fëmijë me vizatime edhe për shkolla të mesme cili mandej është mësuar nëpër shkolla të mesme. Kjo është me qëllim krijimit të kujtesës kolektive për atë çka ka ndodhur në të kaluarën. Për mos lejimin e manipulimit të numrave, me numra për mos mohimin e krimeve ende kemi në vendet e ish Jugosllavisë shtete të caktuara, qeveri të shteteve të caktuara e mohojnë numrin e viktimave. Thonë jo nuk janë aq. Komisioni është një instrument një mekanizëm që i nxjerr ato me fakte. Shumëkush më ka bo pyetje gatë ligjëratave të tjera në takime tjera. Po ne e dimë se çka ka ndodh. A jeni të sigurt që e dini. Unë s'jam fort i sigurt edhe se që nëntë vite merrem me këtë, sot dëgjova për një rast të ri. Nuk e dimë se çka ka ndodh. A e dinë ata shtetet në Rajon, a munden me dit ata krejt në Serbi se çka ka ndodhur në Kosovë ose kroatët ose boshnjakët se besoj. Raporti i komisionit kishte me qenë diçka cili kish me ndikuar në të gjithë me u krijuar ajo platforma se çka ka ndodhur në të kaluarën. Gjithsesi komisionet nuk janë marr bash me secilin rast mirëpo megjithatë ka nxjerr fakte të mjaftueshëm për ato se çka ka ndodhur në të kaluarën. Më falni se e zgjata shumë. Pyetje kur doni.

Kushtrim Koliqi: Që se doni me ju përmbajtur agjendës është mirë se dhe Ivani me vazhduar me idenë Komisionit Rajonal për shtete e ish Jugosllavisë edhe pastaj e kemi periudhën ku veç ju boni pyetje, e panë listat përgjigjen. Faleminderit shumë Bekim. I rashë pishman që e kreu qatë katër minutash se atë çka e tregove e tregove edhe njëherë para neve gjithëve rendësin dhe sa punë duhet me bo për me themeluar një komision sa do pak të suksesshëm. Të njëjtën kohë e

potencove shumë mirë që raportet e këtyre komisioneve kanë efekt shumë të gjatë. Kanë efekt historik pas 40 vjetëve, pas 50 vjetëve, pas 100 vite ato raporte të Afrikës të Jugut, ato libra kanë me u lexua prapë prej njerëzve të ardhmes. Shumë modele pamë shumë modele dëgjuam, e dëgjuam edhe një komplikim edhe në lidhje me komisionin Rajonal se është një model i paparë deri me tani. Komisioni Rajonal i përbërë prej plot shteteve edhe Kosovës tash si shtet i ri kështu që përgjegjësit edhe problemet e komplikimet janë pakës ma të mëdha deri në momentin kur startojnë apo startojnë me Komisionin Rajonal. Tash e ftoj Ivan Novosel prej organizatës Legalis nga Zagrebi për me na dhënë pak a shumë informata për iniciativën e Komisionit Rajonal, pra për neve na këtu çka dëshirojnë me bo.

Ivan Novosel: Së pari do të të shfrytëzoja mundësinë dhe edhe njëherë t'u përsëndes, jam i nderuar që sot gjendem dhe jam i ftuar këtu në mesin e juaj gjithashtu i falënderoj organizatorët. Do të mundohem mos të dal jashtë kornizës kohore. Edhe pse mendoj se do te jetë shumë vështir, por një pjesë të fjalimit tim, do të mbështetën në të dhënat që ju dha Bekimi dhe të cilat më së afërmi do t'u tregojnë atë që është bërë deri më tani, dhe çka planifikohet të bëhet, me themelimin e një iniciative rajonale të Komisionit. Kështu, struktura e sotme të fjalimit tim do të jetë me radhas: Se pari do të fillojmë shumë shkurt, shumë shkurt sepse supozoj se në materialin të cilin e keni marr për seancë të sotme është edhe prezantimi i historisë të iniciativës. Atë shumë shpejt do ta kalojmë, dhe do ti theksojmë disa data të rëndësishme, disa numra të rëndësishme, e jo më shumë. Pastaj do të flasim edhe më shumë përse kjo nismë, përse nevoja për këtë Komision. Më vonë pasi përgjigjemi përse, dhe nga aty i shkëpusim disa qëllime, do të mundohem të përpiqem të përgjigjem në pyetje se çfarë do të jetë. Çka do të jetë KOMRA? E katërta dhe pyetja e fundit është si? Si do të funksionon KOMRA? Ose, do të përpiqem t'u prezantoj fazën e tanishme në të cilën e gjithë nisma funksionon. Kjo është e rëndësishme të theksohet, dhe ajo është ajo pyetje të cilën e ka parashtruar ajo kolegja poshtë më falni se nuk ju di emrin. Në të cilën mënyrë do të rrjedh operacionalizimi dhe instrumentalizimi im e gjithë kësaj nisme. Ky proces nuk është përfunduar ende aj ende vazhdon por struktura filluan të dalin në sipërfaqe. Të fillojmë nga fillimi. Historia e iniciativës për themelimin e KOMRA-s. Pra historia e nismës për themelimin e KOMRA-s ja fillon me para historinë së çka ka ndodhur, për çfarë arsye vije deri te kjo. Është shumë vështir kur flitet për konfliktet e luftës, njësoj sikur me nxjerr në pah, ajo është e pastër, sikur kur shkojmë tek distriksion i drejtësisë e gjendje lufte. A ka pasur konflikte lufte, çfarë lufte ka qenë ajo, a ka qenë ajo luftë civile, a ka qenë një rebelim, a ka qenë luftë kombëtare, apo mes kombeve. Aty pra, ka interpretime të shumta dhe thjesht interpretime elite politike në shumë vende, unë këtu do ta theksoj si shembull Kroacin, sepse atë më së miri e di. Politika zyrtare në një moment thotë se kjo ishte një luftë civile, në pastaj thotë se ka qenë agresion, thjesht se këtu nuk ekziston një disinkcion i qartë. Por në këtë çast ajo pjesë është më pak e rëndësishme, sepse ne e kemi fokusin primar e ai është viktima, dhe të përqendrohet në hulumtimin e faktit se çka ka ndodh dhe ku janë ata te cilët e kanë humbur jetën, e jo se çfarë duhet të jetë në letër apo nuk duhet të jetë. Domethënë më datën, 6, Prill (në muajin e katërt) të vitit 2006. tri organizata nga territori i ish Jugosllavisë, Fondi për të Drejtën Humanitare nga Serbia nga Beograd, Dokumenti nga Zagrebi dhe Qendra e Dokumenteve në Sarajevë e kanë nënshkruar një protokoll mbi bashkëpunimin për dokumentimin e krimeve të luftës. Përse kjo është e rëndësishme, kur veç ekziston qasja parciale regjistrimit të krimeve të

krimeve të luftës dhe viktimave, ku në vitin 1992 Fondi për të Drejtën Humanitare, i cili u themelua dhe udhëhiqet nga Nataša Kandić, shënoi atë kur hyrën ushtarët në Bosnjë dhe ata menjëherë shkuan pas tyre, dhe merreshin shënime. Situata e ngjashme ishte dhe në Kosovë. Në Kroaci ishte një iniciativë e cila ishte e zbatuar ajo ishte një Këshilli i Helsinkit Kroat për të Drejtat e Njeriut menjëherë pas veprimit ushtarak në aksion i quajtur Stuhia 1995 kur u lirua ma saktë kushtetuta juridike të rendit e kthej pjesën më të madhe të Dalmacisë në Kroaci, ku ata janë të nënshkruar me një metodologji e cila është krijuar atë kohë por ajo kohë ishte më e mira që është mundur të pritët për të provuar regjistrohen krimet. Këtë e përmendi për shkak sepse Këshilli i Helsinki për drejtat e njeriut edhe me disa organizata e ka themeluar Dokumenti si një qendër e cila ishte duhur të merret me regjistrimin e viktimave si pasojë e luftës, çmim që duhet të merrej me Listën e viktimave nga pasojat e luftës. Pas kësaj, organizatat, natyrisht edhe përpara kishte pasur kontakte, nuk ka ardhur në një çast të izoluar në muajin Maj vendosën të organizojnë Forumin e parë në vitin 2006. Forumi i parë i drejtësisë tranzicionale u mbajt në Sarajevë, në atë forum i cili ishte diçka i këtij lloji, por vetëm me një numër më të madh. Aty vijë deri tek unë e kisha quajtur një Brain storm (stuhi e madhe e trurit), e cila mbledh të them thjeshtë masën kritike të sektorit civil organizatave jo qeveritare, të cilat japin komentet e tyre, japin ideja, sugjerimet duke u përpjekur të krijojnë një vizion të nacionalizimit e të gjithave në të cilën mënyrë duhet të duket. Procesi i cili vijon nga muaji Maj i vitit 2006 dhe deri tek fundi i vitit 2008 është si më poshtë. Janë organizuar katër Forume ku kanë marr pjesë rreth diku 300-400 njerëz, nëse nuk jam duke gabuar janë organizuar 15 konsultime. Pra këto forume të tjera janë organizuar pas konsultimeve të kryera. Si pas meje këto konsultime janë pjesa ma e vlefshme e gjithë kësaj. Dhe mendoj se këto tri organizata, iniciatorët e treguan dëshirën e tyre dhe vendosmërinë si dhe seriozitetin e tyre për këtë punë, sepse në tërë këtë proces i kanë përfshi organizatat dhe pjesë të shoqërisë si dhe individët te cilët me und të japin një kontribut të madh për të gjithë këtë. Këta janë të rinj, janë gazetarë, janë shoqatat e viktimave, shoqatat e veterinarëve, janë artist dhe shkencëtar, si dhe studentet siç jemi duke punuar ne. Pra, është me rëndësi të mblidhet një masë e madhe sipas mundësisë masën kritike e cila do të ishte mbështetje dhe diçka që do të duhej të siguronte që kjo nismë për krijimin e koalicionit me të vërtetë gjallëruar. Më datën 9 Maj të vitit 2008. në Podgoricë është paraqitur oficial ose zyrtarisht nisma për KOMRA-n, domethënë pastaj filloi të flitet më strukturalist rreth asaj për çka ne flasim këtu sot përsëri. Pas saj është themeluar këshilli koordinues i cili e ka marrë përgatitjen e statutit të kësaj initiative. Përveç kësaj përsëri me und të shihen domethënë shënimet të cilat nuk ishin në atë kohë, kjo nuk do të jetë e kryer pa punuar shumë seriozisht me një qëllim të qartë dhe me një perspektivë të qartë të zhvillimit strategjisë e pastaj me u fut në vepër. Forumi i fundit siç edhe më parë ishte i përmendur është mbajtur në Maj dhe Tetor më 28,29 në muajin e dhjetë të vitit 2008 në Prishtinë ne atë koalicion për KOMRA-n janë bashkangjitur 110 organizata nga tërë rajoni dhe më gjerë nëse nuk gaboj tej, ka pasur disa organizata nga Sllovenia dhe 150 individë. E përmbyllur me muajin Korrik muaji i shtatë të vitit 2009. iniciativës janë bashkangjitur 150 organizata joqeveritare dhe 200 individ. Pra, numri i organizatave është duke u rritur me numrin e mbajtur të konsultimeve si dhe me numrin e planifikimit strategjik dhe me numrin suma sumarum më aktivitetet të cilat koalicioni i kryer në mënyrë që të merret përkrahja sa më e madhe prej organizatave për të drejtat e njeriut organizatat, shoqatat e familjarëve, organizatat për të drejtat e të rinjve, etj. Pas saj janë formuar grupet për koordinimin e konsultimeve. Vij nga

Kroacia, ku kemi formuar një grup, grup punues për të rinjtë, ku jemi tri organizata Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kroaci, Qendra për Studime të Paqes dhe Legalis. Ne jemi tani në përgatitje do të thotë në operacionalizim, pjesë operative, i cili është shumë i rëndësishëm, dhe thjesht ne të cilët i dimë më së miri nevojat e atyre me të cilat punojmë, kryesisht fokusimi tek grupi i të rinjve. Thjesht ne më së mirë i kuptojmë nevojat e tyre më së shpejti me und të adaptohemi është thjeshtë mënyrë më e mirë për tu opeacionaizuar kjo iniciativë. Kjo është një histori e shkurtër për ti pasur të gjitha të shkruara, kemi shumë më të mirë, mjaft më të qartë më të konciz në materialet e juaja. Për atë ju rekomandoj ti lexoni ato materiale. Lidhur me historinë e KOMRA-s me und të vizitoni veb faqen KOMRA ku gjendet ne dispozicion shumica e materialit çka është e lidhur me historinë e të gjithave të cilat deri tani janë të kryera dhe disa ndryshime për të ardhmen. Po kalojmë në pjesën e dyte e ajo është çështja: Përse KOMRA? Pyetja përse KOMRA është një pyetje legjitime të cilën ne kishim duhur të shtronim gjatë gjithë kohës në këtë proces të konsultimeve. Nëse ne e dimë që këtu kishte pasur konflikt luftime, tash a do ta quajmë një luftë apo konfliktit ushtarak, luftë e armatosur apo diçka të ngjashme për me ua është mjaft relevante sepse një veprim i tillë, ashtu i atillë pas vete la viktima. Kjo është gjëja më e rëndësishme e procesit të formimit të shteteve kombëtare Me shpërbërjen e ish Jugosllavisë, në këto hapësira elitat politike që kanë qenë të formuara, të cilat ishin themeli i këtij projekti shtetëror, në atë moment janë kryesisht, së paku i tillë është rasti në Kroaci, për të cilën unë mendoj se është i vetmi përjashtim te Sllovenia ku elita nacionale formohet rreth së djathtës, apo qendrës e djathtë nga aspekti politikë. Shumica nga ju studion shkencat politike dhe pastaj e dini që ky spektër politik nënkupton vlerat tradicionale apo thirrje në historinë, në rastin e historisë së Kroacisë është histori me shekuj për të cilën do të jenë krenarë Kroatët dhe ashtu disa gjëra ku ka mjaft mite dhe mjaft gjëra të cilat thjesht nuk ekzistojnë. E njëjta gjë është dhe në historinë e Serbisë me betejën e Fushë Kosovës kundër Turq etj. Në atë çast dhe pas luftës sidomos me pas një situatë dhe tani e njëjta situatë ende ekziston se paku në Kroaci është gradualisht duke u zvogëluar ku kemi relativizmin e viktimave, ku thjesht, por ajo është serbe, nuk ka kurrfarë lidhje ne kemi luftuar kundër tyre dhe pse ajo është e vdekur as kënd nuk e intereson. Thjesht është retorikë e cila ishte e pranishme në Kroaci deri në vitin 2000, në këtë kohë është zvogëluar me të madhe. Megjithatë, ajo ende i ka rrënjët e saj. Ekziston edhe një segment i rëndësishëm në relativizmin e viktimave, në qoftë se nuk përcaktohen faktet, nëse nuk e bëjmë regjistrim e numrit të viktimave, do të arrij deri tek licitimi i numrit të viktimave nga serbet. Për me ua personalisht nuk ka asgjë më të gërditshme se kjo. Thjesht, sepse çdo viktimë e ka emrin dhe mbiemrin, çdo viktimë ka një dinjitet dhe çdo viktimë edhe se të paktën është një numër ajo e ka personalitetin e vet dhe nuk me und të thuhet njëqind ose dyqind mijë, nuk me und të thuhet njëqind apo dyqind njerëz, nuk me und te thuhet njëqind ose njëqind dhe një burrë. Thjesht, të gjitha viktimat duhen ta kenë emrin dhe mbiemrin e tyre. Duhet të jenë aty, domethënë të jenë të identifikuar. Dhe një gjë e rëndësishme për të ekzistuar identifikimi i fortë dhe solidariteti me të akuzuarit. Përsëri do të flas nga pozita e Kroacisë dhe Serbisë, e cila më është më afërm se pozita e Kosovës, sepse nuk e di shumicën e të dhënave përkatëse. Ju e keni rastin kur kanë qenë të organizuara gjykimet në Kroaci për gjeneralin Mirko Norca ose kur është kërkuar i arratisuri gjeneral Ratko Gotovina, ku e keni qytetin e Zarit në bregdet i cili është për këta mjaft i orientuar djathtas, kjo do të thotë se në kohë kur është kërkuar i arratisuri gjeneral Gotovina dhe kur aj ka qenë i arrestuar në muret e qytetit i cili ekziston qysh nga koha e venecianëve të lashtë keni pasur

mundësi ta shihni një billboard në të cilin shkruante, „Hero i luftës e jo kriminel i luftës”. Pra ky është një problem për atë se politika e tanishme përdor parulla të tilla, dhe përdor asi grupe ekstreme në shoqëri, dhe për shkak të asaj që praktikon politiken e përditshme çka në këtë rast nuk është mirë. Nuk ka asnjë dënim publik nga të lartët, por nëse vije deri tek kjo edhe vjen çka ka qenë një problem konkret në Kroaci, vjen sepse dikush është duke na vëzhguar nga Bashkimi Evropian. Por pastaj kjo kritikë është shumë e butë. Retorika veçanërisht është duke u ashpërsuar në kohën kur është fjala për zgjedhjet, ato lokale, kombëtare apo presidenciale. Solidariteti, që ndodh me të akuzuarit gjithashtu nuk është mirë. Nuk është mirë për arsye se është e nevojshme që njerëzit e thjeshtë anëtarët e shoqërisë, thjesht t’u shpjegojmë që të lejojmë gjyqet për të bërë punën e tyre. Në qoftë se njeriu është fajtor sepse e ka vrarë, atë, atë dhe atë ai nuk me und të jetë hero. Ai thjesht nuk me und të jetë një hero por një kriminel, shoqëria apo shteti e kanë dënuar, populli apo bartës i sovranitetit i cili e dorëzon atë sovranitetet përfaqësuesve të përzgjedhur me një pjesë ajo kthehet dhe në pushtet gjyqësor. Thjesht aj është i gjykuar dhe nuk është e lejueshme. Qëllimet të cilat janë duke u krijuar, të cilat më pas vijnë nga të gjitha këto ngjarje nga të gjitha prej këtyre janë si më poshtë. Kështu, qëllimet e KOMRA-s të cilat duhet ti arrin: Krijimi i shënimeve zyrtare dhe objektive, krimet dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut dhe ligjit humanitar. Dhe kjo kishte duhur të jetë diku sipas planit të planifikuar në periudhën prej fillimit të vitit 1991 muajit Janar dhe deri tek fundi i vitit 2001 në muajin Dhjetor. Do të thotë prej fillimit të vitit 1991 dhe deri tek fundi i vitit 2001. Një objektiv tjetër e gjithë këtyre duhet të jetë njohja e viktimave. Pra, për rikthimin e dinjitetit të viktimave. Thjesht që viktima mos të jetë vetëm numër, por viktima ta ketë emrin dhe mbiemrin. Javën e kaluar isha në Vukovar, dhe ne kemi qenë në Ovçar në vendin e varrezave masive dhe më pas ne ishim në hangar ku njerëzit u mbajtën përpara se të pushkatohen. Ata kanë bërë atje, domethënë një koncept shumë të mirë që me und të shërbente si një shembull do të thotë si metodë si me und të shënohet me monumente dhe me disa me uze si vend të vrasjeve. Ju keni një super koncept të hapësirës të ndarë si kjo ku brenda e keni shumë imazhe moderne minimale të rënduara të treguara të cilat njëkohësisht drizën dhe ndizen, ku ishin treguar fotografitë e të gjithë njerëzve të cilët u vranë atë natën në Ovçar. Një tjetër qëllim i cili me und të jetë afatgjatë dhe është i rëndësishëm për të parandaluar të keqen mos të përsëritet. Thjesht situata të cilën e përmenda pas luftës dyte botëror ku një ideologji ka provuar më lëvizjet të dhunshme tektonike dhe vrimat të cilat janë bërë më lëvizjet tektonike në brendësi të sistemit të atëhershëm të shoqërisë Jugosllavisë ka përfunduar me katastrofë. E, katastrofë është ajo çfarë ka ndodhur nga viti 1991 deri 2001. Thjesht, parandalimi i krimit nuk duhet të bëhet në atë mënyrë. Çfarë bëjmë ne apo kjo nisma e jonë, është se ishte duhur të ofroj model shumë më të mirë dhe konkret se si ti shmangemi asaj çka ka ndodhur nga viti 1991 deri në 2001. Pyetja radhas dhe do të provoj të jem i shkurtër, është çështja se çka do të jetë ajo. Çka do të jetë një ditë KOMRA? Këtu i kam disa fjalë, ajo do të jetë trup zyrtar, ajo do të jetë trup rajonal, ajo do të jetë trup i përkohshëm, ajo do të jetë trup jashtë gjyqësor, do të jetë e trup hetues, do të jetë trup i pavarur. Unë do të përpiqen të shpjegojë shumë shkurtimisht se çfarë do të thotë kjo. Trup zyrtarë, prapë do të bazohem në fjalimin e Bekimit dhe ketë do ta bëjë edhe disa herë. Jo së jam duke e kopjuar por sepse po përrputhet. Trupi zyrtar do të thotë se do ta themelojnë institucionet zyrtare, apo parlamenti, kryetarët e shteteve, apo qeveritë, trashëgimtarët ligjore të ish Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë. Trupit rajonal do të thotë që do të mbulonte regjionin i cili ka qenë i goditur me

konflikte në territorin e ish Jugosllavisë. Pra, ajo nuk do të jetë komision për të njëjtin rajon, diçka si në Kroaci, apo në Serbi, ose në Kosovë. Ajo do të jetë rajonale, e cila pastaj në princip ndonjë decentralizim dhe bllokim do të jetë i përhapur në të gjitha shtetet. E përkohshme, prapë jam duke u referuar në fjalimin e Bekimit, parashikimi i afatit të qëndrueshmërisë, ai mandat për të cilin Komisioni duhet të veprojnë është tre vjet plus gjashtë muaj, për publikimin e raportit. Jashtë gjyqësor mendoj që këtë e keni të qartë, domethënë komisioni nuk do të gjykojë askënd, askujt nuk do të me und t'ia përcaktoj dënimin me burg dhe gjykata nuk do të jetë në gjendje të ndjekë ndonjë dëshmitar që duan të pranojnë atë që ndodhi, çka ka ndodhur apo për te marr masa te cilat janë të marrë nga dëshmitari, apo nga viktimat. Trupi hetues në masë të madhe lidhur me trup jashtë gjyqësor përkatësisht gjyqësor në mënyrë që do të shqyrtoj atë çka ka ndodhur. Të ndihmon në një proces të ardhshëm gjyqësor, prokuroreve në një mënyrë që të kenë në një vend të mbledhura të gjitha të dhënat për atë çka ka ndodhur për të mundur ti përdor për ti ngritur padit. Çka do të thotë e besueshme, e besueshme dhe do të thotë se komisioni do të përbëhet nga njerëz aktual që kanë kredibilitet dhe integritet. Do të thotë se nuk janë në asnjë mënyrë në lidhje me të gjitha këto gjëra të këqija që kanë ndodhur në territorin e ish Jugosllavisë. Trup i pavarur do të thotë se do të jetë themeluar me vendim të parlamenteve, qeverive, që politika ditore si dhe asnjë politik e cila krijohet në parlamente, apo ne dhomat e presidentëve dhe nuk do të ketë ndikim në punën e trupit. Dhe pyetja e fundit, unë do ta zgjasë vetëm dy minuta më shumë. Dhe pyetja e fundit është Si? Ajo është një çështje që është përsëritur disa herë në procesin e bisedimeve të sotme. Ashtu fillon themelimi i komisionit, për mos të përsëritur, ajo me und të jetë krijuar me vendim të presidentit, qeverisë, parlamentit apo nga institucionet ndërkombëtare si marrëveshje paqësore. Konkretisht e lidhur me KOMRA-n. Në rast të KOMRA-s ishte më mirë se si komisioni të themelohet me vendim të parlamentit, për shkak se komisioni do të ketë më shumë legjitimitet dhe nuk do të lejon që ajo të bëhet me një lloj rezolucion apo me ndonjë lloj të ligjit apo me diçka të ngjashme, varet nga kushtetuta parciale dhe nga praktika parlamentare. Periudha e punës tashme është përmendur tri vjet plus gjashtë muaj. Struktura e Komisionit dëgjuam nga prezantimi i Bekimit si ishte dukur në disa shembuj të tjerë. Struktura e Komisionit duhet të duket si në një mënyrë që do të ishte Zyra Qendrore, pastaj zyrat e komisionit në çdo shtet, këto zyra të Komisionit do të mbledhin dhe të hulumtonin informacion në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe shkelje të ligjit humanitar ndërkombëtar. Zyrë qendrore që të gjitha ato i kishte mbledhur dhe vendosur në një vend, apo do të këtë një arkiv të përbashkët dhe do të organizoj dëgjim publik. Pika e katërt është përzgjedhja e anëtarëve të komisionit apo komisionarëve, nuk do të përsëritet tani dhe do të përpiqet të përmbledhë atë që është e rëndësishme në gjithë këtë dhe se çfarë do të jetë më e mira për komisionin rajonal. Do të ishte mënyra ma e mirë kur këta komisarët do të ishin përzgjedhur si një lloj paneli ose ndo lloj bordi të cilin do ta krijojnë shtetet, ku mendoj çdo shtet do ta këtë një numër të barabartë të përfaqësuesve të cilët pastaj do ti emërojnë anëtarët e komisionit dhe komisionarët. Gjatë kësaj nuk duhet të harrohet se duhet të merret parasysh karakteri i Komisionit Rajonal, çka është një rast unik i historisë të komisioneve dhe drejtësisë tranzicionale, dhe nuk guxon të harrohet përbërja etnike dhe fetare e gjithë rajonit dhe natyrisht këta individë duhet të jenë të përzgjedhur, duhen të jenë profesionist në të gjitha sfera. Komisioni duhet të jetë inter disiplinorë. Komisioni duhet të ketë integritet moral. Komisioni duhet të ketë, apo anëtarët e komisionit duhen të kenë ose duhen të jenë të respektuar dhe të gëzojnë mbështetjen e shumicës të qytetarëve në vendet e

ish Jugosllavisë. Mandati i Komisionit, dhe këtë e kemi thënë ishte nga /01/1991 deri më 31/12/2001. Qëllimi gjithashtu është thënë, prandaj hulumtimi dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, të drejtës humanitare ndërkombëtare, megjithatë, duhet të specifikojë qartë se cilat lëndimet më të rënda do të hulumtohen ndërsa pjesa tjetër të shkoj në themelim, me rekomandime me und të preferohet të themelohet një tjetër trup që do të merret me raste individuale. Në të gjithë këtë ajo çka duhet të jetë specifike për KOMRA-n është se duhet të zbatohen praktika e aktgjykimeve të gjykatës ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe kualifikimet ligjore të cilat mirën nga akt vendimet, dhe të aplikohet praktika e jurisprudencës, ose kualifikimet vendimeve gjyqësore nga Kroacia, nga Bosnja, nga Serbia dhe nga Këshilli gjyqësor ndërkombëtare i Kosovës. Megjithatë në qoftë se nuk janë në kundërshtim me kualifikimet e vendime të gjykatave ndërkombëtare për kundërvajtje për ish-Jugosllavinë. Autorizimet të komisionit. Gjatë autorizimit të Komisionin, ky komision do të mbështetet nga arkivi të gjykatës së Hagës, aty do të duhej të siguroje mundësin e kërkimit por edhe të kërkon marrjen e dokumenteve zyrtar të institucioneve shtetërore. Pra do të thotë Republikës Kroacisë, Republikës Serbisë dhe nga Federatat e Bosnjës dhe Hercegovinës si dhe Republikës së Kosovës, Malit të Zi dhe të tjerave. Këtu duhet të merret parasysh mundësia dhe nevoja e dëshmisë e dëshmitarëve, viktimave dhe kryerësve të krimeve apo nga ndonjë që ka njohuri në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur. E tash, a duhet të jetë ajo vullnetare, a duhet të jetë e detyruar në një mënyrë që Komisioni do ta këtë mundësinë e një lloji të hetuesit parlamentar me besueshmëri e cila do ti detyron në mënyrë të këtë detyrim ligjor të përgjigjet komisionit. Ajo me und të jetë e mundur të zbatohen në territorin e ish Jugosllavisë, por patjetër që është e vështirë të aplikohet për qytetarët e shtetit zyrtar ndërkombëtarë organizatave që kanë punuar në territorin e ish Jugosllavisë, të cilët janë shtetas të vendeve të tjera që nuk i përkasin këtij rajoni. Me gjithë se është debat i hapur për të cilin duhet të gjejmë një mënyrë dhe me gjëra të tjera. Metodologjia e punës është shumë e rëndësishme, këtu, dhe ajo që ishte e ndarë në zyrën e shtetit, shtetet të cilët gjenden në atë. Ato punojnë në këtë teren dhe të grumbullojnë të dhëna, deklaratat, materialet të shkruara, foto dokumente, video incizime dhe gjëra të tjera. Arkivimi bëhet te ata dhe i lënë në vendin qendror dhe gjëja ma prioritare në të gjithë këtë është një dëgjim publik i viktimave të organizuar nga zyra qendrore me mundësisë mbi administrativin e viktimave gjatë një dëgjimi publik. Duhet bërë shumë metodologji specifike dhe shumë të ndjeshme ku duhet të përfshihet një rreth i gjerë i njerëzve duke i dhënë përparësi psikologëve. Të cilët do të diskutonin me viktimat dhe thjesht duke i përgatitur për proces dhe t'iu japin atyre mbështetjen psikologjike e nevojshme për vazhdimin e jetës më vonë. Pika e nënte i jep përparësi rolit te organizatave joqeveritare unë do të thosha të rinjve, studentëve, por unë e shoh si rolin e të rinjve por për të gjithë sektorin është një mënyrë e sigurisë që ne jemi mbledhur këtu si një iniciativë e cila ishte e nxitur nga tri organizata joqeveritare. Ky numër i organizatave jo-qeveritare është rritur siç e shihni në 150 plus 200 individë, thjesht nevojitet një masë e tillë e cila duhet të vazhdonte punën. Kjo masë duhet të përdoret në momentin ku duhet bërë presion në shtete, qeveri, parlamente, kryetarë të shteteve për formimin e këtij komisioni. Thjesht kjo pjesë është e rëndësishme nëse dëshirojmë që ky komision të gjallërohet, se pa këtë presion i cili vjen nga brendësia por edhe me përfshirjen e organizatave ndërkombëtare. Nga presioni që vije nga jashtë, frikësohem që kjo iniciativë pastaj do të ishte e humbur. Thjeshtë nuk do ta kem, jo në kuptim të kotë që këtë nuk po punojmë asgjë në dobi gjë që nuk do të jetë e shkruar, që nuk do ta arrijmë efektin e dëshiruar.

Në pikën e dhjetë që përfshinë rolin e mediave, këtu sot është përmendur disa here mediat. Në procesin e konstatimit me të rinjtë, më shkencëtarë, më grupe tjera sociale civile, të përfolura janë dhe ende do të përfolën konstatimet me media. Do të thotë që duhet të punohet edhe me media. Pse? Sepse mediat tërë kohën kanë qenë të mësuar, sidomos nëse marrim një hapësirë kohore të gjerë. Mediat kanë ardhur dhe kanë ndikuar në brendësi të diktaturës, në sistem të komunizmit dhe në shek. XX prapë janë nën presion, censurë e cila në këtë rast është produkt i shteteve nacionale ku më së shpeshti në Serbi dhe Kroaci janë instrument propagandë të luftës dhe inkurajim i urrejtjes ndëretnike. Me mediat gjithashtu duhet të punohet ky proces, duhet të zhvillohet paralelisht me tërë këtë që në moment kur ata do të jenë më se të duhur, dhe ky është momenti kur duhet të bëjnë presion mbi qeverinë, kur duhet për të mobilizuar të gjitha forcat në dispozicion dhe fuqitë me qëllim të mirë brenda shoqërisë ku njeriu do të luajë një rol shumë të rëndësishëm, sepse ata janë thjesht disa relej si një transmetues, një rrjet i cili e transmeton idenë të cilën ne sot jemi duke e zhvilluar në hapësirë pa ajër, ku ata do të duhen të transmetojnë në shoqëri më të gjerë, dhe për atë shkak më të vërtetë më pëlqen iniciativa nëse e kam kuptuar mirë këtu Integra do ta kryen punën me radio stacione lokale, çka është për tu lavdëruar. Dhe e fundit gjë që është shumë e rëndësishme të cilën Bekimi tashmë e ka përmendur raportin. Raporti, përveç se është libër e këtë së paku do ta lidhi më rastin në Peru, në rastin e Argjentinës ku libër u bë libri ma i miri (Best seler), „Nunka Mas,, "Unë supozoj se aty do të jetë një numër i madh materialit dhe kur tani në këtë mënyrë hynë në operacionalizim, thjesht kur keni këtë sasi të materialit që do të shërbej kryesisht shkencëtarëve për disa hulumtime në të ardhmen aty duhet të theksohen disa strukturime dhe një përmbledhje e atyre që shoqërisë civile ajo do të jetë e pranueshme dhe e thjeshtë të jetë në gjendje për ta kuptuar se çfarë është ajo. Pra, raporti është produkti i komisionit në rastin tonë, në fakt në rastin e KOMRA-s i cili duhet të zhvillohet në tri vjet, plus faza e gjashtë muajve ku ky raporti do të jetë i përfunduar, i përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare të ish-Jugosllavisë dhe ku duhet të prezantohet publikisht. Një tjetër gjë rreth pjesës punuese finale të projektit janë rekomandimet që me und të janë obligime, dhe të cilët nuk duhen të jenë obligative. Unë mendoj se për çdo rast kishte qenë mirë, kur punojmë në këtë iniciativë duhet përpjekur të bëjmë presion mbi parlamentet, qeveritë, presidentet e qeverive të shteteve. Rekomandimet që do ti jep komisionit do të jenë obligative. Përse unë flas në këtë mënyrë, flas për shkak se komisionit në të gjitha këto, tani do të ndërlihem me atë që kam thënë më parë. Komisioni në të gjithë këtë analizë të ngjarjeve që ndodhën, në të gjithë këtë numërim të viktimave me und të jap kontribut të madh në stabilizimin dhe ri këmbimin e të gjitha shoqërive tona. Domethënë, nuk flasim për bashkëjetesën, por mbivlerësimet për të folur për jetën. Që shoqëritë tona të afrohen bashkësisë ndërkombëtare të cilës pa kurrfarë dyshimi i takojmë por në vetë duhet ta punojmë një pjesë të punës tonë. Atë çfarë shoh unë prapë do të përsëris dhe do të përfundojë atë që unë shoh në këto rekomandime si një gjë e madhe të ardhmen, e ardhmja që do ta siguron të ardhmen jo vetëm neve, fëmijëve tanë, brezave të ardhshëm. Thjesht, elita politike e humb hapësirën për manovrim dhe manipulim. Thjesht, për të detyruar sistemin arsimor, për ta detyruar bashkuesin fetare dhe sistemin arsimor me qëndrimin e saj ndaj ngjarjeve të fundit, por jo vetëm pranë njërit, por në bazë të ngjarjeve që kanë ndodhur në vitet e '40 dhe pastaj në vitin 1999 në ish-Jugosllavi. Si lëndë në arsimin kombëtar duhet të futet edukimi arsimor për drejtat të njeriut, si siguri e vetmja e mundshme që me und të siguroj shoqërinë tonë në përgjithësi, shoqërinë e tërë botes që përsëri mos të vijë deri në këtë konflikt. I

vetmi ilaç kundër kësaj është toleranca të jetojmë me të ndryshmit dhe të pranojmë diversitetin si diçka e madhe. Përsëris, përsëri atë çka thashë më parë, njerëzit nuk janë të njëjtë, njerëz janë të ndryshëm dhe ajo është mirënjohje, njerëzit vetëm i kanë drejtat të barabarta, dhe e drejta në radhë të parë është për ti respektuar të tjerët, dhe për t'i përmbajtur fjalës e urtë popullore: „Liria ndalohet aty ku fillon liria e të tjerëve”, kjo është formë ulë të cilën komisioni duhet ta theksoj dhe cila ofron mundësinë që kjo do të përfundojë mirë. Unë ju falënderoj, ju falënderoj përkthyesve, shpresoj se nuk kam folur shpejt dhe shumë ju falënderoj.

Kushtrim Koliqi: Shumë faleminderit zotëri Ivan se faktikisht e ka bërë sqarimin e idesë komisionit Rajonal, ndoshta deri në momentin kur Ivani kolegë nga Kroacia e ka shpjeguar KOMRA-n, ndoshta për të gjithë në ka qenë pak e pa kapshme se qysh kishte mundur më funksionuar KOMRA. Çfarë është KOMRA, çfarë është ky komision rajonal, domethënë, pak a shumë na u kanë bashku krejt pjesë që janë dashtë me i dit për me krijuar një koncept se qysh kishte mundur me qenë një komision rajonal në trojet e ish Jugosllavisë. Tash është koha kur, faktikisht s'kishte qenë mirë ju me dal nga kjo sallë me një paqartësi me një breng. Ju kisha lut që kujt do nga panelistëve këtu të bëni pyetje direkte edhe kritike edhe pyetje sqaruese që ju kur të dilni nga këtë të dilni me një mendim të plot personal të juaj. Masë pari çka është, pse u mbajt ky konsultim, dhe çka është KOMRA, dhe masë andej mendimi i juaj personal, a është i vlefshëm a nuk është i vlefshëm me u themeluar dhe me funksionu një komision tillë në territorin e ish Jugosllavisë. Ju ftoj për pyetje. Më duket Krisitjani e pat të parën, pastaj vazhdojmë me tjerë. Tani vazhdojmë më atë çiken.

Kristijan Hasani: Kristijan Hasani, student i shkencave Politike. Pata një pyetje për zotëri Blakaj me qenë se ai i pari filloji të flas për konceptin e KOMRA-s. Sa mendoni zotëri Blakaj se komisioni rajonal për zbardhjen e së vërtetës me und të jetë funksional në një kohë ende të trazuar, ku veç vazhdon pothuajse me ritme të njëjta, të ushqehet një ndjenjë e fort nacionaliste nga të gjitha palët, qoftë nga ana e viktimave, të pësuarve, dhe kryesit e këtyre krimeve, kur veç dihet që për zbardhjen e çështjes e tillë kësaj nevojitet një kooperim të përbashkët e të gjitha palëve. Pra sa mendoni ju se, e dimë faktikisht se personat kompetent të kësaj iniciative do të jenë tamam kompetent dhe asnjanshëm sepse është siç e thatë edhe ju është Rajonal. Por dihet që për zbardhjen e së vërtetës pos dëshmisë të viktimës duhet të jetë bashkëpunimi dhe kooperimi palës tjetër në këtë fakt palës Serbe. Sa mendon që ndijën nacionalistë dhe urrejtje ndëretnike me und ndikoj që ti jepen dëshmitë ndoshta në kah të gabuar dhe sa mundet të paraqet nacionalizmi problem për këtë Komision.

Bekim Blakaj: Kristijan faleminderit shumë për pyetjen. Ke të drejtë, tensionet ndëretnike dhe ndërshtetërore tani janë ende shumë të mëdha. Për fat të keq është bindja e imja që ato vetëm po thellohen edhe më shumë. Pse? Ka arsye të ndryshme por me u më duket se një arsye janë edhe paragjykimet edhe informimi i gabuar, ose dezinformoimi. Besoj se krejt kjo kishe me qenë ndryshe sikur se marrim hipotetikusht ky komision ka dal me prodhimin e vetë, respektivisht më raport. Ndryshe kishin reaguuar njerëzit kur kishin pa, i kishin lexuar faktet, kur i kishin dëgjuar njerëzit çka kanë përjetuar besoj që kjo e kish krijuar një platformë ngadalë me u ftoh gjakrat edhe më pranuar së vërteta. E përmende domethënë bashkëpunimin e palës serbe decidivisht. Sa i përket shoqërisë civile, unë mendoj se në Serbi ekziston një pjesë e shoqërisë civile cila është e

shëndosh në kuptimin e saj që edhe po tenton maksimalisht që të krijohet ky komision, me u atë që edhe në Serbi të dëgjohet se çka ka ndodhur në Kroaci, se çka ka ndodhur në Bosnjë çka ka ndodhur në Kosovë sepse më në fund të fundit ajo e vërteta është shumë e nevojshme për vetë shoqërinë Serbe, për vetë ata është shumë e nevojshme por edhe për të gjithë të tjerët. Besoj se shumë shpejt më kishte ardhur ndonjë pyetje kështu që po mundona me u përgjigj para që më shtron pyetje dikush. Edhe kjo ndërlihet me pyetjen tënde. Me qenë se këtë komision, komision rajonal duhen me nënshkruar komisionet e gjitha shteteve në rajon. A ka me nënshkruar Serbia në qoftë se pranon ende Kosovën që s'ka asnjë marrëdhënie zyrtare. Këtë përgjigje ende se dimë, por ideja është se një moment të caktuar, besoj në fund të procesit të këtyre konsultimeve që të fillohet një kampanjë mediave edhe një kampanjë tjetër se çka të bëjmë me mbledhjen e nënshkrimeve të vetë qytetarëve, të mbledhin një milion nënshkrime edhe ato një milion nënshkrime janë shumë valide. Kur ti afroresh dikujt qoftë aj kryetari shtetit me një milion nënshkrime atëherë e ke një bazë të fortë. Prandaj unë besoj se në një të ardhme të afërt është i mundshëm krijimi i komisionit e mandej do të flasin faktet. Definitivisht kur të ofrosh fakte nuk ka mundësi për manipulim apo diçka tjetër. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Më duket ajo në të vjollce.

Liridona Neziraj: Unë kam një pyetje për kolegun nga Kroacia. Jam Liridona Neziraj nga Gjakova desha një pyetje për kolegun. Çfarë kriteresh duhet plotësuar një person për të marr pjesë në këtë komision, niveli shkollimit sa duhet të jetë, edhe a duhet të bëhen trajnimet për këta persona jashtë shtetit për të marr pjesë në këtë komision. Çfarë qasje duhet bërë?

Ivan Novosel: Kur flasim për kriteret, ato janë ende te shtruar për shqyrtim, modelin të cilin ju prezantova unë nuk është ende i përfunduar, në atë ende duhet edhe shume të punohet. Ndoshta kam harruar t'iu tregoj për atë arsye tash do ta shfrytëzoj këtë rast. Këtu do te ketë, në brendësi të punës të komisionit kemi dy lloj punë, vrazhdë folur më së paku dy lloj punë. Në një anë kemi vetë komisaritet apo anëtarë të komisionit, e tash desha të pyes a menduat se çfarë kushte ata duhen të parashtrjnë apo keni menduar në diçka tjetër, domethënë çfarë kushte ata duhen te parashtrjnë. Aha... Domethënë në përgjithësi të këtij projekti. Ende nuk është KOMRA, ende nuk është komision regjional, do të bëhet komision regjional në moment kur qeveritë, parlamentet apo kryetarët të shteteve janë te gatshëm të themelojnë këtë komision. Ende është iniciativë për themelimin e KOMRA-s, iniciativa e shoqërisë civile, vetë pjesëmarrja e juaj e tregon këtë. Në cilën mënyrë do të bashkëngjiteni, të japim participim ma tutje varet vetëm nga ju. Unë supozoj sepse kështu është edhe në Kroaci, për atë supozoj që situata është e njëjtë gjithkund kush është i gatshëm për të punuar do ti gjendet hapësira për të punuar. Ajo është e qartë vetë prej vete. Në fazën e ardhshme prapë jam duke folur me hipnotizëm, kur të vije deri tek themelimi i KOMRA-s, në një ane do ti kemi komisaritet, që domethënë anëtarët të komisionit. Se sa veta kanë me qenë ata ende nuk është duke u ditur, në anë të tjetër do ti keni operatorët të shprehem ashtu, njerëzit të cilët veç tani kanë provojë, kanë punuar ne organizata joqeveritare, të cilët kanë punuar në këtë iniciativë, të cilët do ti mbledhin të dhënat, te cilët do ti përcaktojnë punët, që domethënë parapërgatitjen për punën e komisioneve. Nuk mundem tash të presim, jam duke folur për mëndë, por le të themi nga dymbëdhjetë apo trembëdhjetë komisar qe të vizitojnë te gjithë regjionin dhe të bisedojnë me të gjithë viktimat. Për të kryer gjithë këtë punë

ju duhej nja gjashtëmbëdhjetë vite, çka nuk do të ishte e mjaftueshme. Kushtet të cilat janë deri tani të njohura komisarit duhet ti plotëson. Për tu bërë komisar janë të parapara në një pjesë kur kjo iniciativë të prezantohet shteteve. Supozoj, se do të jetë kriter që ai person nuk ka qenë i përzier në krime të luftës në asnjë kontekst negativ. Me siguri si një nga kushtet do të mirët dhe parapërgatitja shkollore e tyre, nëse janë shkencëtar në cilën lami janë duke vepruar, sepse, komisioni do të jetë multi disiplinorë dhe këta persona duhen ta kenë besimin e shumicës të popullit të shteteve të ish-Jugosllavisë. Nëse këto kushte themelore nuk janë të kënaqshme, dhe në çast kur themelohet komisioni i kemi komisarët të këqij, të cilët nuk e kanë besimin e plot tek populli, në anë tjetër me und të shfaqet që nuk janë të pranuar nga sektori i organizatave joqeveritare, shumë thjesht puna do të dështoj. Shpresoj kolege që kam qenë i qartë.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit. Ok. Veç ta mbajmë një rend më duket ajo vajza me syza të kaltër, vazhdo, vazhdo.

Lirije Avdiu: Unë po kthehem në fillim aty ku zonja Shukrije Gashi tha një fjali mbresëlënëse që me ua më bëri shumë përshtypje. Ishte pikërisht ajo fjalia. Ne rregull më fal. Unë jam Lirije Avdiu. : Unë po kthehem në fillim aty ku zonja Shukrije Gashi tha një fjali mbresëlënëse që me ua më bëri shumë përshtypje. Ishte pikërisht ajo fjalia,, në vendet e ish Jugosllavisë nuk duhet më të gjej përdorim të jemi armik. Këtu natyrshëm lind pyetja se si mundet që të arrihet gjë e tillë, kur kemi parasysh se ne u ritëm me bindje se kemi armiq, armiq tonë pra serbët na ushqyen neve me urrejtjen ndaj tyre. Edhe si me und të arrihet që ne të mendojmë se nuk kemi armiq kur merren parasysh rrethanat dhe kushtet në cilat ne u ritëm.

Shukrije Gashi: Që të eliminohet shprehja armik, është e nevojshme në të cilët gjithë populli e përjetuam luftën ose konfliktin, ose goditjen në çfarë do forme qoftë që të distancohemi prej veprimtarive të tilla, që të vlerësojmë se çka solli veprimtaria kriminale. Kur të rezonojmë në këtë formë atëherë do të vijmë deri tek përfundimi sepse revanshizmi sjell revanshizëm dhe armiqësia vazhdon të ritet, vazhdon të kultivohet. Për t'i prerë rrënjët revanshit dhe mundësisë së mbjelljes armiqësisë, urrejtjes në mesin tonë në fakt ne duhet ta bëjmë të kundërtën. Ne tash duhet të mos të harrojmë të kaluarën me qëllim të mos na përsëritet dhe të përqendrohemi në të ardhmen e cila krijon hapësirë për me gjet terrenin e përshtatshëm të zhvillimit të idesë të iniciativës për krijimin e KOMRA e cila do të jetë një mundësi e mirë për secilin prej nesh këtu dhe jashtë kësaj sale kudo në ish Jugosllavi që nga fjalori i përditshmërie jonë të zhbëhet njëherë përgjithmonë termi armiqësi dhe zëvendësohet me termin miqësi. Kjo natyrisht që kërkon, me und të kërkon sakrificë unë jam shumë e sigurt se çka do qoftë që ne do të synojmë që të bëjmë në të ardhmen e afërt do të jetë e pamundur që deri në masën ideale të baraspeshohet interesat e ndërsjella, të bëhet qetësia shpirtërore në mes të viktimave të vendeve të ndryshme mirëpo secila iniciativë e ngjashme kërkon sakrificë. Ne gjithë dimë se edhe në rastin e Kosovës një shembull analog të marr është pakoja e Ahtisarit për cilën zgjidhje (Pako) nuk jemi asnjëri plotësisht të kënaqur, mirëpo u deshtë që të bëhet një arritje marrëveshje të tilla e cila është e dhimbshme por ishte e vetmja mundësi. Prandaj edhe çështja e idesë të komisionit rajonal me und të ketë sekuenca të cilat janë të dhimbshme mirëpo vetëm më një zgjidhje të baraspeshuar me qenë se ka shumë shtete do të me und të gjejmë përkrahje të shpejt dhe të madhe nga bashkësia ndërkombëtare për faktin se nevojat e zgjidhjeve së problemeve të tilla kërkojnë shpejtësi në

kohë. Bota nuk ka kohë me tempon me të cilën po zhvillohen ngjarjet në botë që me dhjetëra vite të tëra të merret me raste veç e veç. Prandaj për një qasje racionale, të shpejt në të cilën kanë me përfituar të gjithë është pikërisht e mirë ideja e REKOM-t. Në këtë aspekt në veçanti ka rëndësi perceptimi i ynë kësaj ideje nga aspekti i miqësisë se sa të perceptojmë nga kënd vështrimi i armiqësisë. Është e nevojshme domosdoshme që ne të pastrojmë në radhë të pare me ndërgjegjen tonë, të vetën se a jemi të gatshëm, sa jemi të gatshëm të sakrifikojmë dhe pse po sakrifikojmë. Kjo domethënë është një sqarim që me und të jap.

Kushtrim Koliqi: Zonjusha atje.

Krenare Imeraj: Unë jam Krenare Imeraj, desha ta parashtroj një pyete në të cilën cili do nga ju me und të përgjigjeni. Pyetja ime është, unë e dëgjova bisedën deri tash dhe shumë herë u cek kthimi i dinjitetit të viktimave, në q 'mënyrë mundeni ju si komision më ja u kthyer dinjitetin viktimave, ndoshta në mënyrë verbale, ndoshta besoj se nuk me und të kthehet dinjiteti i viktimave. Kjo ke pyetja ime qysh, në q 'mënyrë?

Bekim Blakaj: Faleminderit për pyetjen. E di qe kemi shumë pak kohë por më duhet me u mundu me iu përgjigj pyetjes sate. Përderisa viktimat përmenden vetëm si numra kaq janë të vramë.... Se di çfarë problemi është unë e kam shkyç telefonin se di. Përderisa ata numërohen vetëm si numra edhe manipulohen me to jo kaq janë qenë jo kaq, jo s'janë kon kaq, jo ata nuk kanë dinjitet. Nuk mjafton as mi bo listat e tyre. Një dinjitet moral atyre dhe familjarëve të tyre kthehet në momentin kur pranohen si viktimë. Pranohet se ata i kanë vra. Po ne jemi kryerësit e krimeve, kërkojnë falje ajo është kthimi i dinjitetit. Domethënë, jo vetëm mi numëruar si numra, ata kanë familje, ata kanë shtëpi, iu mungojnë familjarëve të tyre shumë, shokëve, miqve, mirëpo përderisa ne heshtim edhe u përmend sot njëherë në vit i përmendim dhe ju shkojmë në varrezat e tyre, atëherë atyre nuk ju ka kthyer dinjiteti. Kjo është mënyra për me u ju kthyer atyre dinjiteti, së paku dinjiteti moral. Me fol hapur, me fol me zë, për ta, jo me na mbet një herë në vjet me i përkujtuar në gazeta ose me ju mbajt një komemoracion. Domethënë këtu është qëllimi, është për fjala dinjiteti moral. Përderisa ata ende nuk njihen të tillë nga të gjithë se kanë humbur jetën, qe janë të viktimizuar atëherë nuk ju ka kthyer dinjiteti. Domethënë jo është përgjigja ma e shkurt e imja.

Kushtrim Koliqi: Më duket që ke ajo zonjusha, zotëria, tani ju tre. Se kështu më duket se i pashë.

Shukrije Ahmeti: Faleminderit. Jam Shukrije Ahmeti, kisha dashur me ja bo prapë një pyetje zotëri Bekimit : Nëse mendoni se do te arrijmë deri te disa fakte për të që kanë kryer disa krime në kohën e luftës, mendoni se ata persona do të dalin e dënohen dhe tamam ta marrin dënimin qe e meritojnë. A mendoni që ne do arrijmë qe po i na dërgojnë në këto mbledhje ose sadopak te dënohen ato persona. Faleminderit.

Bekim Blakaj: Po sot unë e përmenda pak ma herët, se për fat të keq procesimi i lëndëve për krime lufte, për vrasje, për zhdukje, është minimal nuk mundet me kon ma minimal. Edhe e përmenda faktin që komisioni së paku në përvojat e të tjerëve që folëm sot në shumë raste ju ka ndihme uar gjykatave, që të marrin prova shtesë për këto krime. Ka prova unë e di që ka prova

ne problem kem në fakt edhe çështjen e mos qasjes të institucioneve tona, për në përndjekje te policisë në kryerje të veprës. Tani, të jem i sinqertë shumica kryerësve të veprës janë nëpër Serbi, nuk ekziston mundësia eskadimit për shkak mos njohjes dhe kështu me radhë. Janë duke u zhvillu disa procese, është në përfundim një proces gjyqësor në Serbi për një masakër që ka ndodhur në Suharekë besoj se ju të gjithë e keni ndjekur sepse janë duke e përcjell mediat. Dua me ju tregu diçka shumë interesant edhe pse nuk ka të bëjë me përgjigjen tonë, me pyetjen tënde. Kemi raste ku pjesëtarët e njërive të ndryshme, njësit të cilat kanë bërë krime, janë ofruar vetë me japë dëshmi për atë çka ka ndodh. Pa kërkuar dhe pa aplikuar për ndonjë amniston, diçka thjesht i ka përndjekur e kaluara dhe ju kanë ofruar edhe organizatës tonë por edhe gjykatave për me dëshmuar për atë çka ka ndodhur. Kjo më jep shpresë që bile një pjesë e madhe e krimeve që kanë ndodh gjenden kryerësit e veprave dhe ballafaqohen me drejtësi. Faleminderit.

Liridon Jetishi: Edhe një herë Liridon Jetishi. Kështu, pyetja është kështu, edhe si pyetje por mundemi me konkludu të gjithë biseduesit këtu. Për shembull ato viktimat të cilat janë në moshë të shtyrë ato veç po vijnë deri tek zhdukja e tyre, domethënë ata po shkojnë po treten dhe po metë ajo ngjarja pa u tregu ndaj askujt hiq. Kjo është njëra ndër pikat. E dyta në Shtetet të Bashkuara të Amerikës ka disa instrumente që kur e kanë pa se kriminalitetit po zhvillohet në atë masë kur s'kanë mundur mi zbuluar te gjitha veprat penale, kryerësit në shtet. Kanë vendos, kryerësit e veprës penale të paraqiten në gjykatë e tregonin çka kanë bo qysh e kanë kryer veprën penale dhe kurrfarë mase penale nuk do të merret ndaj atyre. Nuk do të gjykohen edhe kjo do të ndihmonte njerëzit si është kryer vepra penale, si është kryer krimi, në njëfarë mënyre do të kërkon falje ndaj atyre personave që kanë kryer edhe e fundit, po mundohen na thamë me ngrit monumente, gjëra të tjera, të cilat do ti ndihmonin viktimave. Për shembull prapë po e marrim burgun e Dubravës erdh ftesa për me shku në një inaugurim përmendore e burgun e Dubravës. Edhe kur shkuam ne burg aty gjysma i kishin ra pishman pse janë shku. Masakra ka ndodh brenda në burg ata e kishin bo përmendoren në një livadh, çka po i vyen ajo përmendore ku ja kanë bo. Le të bëhet në vendin e ngjarjes, nëse kemi nevojë për një metër katror në dhjetë kilometra e gjejmë një metër, nuk është problem tek e mrama qatë metër e marrim në oborrin e dikujt për viktimitë e lëshon me të vërtet që ia lëshon. Është problemi që s'po nderohet viktimat ashtu siç i ka hije dhe këto probleme ne si grup, si student duhet mi jep ka një mendim edhe me ardhur deri tek përfundimi. Kaq pata.

Bekim Blakaj: Faleminderit Liridon. I ke prek disa çështje me shumë rëndësi, i përmende viktimat që janë moshë të shtyrë, a ke ti ndonjë propozim se çka ish dashur me bo.

Liridon Jetishi: A ka propozim ma të mirë si këto organizata kinse po merren me këto punë dihen së pari kush janë ata njerëz, aktiviteti i tyre, ne dimë se ka komisione që kryen punë ndërtimi pa leje vë vend se me shku me këqyr mbindërtimin pa leje shkojnë pinë kafe në Gjermi apo diku tjetër. Kështu po ndodh problemi edhe me komisione edhe me shoqata te cilat janë në terren. Po dua me thënë, shembull më të thjesht nëse e merr një gotë me dërguar në kuzhinë dërgoje, me kryer një punë krye nëse jo deklarohu se nuk mundesh me kryer dhe mos varet një provë ose një fakt në ty kur ti po e zhduk vetë ato. Të jenë njerëz të cilët e fitojnë besimin e popullit qe po e kryen një punë të ndershme. Se kjo tek e fundit është historia e kombit shqiptar në përgjithësi. Edhe për krimet që i ka kryer Federata e Republikës Serbe.

Kushtrim Koliqi: Po më duket që ju po mendoni, që mos me prit me u themeluar komisioni, organizatat te cilat momentalisht merren me këto punë sa shpejt me prioritet tyre me pas grumbullimin e informatave të dëshmitarëve, te viktimave te vjetër, domethënë që janë në moshë. Një nga konkluzioneve ma direkte që tash ku me di, edhe nuk ka me u zgjat për me u bo ai komision. Kështu qe ajo dihet se ato fakte që mblidhen prej këtyre organizatave kanë mi shërbyer atij komisionit. Kështu ndoshta është dashtë me u marr me iniciativë prej këtyre organizmave që veprojnë jo vetëm në Kosovë po në krejt rajonin ku ka pas luftë.

Ivan Novosel: Operon misioni i bashkësisë evropiane EULEX-i më korrigjoni ju lutëm nëse gaboj, por mendoj se atë mision e ka pranuar edhe Serbia sikur legjitime. Si vazhdim i UNMIK-ut do të thotë se është mjaft i ligjshëm në të njëjtën mënyrë në të cilin ka qenë UNMIK-u më rezolutën e këshillit të sigurisë... Gjysmë, gjysmë. A është,apo jo. Po,mirë. Kështu, me ua këtu me duket se dera është e hapur, sepse në fazën e mëparshme dhe Bekimi foli për atë si dhe unë e kam përmendur më parë me und të jetë krijuar nga shtetet, institucionet shtetërore por me und ta krijon dhe organizata ndërkombëtare. Por edhe, në rregull, institucioni apo Unioni Evropian një lloj organizatës ndërkombëtare dhe konfederatat dhe federatat tani është ende shumë konfuzë varet nga interpretimi. Është e avancuar që me und të krijohet një konsensus dhe një zgjidhje do të thotë se në qoftë se shikohet pastër strikte të drejtë ligjore në qoftë se Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina nuk e njohin pavarësinë Kosovës me und te vije deri tek zyrtarizmi i misionit lidhur mbi bazën të këtë misioni. Me të vërtet nuk mundem të ofroj një përgjigje më të mirë, mundem vetëm të ofroj hipoteza PR arsye se ende nuk ka arritur deri të faza e operacionalizimit. Ende do të kaloj një kohë deri sa ky komision të gjallërohet deri atëherë unë sinqerisht shpresoj se do të bëjmë që gjërat do të zgjidhjen mirë dhe të dalin në dritë.

Kushtrim Koliqi: Kemi edhe 3 pyetje deri në fund zotëria.

Lavdim Rizani: Lavdim Rizani student nga Shkencat politike pyetja është për ju për panelin e juaj pra çfarë mendoni ju se ky komision do të jetë legjitim dhe pranohet nga këto vende edhe çfarë mendoni ju se a do të jetë ky i ndarë nëpër departamente do me thonë të mirët më disa çështje apo vetëm më një çështje të krimit do më thonë se na tregoj ky ma herët që zotëri Beka na tregoj që ka pasur në vende të ndryshme mirëpo ato kanë qenë të ndara nëpër departamente të ndryshme këto komisione çfarë mendoni në Kosovë të mirët vetëm më një çështje a në disa çështje dhe ta di njërën apo tjetrën po ose jo apo pse njëra e pse tjetra vetëm desha të lidhem pak më zotëri Ferizin këtu thotë se ka argumente për këto krime të kryera dhe kanë nëpër organizata të ndryshme e vërtet oshtë që kanë organizata mirëpo pse këto nuk adresohen në vendin e duhur pse mbeten kështu vetëm tubohen e mbetën nuk adresohen në vendin e duhur tek organet kompetentë cilat do të merren me këto çështje. Faleminderit

Kushtrim Koliqi:Më fal ju kisha lut që ju që jepni përgjigje në mënyrë koncize me jep përgjigje më shkurtimisht që më pas sa më shume pyetje e sa më shume sqarime do më thonë momentalisht i kemi 2 pyetje.

Bekim Blakaj: Në mënyrë koncize se di po bëjë shaka po në fakt Ivani e sqaroj shumë mirë që ende në fakt duhet shumë me u debatuar në lidhje me mandatin e komisionit do më thonë në këtë moment nuk mundem më jep PO nuk mundem me jep në pyetje se çka është ideja. Ivani tregoi që të jetë një zyre qendrore të komisionit edhe mandej në çdo shtet të rajonit ka një zyre nacionale që të do ti koordinonin punët e tyre do më thonë kjo është ideja e sa i përket mandatit ose shkeljeve më të cilat shkeljeve të drejtave të njeriut më të cilat do të merret komisioni ende nuk ka një konkludim në lidhje me këtë. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Abdullah

Abdullah Ferizi: Mundem veç me dhanë mendimin tim personal e dini ju shumë mirë që vendi ku jetojmë dhe koha ku jetojmë është shumë e ndikuar prej vendimeve që në fakt nuk merren në Kosovë edhe nëse shikon kohët para luftës ndoshta edhe në vetë luftën ki implikimet e akterëve të ndryshëm edhe qendrave të vendosjes të ndryshme momentalisht për Kosovën e keni pa edhe vetë gjithë ky proces sidomos pas luftës ki pas raste kur informatat nuk jepen edhe prej po e zëmë prej KFOR-it si është dashtë bile në këtë drejtim më dhanë informata e leni ma sa lëndë i keni të pa shqyrtomë në UNMIK. Bekimi përmendi sa lënda janë të shqyrtuar prej gjyqësorit kështu që edhe nëse kanë këto informatat janë jashtë, janë të mbledhura nevojitet me pa diçka më informata. Organet ekzistuese nuk janë aspak nuk kanë bo dej tash mjaft me informata kështu që prapë po përzihem të ajo që po mendoj që kish mundur me ju dhënë peshë këtyre argumenteve që janë mbledh.

Kushtrim Koliqi: Kjo është faktikisht suma sumarum përgjigja është nuk ka kush me ju financuar momentalisht. Politika momentale kompetencat momentale ata njerëz që i kanë, institucionet që i kanë nuk janë të interesuar mi shqyrtuar kështu që faktikisht nuk ka adresë të saktë ka me shkuar.

Bekim Blakaj: Nëse më lejohet vetëm një sqarim i vogël do më thonë janë bo shume kallëzime penale këtu e çështja është se sipas ligjit në fuqi nuk mundet me u mbajtur një proces gjyqësor ndaj një personi në mungesë. Se di apo më kupton. Për derisa nuk nxihet i dyshuari nuk ka proces gjyqësor, prandaj edhe janë bllokuar lëndët dhe janë mbledhur pluhuri. Më fal.

Kushtrim Koliqi: Pyetja e parafundit. Zotëria.

Besart Metaj: Faleminderit shumë edhe unë jam Besart Metaj prej Gjakova, student i vitit të dytë në fakultetin Juridik. Unë desha faktikisht të përkrah mendimin e Liridonit edhe të kërkoj faktikisht një sqarim të shkurt nga ju. Unë shumë mirë pajtona me Liridonin që bëri pyetjen se çka do të bëhet me viktimat apo dëshmitarët të cilët kanë qenë pjesë e masakrave, të cilët janë momentalisht në moshë të shtyrë. Duke pas parasysh që ata dita ditës po kanë probleme psikike, mendore disa prej tyre po ndërrojnë edhe jetë, kështu që më largimin e tyre nga kjo jetë. A mendoni që është shuarja e atyre fakteve edhe ne po shpresonim më së shumti në këtë koalicionin për KOMRA dhe shpresonim se sa ma parë të formohet dhe të mobilizohet me strukturat të veta të cilat i ka, sepse ne jemi dëshmitar që lufta në Kosovë ka përfunduar që dhjetë vite. Që respektivisht për 2000 dhe deri tek 2009 e dimë se ka mjaft organizata që merren me trajtimin e këtyre çështjeve. Disa organizata sa për sy e faqe të zyrave, edhe disa prej tyre që

kanë marr edhe aksione nëpër teren. Ne e kemi edhe grupin parlamentarëve në parlamentin e Kosovës e cili është i përberë, grupi parlamentar për çështjen e të zhdukurve edhe për çështjen e të burgosurve politik edhe as këta nuk po bëjnë kurrgjë për këtë në këtë rast. Unë si pjesëmarrës në këtë konsultim desha që edhe njëherë nga ju të kërkoj një seriozitet pak më të madhe në këtë punë edhe të jeni sa ma konkret nëse e keni fatin të vazhdoni me këtë koalicion. Faleminderit.

Shukrije Gashi: Shqetësimet që i ndave me neve dhe ma herët edhe tash janë shumë me vend. Çka mungon konkretisht në Kosovë për ta realizuar një mendësi të tillë, do më thonë që ata dëshmitaret të cilët janë në moshë të shtyrë që të dëgjoher zëri i tyre si dhe që të realizohet drejtësia është një mungesë të bashkëpunimit më i drejtpërdrejtë në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile në qoftë se do të kishte bashkëpunim ma të mirëfillte dhe më të shpejt atëherë atë herë gjithat këto iniciativa ndarazi e OJQ-ve do të arrinin në adresën e duhur. Mirëpo që të bëhet kjo ne kemi nevojë për ndihmën e juaj. Në bëjmë aq sa mundemi në iniciativën tonë por që kjo të merr fuqi do të jetë më e zorshme, neve na nevojitet ndihma e juaja. Pa përkrahjen e juaj pa përkrahjen e gjithë përfshirëse, edhe juve studenteve edhe gjykatave, gjithë akterëve të rendësish në shoqëri nuk do të me und të realizohet asgjë. Qeveria momentalisht ka shumë probleme prandaj neve na duket se është inerte që ne ta zgjojmë nga gjumi qeverinë atëherë bashkërisht me und të bëjmë diçka. Veçmas këto mbetën vetëm iniciativa dhe ato argumente të cilat i kem faktet do të ngelin nëpër arkiva edhe për një kohë të gjatë. Andaj për këtë arsye ju kemi thirrur juve këtu që me rekomandime, propozime, me ide, ta shtyjme këtë proces tutje. Kjo është një përgjigje për pikëpamjen time. Faleminderit.

Kushtrim Koliqi: Pyetja e fundit. Pyetja a po, apo mendim.

Naser Lajqi: Unë fillimisht ju përshtendes jam Naser Lajqi edhe që aty e kamë emrin të shkruar jam drejtor i organizatës,, Syri i Vizionit”shumica do më thonë pak a shumë paragjykojnë sepse e dinë se çfarë e kemi situatën politike tani me shtetin Serbin. Por kjo është një projekt që tani ka filluar siç tha kolegu i jonë Ivani mos gabofsha, dhe pritët të finalizohet në fund të dhjetorit çka do më thonë që kemi edhe njëzet muaj për të punuar edhe mendojmë që deri tani atëherë na të na ngef edhe Serbja si shtet. Kjo është si një paragjykim edhe nga ana ime. Mirëpo unë kisha thënë a i paraqitët këtij komisioni një rrezik nga brenda çka ndodh nëse në momentin e fundit organizatat të cilat i përfaqësojnë personat të zhdukur familjet e dëshmorëve e këto refuzojnë të bashkëpunojnë me neve. A është parapa ky rrezik sepse çdo herë kur hartojmë diçka duhet ti parashohim edhe rreziqet. Edhe një rekomandim kisha me përcjell ashtu pasi jemi në fazën e rekomandimeve. Kur jemi tek personat këta që kanë pësuar me moshë. Kanë propozuar që të merren këto lëndë dhe t’iu jepet prioritet këtyre lëndëve, këtyre viktimave që janë në moshe që të shqyrtohen ato materiale ato dëshmi dhe të merret sërish në qoftë se ai person është në gjendje ta rikonfirmoj dëshminë e tij që është dhënë. Pse jo, ajo dëshmi me und të jetë e incizuar si video incizim që kishte mundur shumë me ndihmuar në të ardhmen. Faleminderit.

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Lajqi për pyetjen e juaj. Në fakt e ke bo një pyetje shumë me vend edhe pse ne i përmendem shifrat e disa organizata jo qeveritare ju kanë bashkangjitur koalicionit dhe kështu me radhë, duhet ta marrim parasysh një numër i madh i tyre ende nuk është bashkëngjitur. Ne kemi pasur konsultime, sepse ti i përmende shoqatat familjarëve të

viktimize dhe kështu me radhë. Ne kemi pasur vitin e kaluar konsultime me shoqata plus në Forum edhe mandej kemi pas takime kohë pas kohe më ta. Në fakt qëndrimi i tyre nuk është as negativ as pozitiv ndaj kësaj iniciative, kanë deklaruar se ju duhet ma shumë kohë për çka është gjithçka në rregull të konsultohen edhe të marrin ma shumë informata më krejt këtë proces. A din si është shumë vështirë ti kesh të gjithë në një bord. Zakonisht ka ndonjë organizatë apo shoqatë që është shpreh kundërt, unë përmenda në rastin në përvojën e komisioneve të tjera që shoqatat nuk e kanë përkrah komisionin në asnjë rast. Por qëllimi i këtyre konsultimeve është se jo vetëm me shoqata familjarëve të viktimizeve por edhe me grupe të tjera siç janë të rinjtë, artist, historian, gazetar e kështu me radhë që t'u japim sa ma shumë informacione edhe të marrim sa ma shumë ide prej tyre. Kështu besoj se të gjithë në një moment kanë me pa, kanë me vërejtë rëndësinë e komisionit edhe kanë me ju bashkëngjit koalicionit për komision. Kjo ishte shkurtimisht krejt përgjigja ime.

Kushtrim Koliqi: Faleminderit të gjithëve për pyetje unë shkurtimisht do të, edhe pse krejt ky vend është rekorduar si audio ashtu edhe vizual. Brenda kësaj jave të ardhshme do të dalin të gjitha më të sakta se çka është fol këtu. Unë i kam përmbledh disa gjëra shumë të rëndësishme që kanë thënë këtu, kështu që desha me ju rikujtuar shkurtimisht. Edhe pak a shumë me përmbyllë këtë anë zyrtare të këtij konsultimi, pastaj me vazhduar me drekën. Domethënë. Çka u përmend këtu çka ju dha shumë rëndësi njerëzve, u përmenden shumë fakte, shumë histori janë tregu por ato duhen me u pa dika duhen me u qit dika, duhet me pas njëfarë lloj adrese që shpresonim që çfarë do lloj komisioni apo çfarë do gjykatë, apo kush do mi marr këto për bazë këto gjëra. U përmend se gjithqysh duhet me pas bashkëpunim të madh me EULEX-in. Të merren parasysh që ata kanë kompetenca me të mëdha nga ana e gjyqësisë. Dhe kanë pushtet shumë të madhe në aspektin e presioneve politike brenda rajonit në nxjerrjen e fakteve, pushteti i tyre është më i madh se i politikanëve, politikë bërësve lokal. U përmend ashtu që është shumë e rëndësishëm në mënyrë kontinuale, në mënyrë vazhdueshme sidomos viktimat me u pajis me informata. Çka po ndodh me historitë e tyre, në çfarë faze janë historitë e tyre, mos me u lënë ata anash në atë aspekt mos mi marr intervistën dhe mos mi lënë pastaj anash dhe mos mi informuar. Informimi i tyre dhe komunikimi i ma i shpeshtë i tyre mes organizatave, institucioneve, në këtë rast ndoshta edhe komisionit më pas do më thonë komunikim shumë ma të shpeshtë më grupin ma të ndjeshëm brenda të këtij procesi. Po ashtu u përmenden përgjithësimet në aspektin e akuzave, në aspektin e dëshmimeve janë gjëra të këqija. Nuk bon me bo përgjithësime sa i përket akuzave që na i bënin karshi një nacionaliteti të tjetër apo ndonjë grupi caktuar i njerëzve. Përgjithësimet me u lënë anash gjatë këtij procesi ngase i ndihmojnë këtij procesi, u përmend shumë informatat dhe dokumentet shtetërore sidomos Serbisë në këtë rast duhet më qenë në dispozicion. Shteti serb urdhrat kur janë dhënë, çka kanë bo ata diçka kanë arkivat e tyre duhet mi çel, arkivat e tyre duhen me u tregu, gjyqeve, komisionit, në të ardhmen kujt do qoftë. Por duhet me bo njëfarë lloj presioni politik që arkivat *shtetërore* sidomos qasej të periudhës të Slobodan Millosheviqit me qenë në dispozicion të këtij procesi. U përmend dhe rëndësia shumë e madhe shumë e veçantë përkujdesja institucionale për viktimat, institucionet e Kosovës. Ata që paguhen prej taksave tona, më pas përkujdesje të veçantë për viktimat. U përmend dhe roli i madhe dhe bashkëpunimi me mediat siç e cekët më përpara ka me pas konsultime me media. Shumica e mediave në Kosovë kanë me u thirr në konsultime në njëfarë forme ka me u ngrit vetëdija e tyre së më qenë

sa ma aktiv në lidhje më këtë proces për REKOM-in por edhe më procesin e ballafaqimit më të kaluarën si rëndësi. Mos me shkuar vetëm kur ka ndonjë trevjetor apo kur është ndonjë komemoracion në teatër apo ka do qoftë me raportuar, por më u marr shumë ma seriozisht me këtë qasje. U përmend vetëdijesimi dhe informimi shoqërisë në thellësi. Vetëdijesimi dhe informimi shoqërisë me procesin më ballafaqimin në të kallumen sa ishte i rëndësishëm ky proces çka janë rezultatet e çka janë benefitet shoqërisë kosovare si prioritet për këtë proces. Në të njëjtën kohë informimi i shoqërisë për këtë iniciativë, që është shumë ambicioze që s' do më thonë më do e mos do me u themeluar, dhe nuk do më thonë më do e mos do me pas sukses. Kryesor është, aj motivimi i mirë ajo qasja, ndjenja e mirë pse jena mbledh këta njerëz po besojnë që me u themeluar një komision i tillë i cili ka më pas efekt pozitiv. U përmend edhe njëherë identifikimi i viktimave, me u identifikuar viktimat dhe lloji i viktimave, çfarë lloji i viktimave ka me u marr për komision dhe në përgjithësi me u bo njëfarë lloj identifikimi i viktimave më i madh dhe ma i gjeneral se po ka shumë organizata Kryqi i Kuq, Humanitarian Law Center kanë punuar në këtë drejtim ka edhe shumë histori dhe shumë ngjarje që nuk janë treguar kështu kur identifikohen viktimat njëfarë data bazë ma të madhe. Dhe u përmend informimi i saktë apo dezinformimi, provoja për informim të saktë jo më shkaktuar paqartësi, do fjalë çka del çdo informatë çka del duhet më qenë e saktë edhe e njëjtë. Njerëzit sidomos më lidhje më këtë Komision, kur e këqyr as unë hala nuk mundem me dit vetë kur ka me u themeluar ky komision sepse është me të vërtet shumë i madh. Është investim ekstra i madh, mundim ekstra i madh i shoqërisë. Kur është informimi i saktë ka me pas edhe rezultate të sakta rezultate shpresojmë pozitive. U përmend edhe te dëshmitarët të vjetër, dëshmitar në moshë, viktimat në moshë se më pas afinitet edhe para themelimin e KOMRA-s. Ku me ditë kur themelohet KOMRA. Kryqi i Kuq ndërkombëtar, KMDLNJ, HLC me pas prioritet në grumbullim e fakteve të këto mosha. Që historitë e tyre mos me u shukë që historitë e tyre me qenë të dokumentuar, kurr gjë, kurr gjë, për me u lexuar herë do kur do qoftë. U përmenden edhe memorialët edhe nderimi viktimave, nderimi i ngjarjeve tragjike ama organizimi i tyre më qenë ma i mirë. Se ka shumë elementë ka shumë memorialë që në shikim të parë kanë një shije të keqe po shkojmë ka një pamje vizuale shijes të keqe, kështu që është një prej konkluzioneve që memorialët kur organizohen me pas organizimin e duhur, organizimin e denjë, Ne ato memoriale kishte qenë mirë me qenë vetë ata që kanë përjetuar ato. Po të ishte bo ai memorial me përfaqësues që kanë përjetuar atë masakrën e Dubraves ata sigurisht e kishin dhënë idenë se memoriali me u bo brenda aty, e jo në njëfarë lëndinë dhe krejt më u lënduar. Këto memoriale shumë shpesh i lëndojnë njerëzit. Është bo një mural në Gjakovë aty afër lumit, aty për shembull ka pas organizata që e kanë përkrah por ka pas edhe të njëjtën kohë organizata që kanë thonë kjo është ofendim, kështu që involvimi sa ma i madh i organizatave të nënave apo organizatave të dala nga lufta, apo organizata e viktimave sidomos prej atyre që janë prek direkt për shkak të këtyre memorialëve të rëndësishëm që mos me u ndijë ata keq. Bile mos me u ndijë të ofenduar. Konkluzioni i fundit që unë e kam këtu është serioziteti, serioziteti në punë, kjo çështje çka jemi duke bo ne sidomos çështja e viktimave është shumë qasje e ndjeshme. Shumë senzibile, shumë fragjile, gjithmonë ti ki me pas kundërshtime, gjithmonë ki me pasur njerëz të pakënaqur por bile serioziteti që të ishte ma i madhe që nëse unë punoj këtu më u ndijë që ndërgjegjja e ime është e pastër. Serioziteti i njerëzve institucione që mirën direkt sidomos me viktima duhet me qenë në nivelin ma të lartë. Bile me pas ndërgjegjen më të pastër edhe karshi ngjarjeve që kanë ndodh.

Faleminderit shumë të gjithëve, një informatë shumë teknike, për gjithë ata që kanë bo shpenzime transportit e kemi shkruar edhe në e-mail për ata që kanë ardhur jashtë Prishtinës, ajo është rimbursimi. Dreka është duke na pritur, është e nxehtë unë jam unët shumë, nuk kam hëngër kurrgjë sot, edhe faleminderit shumë, Ivanit i cili ka udhëtuar prej Kroacisë, ka ardhur dje, nesër ka me udhëtuar. Faleminderit shumë sinqerisht. Duartrokitje.